

David B. Benner

DHUNTIA E TË QENITVETVETJA

David B. Benner

Dhuntia **e të qenit vetvetja**

Thirrja e shenjtë e vetënjojjes



SHTËPIA BOTUESE
T E N D A
Prishtinë 2021

Biblioteka Psikologji-Filozofi: Seria 4
Titulli: Dhuntia e të qenit vetvetja – thirrja e shenjtë e vetënjohjes
Autor: David G. Benner
Përkthyes: Kujtim Gegaj
Readaktore: Belkize Çakolli
Editor: Femi Çakolli
Ballina & realizimi: Albert Zuka
Formati: 13 x 20.50 cm.
Shtypi: Printing Press
Tirazhi: 700 kopje
Boton: Shtëpia Botuese TENDA, Prishtinë
Viti i botimit: 2021
Copyright: © Tenda
ISBN:
Printed in Kosova
Katoligimi në publikim – CIP: Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”
Citimet e Biblës “Së Bashku”: © Shoqëria Biblike Ndërkonfesionale e Shqipërisë

Botuesi origjinal:
IVP Books
InterVarsity Press P.O. Box 1400 Downer Grove, IL60515-1426, USA
www.itervarsity.org
Email: email@ivpress.com
First edition: ©2004; Expanded edition: ©2015 by David G. Benner
ISBN: 978-0-8308-4612-2

Adresa për kontakte:
Shtëpia Botuese TENDA
Rr. Shyqri Kushevica nr. 4 (afër Pishinës së Gërmisë)
10000 Prishtinë, Kosovë, EU
Tel. 044118088
e-mail: shb_tenda@yahoo.com
www.kishaprotestante-bum.com
fb: Shtëpia Botuese Tenda

Të gjitha të drejtat e këtij botimi në shqip janë të rezervuara dhe i mban Sh. B. “Tenda”. Pa lejen e mëparshme të botuesit asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, depozitohet në një sistem gjurmues apo të transmetohet në ndonjë formë apo me ndonjë mjet elektronik, mekanik, fotokopje, regjistrim apo ndonjë lloj tjetër, me përjashtim të citimeve të shkurtra në rishikime të printuara.

Kushtuar

Gary Moon

dhe

Jeff dhe DeAnne Terrel



*Ka vetëm një problem nga i cili varet e gjithë
ekzistenca, paqja dhe lumturia ime:
të zbuloj veten derisa zbuloj Perëndinë.
Nëse e gjej Atë do ta gjej edhe veten
dhe nëse e gjej veten do ta gjej Atë.*

THOMAS MERTON

Përmbajtja

Përshtypjet e lexuesve të parë profesionistë_____	11
Rrugëtimi shpirtëror _____	13
Parathënie nga M. Basil Pennington _____	15
Hyrje: Identiteti dhe autenticiteti_____	19
1. Njohja transformuese e vetvetes dhe Perëndisë _____	25
2. Njohja e Perëndisë _____	39
3. Hapat e parë drejt njohjes së vetvetes. _____	53
4. Ta njohësh veten ashtu siç je _____	67
5. Demaskimi i vetvetes së rreme. _____	81
6. Shndërrimi në veten e juaj të vërtetë _____	97
Epilogu: Identiteti dhe Rrugëtimi Shpirtëror _____	115
Shtojca: Për reflektim dhe diskutim _____	121
Udhëzues diskutimi për gjashtë sesione mbi Dhuntinë e të qenit vetvetja _____	122
Udhëzues diskutimi për një sesion mbi Dhuntinë e të qenit vetvetja. _____	133
Shënime_____	138
Për autorin_____	143
Libra nga David G. Benner_____	144

Përshtypjet e lexuesve të parë profesionistë

“Si mësuese e drejtuesve shpirtërorë, studentëve të mi ua kërkoj që së pari të lexojnë Dhuntia e të Qenit Vetvetja. Kuptimi i vetvetes së rreme dhe pranimi i vetvetes së vërtetë brenda nesh është thelbësore për njohjen e Perëndisë dhe dëshirat e thella të gjithsecilit dhe është një parakusht për të dalluar këtë histori në jetën e të tjerëve. Ky edicion i ri nxit lexuesit që të ndalojnë dhe të marrin parasysh implikimet e jetës së tyre përmes pyetjeve dhe shembujve nga jeta e Benner-it dhe përvoja e të tjerëve. Kjo kërkon një konsideratë të kujdesshme të premisë së Benner-it si një realitet i gjallë dhe jo vetëm si teori apo ide. Do ta rekomandoj fuqishëm këtë edicion tek studentët për drejtimin dhe formimin shpirtëror”.

Helen Cepero, drejtuese shpirtërore, autore e librit *Karakteri i formësuar nga Krishti dhe Ditari si Praktikë Shpirtërore (Christ-Shaped Character and Journaling as a Spiritual Practice)*.

“Një libër i vogël dhe tërheqës për njohjen e Perëndisë dhe njohjen e vetvetes. Dhuntia e të Qenit Vetvetja depërton nën koren e egos, tejkalon personalitetin dhe karakterin dhe shkon tek e vërteta brenda teje. Ky është një shteg për të zbuluar dhe pranuar vetveten e dashur dhe të papërsëritshëm që Perëndia ka dizajnuar brenda jush”.

Adele Calhoun, autore e librit *Doracak i disiplinave Shpirtërore (Spiritual Disciplines Handbook)*

“Për dallim nga librat e tjerë të mbushur me psikologji popullore sipërfaqësore dhe kryetituj shpirtëror, Benner-i si psikolog dhe drejtues shpirtëror, ofron një hyrje shumë të thellë dhe sfiduese për zbulimin e vetvetes nga të krishterët, në pak më shumë se 100 faqe... Ai jep një skicë të qartë dhe praktike për ata që duan të fillojnë procesin e gjatë të njohjes së Perëndisë dhe njohjes së vetvetes në mënyrë autentike... Diskutimi i tij mbi pranimin e të metave dhe mëkateve tona si një hap i domosdoshëm për transformim është model i kthjelltësisë. Edhe pse tema është rreth njohjes së vetvetes, është e qartë se transformimi është qëllimi kryesor si i këtij libri ashtu edhe i rrugëtimit që ky libër i fton lexuesit të nisin.”

Publishers Weekly (rishikim), 26 Janar 2004

“I zgjuar, i mëshirshëm dhe lehtë i qasshëm, libri i David Benner Dhuntia e të qenit vetvetja është me të vërtetë një dhuratë për kërkuesit e përkushtuar. Autori mbështetet në përvojën personale si psikolog dhe në përkushtimin e tij të gjatë si i krishterë. Rezultati i kësaj është një libër që me shumë dashuri bashkon pikëpamjet e psikologjisë dhe anës shpirtërore të krishterimit.”

Margaret Guenther, autore e librit *Dëgjimi i shenjtë: Arti i Drejtimit Shpirtëror (Holy Listening: The Art of Spiritual Direction)*

“Libri i David Benner Dhuntia e të qenit vetvetja është libri më i mirë që kam lexuar ndonjëherë që e trajton rrugëtimin e zbulimit të vërtetë të vetvetes. E fillova leximin e këtij libri si një favor për Davidin dhe e përfundova pa lëvizur vendit për katër orë si favor për vetveten. Nisur nga urtësia e tij si psikoterapeut dhe drejtues shpirtëror, urtësi nga Shkrimet dhe zbulesat nga Perëndia dhe zbulimet e veta, Davidi butësisht përshkruan dallimin në mes të personit të rrejshëm në të cilin shumica prej nesh jemi shndërruar dhe personit në ngjashmëri me Krishtin që secili duhet të jemi. Nuk jam sfiduar kurrë më parë kaq shumë dhe frymëzuar në të njëjtën kohë për të pranuar dhuntinë e të qenit vetvetja e vërtetë.”

Gary W. Moon, drejtor, Instituti Martin Family dhe Qendra Dallas Willard për Formim Shpirtëror në Kolegjin Westmont, autor i librit *Çirak i Jezusit*. (*Apprenticeship with Jesus*)

“David Benner është studiues i zellshëm i Perëndisë dhe personalitetit njerëzor. Janë të rrallë librat që ndërthurin urtësinë për besimin me njohjen e vetvetes. Ky është ai lloj libri”.

John Ortberg, autor dhe pastor me përvojë, Kisha Presbiteriane Menlo Park, Menlo Park, Kaliforni.

“Po i zbulojmë ngadalë të gjitha aspektet e mishërimit. David Benner e bën pikërisht këtë gjë në këtë libër të shkëlqyer, duke përdorur teologji të mirë, praktika psikologjike dhe shpirtërore për ta vënë në pah edhe anën më të fshehtë. Kjo është detyra e gjithë mësuesve të mirë.”

Richard Rohr, OFM, Qendra për Veprim dhe Shqyrtim, Albuquerque, Nju Meksiko.

“Siç ka bërë edhe shumë herë më parë, David Benner na drejton tek vendi i urtësisë dhe përkushtimit përmes këtij libri të bukur. Me ndjesi dhe mprehtësi ai tregon se dy detyrat më të mëdha në jetë, njohja e Perëndisë dhe njohja e vetes, bashkohen në një trajektore të vetme teksa lëshohemi në krahët e Perëndisë së dashur.”

Mark R. McMinn, Profesor i Psikologjisë, Kolegji Wheaton dhe autor i librit *Pse ka rëndësi Mëkati* (*Why Sin Matters*).

“Rrallë herë sugjeroj libër mbi drejtimin shpirtëror që përjashtojnë Shkrimet e Shenjta. Megjithatë, librin Dhuntia e të Qenit Vetvetja do t'ia ofroja me shumë dëshirë të gjithë nxënësve për drejtim shpirtëror. David Benner na ka treguar se ku takohet përvoja jetësore, mendimi personal dhe lutja: në Perëndinë. E rekomandoj fuqishëm, posaçërisht për ata që sapo kanë filluar me drejtimin shpirtëror.”

David I. Donovan, SJ, Asistent Rajonal për Formim, Provinca e Shoqërisë së Jezusit, New England

Rrugëtimi shpirtëror

Kur është puna te jeta shpirtërore, metafora e rrugëtimit është edhe e dobishme por edhe disi çorientuese. E dobishme sepse reflekton faktin se thelbi i shpirtërores është proces, veçanërisht proces i transformimit. Çorientuese sepse fsheh faktin se ne tashmë jemi aq sa kërkojmë dhe ku synojmë të arrijmë, veçanërisht në Perëndinë. Sapo ta kuptojmë këtë, natyra e rrugëtimit na shfaqet të jetë më shumë si hapje e syve sesa si arritje, më shumë si vetëdijesim shpirtëror sesa si arritje shpirtërore.

Megjithatë, janë dy arsye shumë të mira për ta përshkruar jetën shpirtërore si një rrugëtim. Së pari, ajo përshtatet me përjetimin tonë. Jemi të vetëdijshëm që personi i cili e fillon rrugëtimin shpirtëror nuk është i njëjtë edhe në përfundim të tij. Ndryshimet në identitet dhe vetëdije, si e kuptojmë njohjen e vetvetes dhe përjetimin e brendshëm të jetës, që të dyja janë mjaft domethënëse sa të përshkruhen edhe si transformuese. E njëjta është e vërtetë edhe për ndryshimet e aftësive tona për të dashur dhe funksionimin e vullnetit dhe dëshirës sonë.

Arsyeja e dytë është se rrugëtimi shpirtëror kërkon ndjekjen e një shtegu. Më shumë se adoptimi i një sërë besimesh, shtegu është një praktikë apo seri praktikash që karakterizon tërë jetën tonë. Ndjekja e këtij shtegu është mënyra se si ne marrim pjesë në transformimin tonë. Kjo është mënyra si ne

ecim në Perëndinë dhe derisa e bëjmë këtë, zbulojmë gjithçka që kemi qenë në Perëndinë deri më tani. Është mënyra se si identiteti, vetëdija dhe jeta jonë themelohen në personin tonë tek Perëndia dhe personin e Perëndisë në ne.

Ana shpirtërore e krishterë bazohet në përvetësimin e mendjes dhe zemrës së Krishtit pasi e dimë se Krishti është e vërteta më e thellë e qenies sonë. Përfshirë aktualizimin e Krishtit i cili është në ne. Kjo nënkupton shndërrimin e plotë dhe të thellë në natyrë njerëzore. Nënkupton përjetimin dhe përgjigjen ndaj botës përmes mendjes dhe zemrës së Perëndisë teksa e rreshtojmë veten krahas agjendës transformuese të Perëndisë për bërjen e të gjitha gjërave të reja në Krishtin. Kjo kërkon pjesëmarrjen në jetën e vërtetë të Perëndisë.

Kjo trilogji përshkruan praktikën thelbësore të krishterë të dorëzimit, se si kjo praktikë shfaqet si përgjigje ndaj Dashurisë së Përkryer dhe ndryshimet që kjo sjell në identitetin, vullnetin dhe dëshirat më të thella. Të tre librat përqendrohen në njërën nga këto tema dhe bëjnë gërshetimin me njëra tjetrën. Së bashku, ato shërbejnë si doracak për përshkrimin e shtegut shpirtëror teksa zemra dhe mendja e Perëndisë ngadalë por sigurt bëhet pjesë e jona. Trilogjia e Rrugëtimit Shpirtëror përfshin librat:

Dorëzoju dashurisë: Zbulimi i zemrës së anës shpirtërore
Dhuntia e të qenit vetvetja: Thirrja e shenjtë e vetënjohjes
Kërkimi i vullnetit të Perëndisë: Rreshtimi i zemrave tona
krahas zemrës së Perëndisë

Parathënie



Leximin e vëllimit të kaluar të Dr. David Benner *Dorëzoju dashurisë (Surrender to Love)*, e llogaris në mesin e hirit më të madh të jetës sime. Tani doktori na dhuron një vëllim tjetër të shkurtër por të fuqishëm. Penda e Benner-it në këtë vëllim është e fuqishme, si çdo kund tjetër, sepse bazohet në përvojën e tij të madhe e që ai me guxim e ndan me lexuesit e tij. Ai shkruan me guxim për Perëndinë sepse, siç e thotë vet, e njeh Perëndinë dhe “Perëndia është i vetmi kontekst në të cilin qenia (jonë) ka kuptim.” Dhe sërish në mënyrë shumë praktike dhe të dhembshur, Benner-i na tregon hap pas hapi si të hyjmë në urtësinë që ai e ndan me ne.

Një prej synimeve të mia që ia kisha vënë vetes pas pensionimit (kur pensionimin e kisha shumë larg), ishte të përvetësoja njohuritë e pasura të disa prej mendimtarëve më të mëdhenj teologjik të kohës sonë si Bernard Lonergan, Pierre Teilhard de Chardin dhe John Dunne, dhe t’i sillja më thjeshtë e që do t’i bënte më lehtë të kuptueshme për lexuesit e thjeshtë në mënyrë që jeta e tyre të mund të ndikohej. Pa e kuptuar fare David Benner e ka bërë këtë gjë, duke i bërë më të kuptueshme dhe më të lexueshme disa prej njohurive ekzistuese të Teilhard de Chardin por duke e ruajtur pasurinë

e tyre, e këtu mendoj veçanërisht për *Mjedisin Hyjnor (The Devine Milieu)*. Natyra depërtuese e Perëndisë që na çon tek dashuria e tij krijuese dhe është me ne në çdo gjë që bëjmë, merr kuptim të menjëhershëm pastoral. Me leximin e këtij vëllimi, mendja e njeriut nuk mund të bëjë tjetër veçse të ec përpara dhe të përqafojë shenjtërinë e gjithë jetës së njeriut bashkë me ndikimin praktik të saj në lidhje me abortin, të ashtuquajturën vrasje e mëshirshme, dënimin me vdekje, armët dhe luftërat, kujdesin ndaj mjedisit në mënyrë që planeti ynë të jetë i qëndrueshëm edhe për gjeneratat e ardhshme dhe ndarja e duhur e asaj që kemi për të ruajtur jetën e kësaj gjenerate.

Dikush do të mendojë gjithashtu se Benner-i po na ofron një tekst shumë të pasur shoqëruar për programin ndoshta më të fuqishëm shpirtëror të zhvilluar në shekullin e fundit, Programin e Dymbëdhjetë Hapave, i përshtatur tani për shumicën e të metave tona më të thella. Secili i moshuar me njohuritë që sjell mosha dhe veçanërisht në pension është më se i bindur se në njëfarë forme ka jetuar “gënjeshtrën që është rritur nga toka e vet-injorancës.”

Doktori na ngacmon disa herë me histori të shkurtra që na godasin me saktësi të dhimbshme. Fjalitë befasuese burojnë nga brenda për t’u skalitur pastaj në kujtesën tonë dhe vazhdimisht na drejtojnë për tek e vërteta se:

Sfida jonë është që të demaskojmë Shenjtërinë natyrale dhe të shpallim praninë e Perëndisë në jetën tonë.

Të krijuar nga dashuria, në dashuri dhe për dashuri, ekzistenca jonë nuk ka kuptim pa dashurinë e Shenjtë.

Nëse Perëndia ju do dhe ju pranon si mëkatarë, pse ju nuk mund ta bëni?

Pranimi i vetvetes i paraprin gjithmonë një vet-dorëzimi dhe vet-transformimi të vërtetë.

Ne besojmë se dimë si të kujdesemi për nevojat tona më mirë se Perëndia.

Të gjithë jemi të prirë të modelojmë një perëndi që i përshtatet falsitetit tonë.

Nuk e gjejmë personin e vërtetë brenda vetes duke e kërkuar atë. Por e gjejmë duke e kërkuar Perëndinë.

Jezusi është Personi i Vërtetë i cili na tregon me jetën e tij si të gjejmë veten në relacion me Perëndinë.

Lumturia jonë është e rëndësishme për Perëndinë.

— Këto janë vetëm disa...

Ky është një libër mjaft sfidues. Nëse e kuptojmë këtë libër plotësisht dhe mundohemi ta zbatojmë atë në jetën tonë, do të na çojë drejt një transformimi. Kjo nënkupton vdekjen e personit të rremë që keni kultivuar me kujdes brenda vetes. E thënë shkurt, kjo dhemb. Nëse do të isha i pamëkat, imazh i përkryer i Perëndisë, do të mund ta njihja Perëndinë e dashurisë. Por duke e njohur veten si mëkatar, kjo më mundëson të njoh dikë më të madh: Perëndinë e mëshirës, dikë më të lartë, sepse dashuria i përgjigjet asaj që është e mirë dhe e dashur ndërsa mëshira i përgjigjet asaj që nuk është e mirë dhe e bën atë të mirë dhe të dashur, e kjo është dhuntia e njohjes së vetvetes.

Libri i Davidit tashmë ka filluar të ndikojë brenda meje. Duhet të shpenzoj orë të tëra në të, orë që besoj se do të jenë shumë të frytshme. Dhe shpresoj se ky do të jetë edhe përjetimi juaj.

Dom M. Basil Pennington, OSCO

Identiteti dhe autenticiteti



Është ironi e madhe të shkruash një libër që promovon zbulimin e vetes për ata që mundohen të ndjekin Krishtin e vet-sakrifikuar. Ju mund të mendoni e të frikësoheni se e kam harruar, apo edhe më keq, kam dështuar ta marr seriozisht, mësimin paradoksal të Jezusit se duke e humbur veten, e gjejmë atë në të vërtetë (Mateu 10:39). Teksa e lexoni librin në vazhdim do ta kuptoni se nuk e kam bërë as njërën e as tjetrën.

Përderisa konceptet si zbulimi i vetvetes, identiteti dhe autenticiteti janë lehtësisht të identifikuar si kushte plotësisht psikologjike, secila prej tyre luan një rol të rëndësishëm në rrugëtimin transformues të anës shpirtërore. Edhe tek pasazhi i Mateut që e përmendëm më lartë, Jezusi flet po aq për zbulimin e vetvetes sa edhe për vet-sakrificën. Mirëpo nuk ka dyshim se rrugëtimi i gjetjes së vetes autentike dhe të vërtetë në Krishtin dhe themelimi i identitetit tonë në këtë realitet është shumë i ndryshëm nga agjenda e vet-përmbushjes që promovohet nga psikologjia popullore.

Absurditeti i qasjes së psikologjisë popullore në vetvete është mishëruar në një film vizatimor që kam parë kohët e fundit. Duke iu adresuar një të panjohure në një ndejë, një grua thotë:

“Nuk e njoh askënd këtu përveç nikoqires, dhe natyrisht edhe më mirë e njoh veten.” Është e qartë se ka shumë mënyra jo të krishtera, e ndonjëherë edhe qesharake, në kërkim të zbulimit të vetvetes dhe autenticitetit.

Megjithatë ana shpirtërore e krishterë duhet të bëjë një marrëveshje me vetveten, jo vetëm me Perëndinë. Qëllimi i rrugëtimit shpirtëror është transformimi i vetvetes. Siç do ta shohim, kjo kërkon si njohjen e vetvetes po ashtu edhe njohjen e Perëndisë. Të dyja janë të nevojshme nëse duam ta zbulojmë identitetin tonë të vërtetë, si persona “në Krishtin” (2Korintasve 5:17), sepse veten e gjejmë aty ku e takojmë Perëndinë. Të dyja janë po ashtu të nevojshme nëse duam të jetojmë sipas mënyrës unike për të cilën jemi thirrur.

Ndër të gjitha krijesat, identiteti është sfidë vetëm për njerëzit. Tulipani e di saktësisht se çka është. Asnjëherë nuk tundohet për të devijuar nga qenia e saj. As nuk përballlet me vendime të ndërlikuara në procesin e rritjes. E njëjta gjë ndodh edhe me qentë, gurët, drunjtë, yjet, amebat, elektronet dhe të gjitha gjërat e tjera. Të gjitha i japin lavdi Perëndisë për atë që janë. Sepse duke qenë ashtu siç Perëndia i ka krijuar, tregohet bindje ndaj tij. Megjithatë, njerëzit, ballafaqohen me ekzistencë më sfiduese. Ne mendojmë. I marrim parasysh mundësitë. Ne marrim vendime. Ne veprojmë. Ne dyshojmë. Të jesh i thjeshtë është shumë e vështirë të arrihet dhe të jesh autentik është tepër e rrallë.

Trupi dhe shpirti përmban mijëra mundësi nga të cilat mund të ndërtohet shumë identitete. Mirëpo vetëm në njërin nga këto mund të gesh veten tënde të vërtetë, që është e fshehur në Krishtin në gjithë përjetësinë. Vetëm në njërin do të mund të zbulosh prirjen unike dhe përmbushjen më të madhe. Por, ashtu siç argumenton Dag Hammarskjöld, nuk do ta gesh kurrë këtë “përderisa të mos përjashtosh të gjitha mundësitë sipërfaqësore dhe të shkurtra me të cilat luan nga kurioziteti, habia apo lakmia dhe të cilat ju pengojnë të hidhni spirancën

në përjetimin e misterit të jetës dhe të jeni të vetëdijshëm për talentin që u është besuar juve e që formon “Unin” tuaj.¹

Ne të gjithë jetojmë në kërkim të një mënyre të mundshme për të ekzistuar që mbart në vete edhe dhuntinë e autenticitetit. Jemi më të vetëdijshëm për këtë lloj kërkimi të identitetit, gjatë adoleshencës, kur kjo zë vendin kryesor. Në këtë fazë të jetës ne provojmë identitete që lidhen me veshjen dhe kërkojmë një stil të qenies që i përshtatet mënyrës si duam të dukemi para tjerëve. Por edhe shumë kohë pasi e kanë kaluar adoleshencën, shumica e të rriturve herë pas here përballen me ndjenjën e mashtrimit, ndjenjën se nuk janë ata që pretendojnë të jenë por janë më shumë ata që pretendojnë të mos jenë. Me pak reflektim, shumica nga ne mund të bëhemi të vetëdijshëm për maskat që kemi adoptuar si strategji për të shmangur ndjenjat e cenueshmërisë por të cilat janë bërë pjesë e vetes sonë sociale. Tragjikisht, neve na duket më e lehtë të shtiremi, dhe vetvetja autentike shpesh duket si një iluzion.

Megjithatë ka një mënyrë të qenies për secilin prej nesh që është natyrale dhe në harmoni sikurse jeta e tulipanit. Nën rolet dhe maskat ekziston një mundësi e vetes që është unike sikurse një fjollë dëbore. Është një origjinalitet që ka ekzistuar qysh kur Perëndia na deshi në ekzistencë. Vetja jonë e vërtetë në Krishtin është vetja e vetme që do të mbështesë autenticitetin. Vetëm kjo na jep një identitet që zgjat përjetë.

Gjetja e vetes unike, siç përshkruhet nga Thomas Merton, është problem nga i cili varet e gjithë ekzistenca, paqja dhe lumturia.² Asgjë tjetër nuk është e rëndësishme sepse nëse gjejmë veten e vërtetë atëherë e gjejmë Perëndinë dhe nëse e gjejmë Perëndinë, e gjejmë veten më autentike.

SHNDËRRIMI NË VETEN E JUAJ TË VËRTETË

Të jesh vetvetja nuk ka ndonjë kuptim shpirtëror nëse ana jote unike nuk do të ishte si vlerë e çmuar para Perëndisë, por secili person është pikërisht kështu, i një vlere të pamatshme para Perëndisë.

Kurrë nuk duhet të tundohemi e të mendojmë se rritja në ngjashmëri me Krishtin e humb anën tonë unike. Mendimi i disa të krishterëve për jetën shpirtërore është se teksa ngjasojmë më shumë me Krishtin dukemi çdoherë e më shumë sikur njëri tjetri, por një kult i tillë për humbjen e individualitetit nuk ka asgjë të përbashkët me anën e vërtetë shpirtërore të krishterë. Në mënyrë paradoksale, teksa ngjasojmë më shumë me Krishtin ne bëhemi edhe më unik në veten tonë të vërtetë.

Siç do ta shohim në vazhdim, ka disa mënyra të rreme për të arritur tek unikja. Këto janë të gjitha përpjekje për të *krijuar* një vetvete, në vend se të *pranohet* dhuntia e vetvetes në Krishtin. Mirëpo unikja që vjen nga të qenit vetvetja e vërtetë nuk është unikja që ne e krijojmë. Identiteti nuk është asnjëherë i krijuar. Ai është gjithmonë një zbulim. Identiteti i vërtetë është gjithmonë dhunti e Perëndisë.

Dëshira për të qenë unik është dëshirë shpirtërore. Njëjtë është edhe dëshira për të qenë autentik. Këto nuk janë thjesht dëshira psikologjike dhe që nuk lidhen me rrugëtimin shpirtëror. Të dyja janë përgjigje që shpirti i jep Frymës, Fryma e Shenjtë që na thërret të kthehemi tek vendi dhe identiteti që kemi në Perëndinë.

Të jesh i thelluar në veten tënde unike është diçka që Perëndia e dëshiron, sepse vetja jote e vërtetë është e rrënjosur në Krishtin. Perëndia ju ka krijuar juve si unik dhe kërkon që t'ju rikthejë tek unikja në Krishtin. Ta gjesht dhe ta jetosh veten tënde të vërtetë është përmbushje e arsyes për të cilën je krijuar.

Ky libër flet për rrugëtimin transformues të shndërrimit në veten tonë të vërtetë në Krishtin dhe të jetesës së thirrjes që kemi. Pas shqyrtimit të ndërlidhjes mes njohjes së Perëndisë dhe vetes, që do ta shohim në kapitullin e parë, libri është i organizuar rreth tri nevojave të gjëra me të cilat ballafaqohen të krishterët që duan ta vënë veten në dispozicion të Perëndisë:

1. Nevojën për një njohje transformuese të Perëndisë që vjen nga takimi i Perëndisë në thellësinë e qenies sonë. Ky është thelbi i kapitullit dy.
2. Nevoja për njohje transformuese të vetvetes që vjen nga zbulimi se si na njeh Perëndia. Ky është thelbi i kapitullit tre, katër dhe pesë. (Përkushtimi i tre kapitujve për njohjen e vetes dhe vetëm një kapitulli për njohjen e Perëndisë nuk do të thotë që mendoj se njohja e vetes është më e rëndësishme se njohja e Perëndisë. E kam bërë për faktin se përderisa ka me mijëra libra për njohjen e Perëndisë, në krishterim shumë pak është shkruar në lidhje me rëndësinë e njohjes së vetes. Edhe për shkak të ndërlidhjes në mes të këtyre dy formave të njohjes, përgjatë kapitujve do të shohim vazhdimisht mënyra të njohjes së Perëndisë që zbulojnë edhe mënyra të njohjes së vetes).
3. Nevoja për të gjetur identitetin tonë, përmbushjen dhe thirrjen në Krishtin brenda vetes sonë të fshehtë, do të shqyrtohet në kapitullin gjashtë.

Rrugëtimi transformues nuk është aq linear sa duket dhe për këtë arsye diskutimi do të endet herë tek njëra temë e herë tek tjetra. Përveç kësaj edhe aspektet e rrugëtimit janë të ndërlidhura. Siç do ta shohim, njohja e vërtetë e vetvetes kërkon që ta njohim vetveten ashtu si na njeh Perëndia, dhe njohja e vërtetë e Perëndisë kërkon që ta njohim Perëndinë jo vetëm si diçka abstrakte apo si e dhënë objektive por sipas dhe përmes përjetimit tonë të gjallë.

DHUNTIA E TË QENIT VETVETJA

Lutem që atë që do të lexoni në vazhdim do t'ju ndihmojë të zbuloni anën unike të asaj që jeni thirrur të jeni qysh nga përjetësia. Besoj që do t'ju ndihmojë të njihni më thellë edhe veten edhe Perëndinë, dhe në këtë mënyrë të kuptoni dhuntinë e të qenit vetvetja.

Sidnei, Australi

E enjtja e katërt para Pashkës!

Njohja transformuese e vetvetes dhe Perëndisë



Në epigrafin hapës të këtij libri, Thomas Merton, na tregon se çka konsideron si gjënë me të rëndësishme në të gjithë botën, nga e cila varet e gjithë ekzistenca, lumturia dhe paqja e tij. Çka do të konsideronit si gjënë më të rëndësishme për ekzistencën dhe mirëqenien tuaj? Si mendoni se do t'i përgjigjeshin kësaj pyetje shumica e të krishterëve që njihni?

Shumica e të krishterëve që unë njoh do të përgjigjeshin me dy fjalë: “Gjetjen e Perëndisë.” Të tjerë do të mund të përdornin fjalë të tjera si, njohjen, dashurinë dhe shërbesën ndaj Perëndisë. Disa, në përgjigjet e tyre, do të përfshinin kishën dhe marrëdhënien e tyre me të tjerët. Sido që do ta shprehnin, dyshoj se shumica e të krishterëve do të thoshin diçka për Perëndinë por nuk do ta përmendnin fare veten.

Të thuash se njohja e Perëndisë luan rol të rëndësishëm në jetën shpirtërore të krishterë, nuk është befasi për asnjëri. Të thuash se njohja e vetes luan rol po aq të rëndësishëm mund të ndez kambanat e alarmit për shumicën e njerëzve dhe do të konsiderohet si ajo lloj thënie që do të mund ta prisje nga një autor që është psikolog dhe jo nga një teolog. Por kuptimi i ndërvlarësisë së njohjes së vetes dhe Perëndisë ka ruajtur

një vend të respektuar dhe të qëndrueshëm në teologjinë e krishterë. Thomas à Kempis tha se “njohja e vetes me përlulje është mënyra më e sigurt drejt Perëndisë sesa kërkimi pas një mësimi të thellë”¹ dhe lutja e Augustinit ishte: “Zot, më mundëso ta njoh veten që të mund të të njoh ty.”² Këta të dy janë vetëm një shembull i numrit të madh të teologëve që kanë mbajtur këtë qëndrim qysh prej ditëve të para të kishës.

Ana shpirtërore e krishterë përfshin transformimin e vetes dhe ndodh vetëm atëherë kur Perëndia dhe vetvetja njihen plotësisht. Andaj, që të dyja zënë një vend të rëndësishëm në anën shpirtërore të krishterë. Nuk ka njohje të thellë të Perëndisë pa njohjen e thellë të vetvetes dhe as njohje të vetes pa njohje të thellë të Perëndisë. Gjon Kalvini shkroi: “Pothuajse e gjithë doktrina e krishterë përbëhet nga këto dy pjesë: njohja e Perëndisë dhe vetvetes.”³

Edhe pse asnjëherë nuk ka pasur ndonjë mospajtim serioz teologjik me këtë pikëpamje të krishterimit të hershëm, kjo është harruar pothuajse plotësisht nga kisha bashkëkohore. Jemi përqendruar në njohjen e Perëndisë dhe jemi përpjekur të injorojmë njohjen e vetes. Pasojat shpesh kanë qenë të mëdha si tradhti martesore, familje të shkatërruara, shërbesa të fundosura dhe shumë njerëz të lënduar.

Lënia e vetes jashtë anës shpirtërore të krishterë rezulton në një anë shpirtërore që nuk është e rrënjësuar në përjetim. E në këtë formë nuk është e bazuar as në realitet. Të përqendrohesh në Perëndinë e në anën tjetër të dështosh ta njohësh veten, mund të prodhojë një formë të devotshmërisë vetëm sa për dukje por gjithmonë do të lë një zbrazëti në mes të dukjes dhe realitetit. Kjo është e rrezikshme për shpirtin e gjithsecilit ndërsa tek drejtuesit shpirtëror mund të jetë shkatërrimtare edhe për ata të cilët i kanë drejtuar.

Mendojeni se si do ta ndikonte jetën e një pastori shumë të njohur dhe kishën e tij, mungesa e njohjes së vetes. Askush nuk do ta vinte në dyshim njohurinë e tij për Perëndinë, së

paku jo deri tek dështimi i tij publik. Ai mbase ka ndërtuar një shërbesë të suksesshme përmes predikimit dhe nuk ka arsye të dyshohet se ai personalisht nuk i njeh të vërtetat që i shpall publikisht. As nuk ka ndonjë arsye të dukshme që të vihet në dyshim njohja e vetvetes. Çdokush që do të mendonte për këtë çështje do të gjykonte se ai ka njohuri të thellë për veten. Predikimet e tij shpesh përmbanin zbulime të vetes dhe dukej se ai e dinte si të jesh i cënueshëm para Perëndisë.

Por sikurse për shumicën nga ne, e gjithë kjo është më shumë paraqitje e jashtme sesa realitet. Vetveten që ky pastor e ka paraqitur para të tjerëve ishte një vetvete publike që ai e ka ndërtuar me shumë kujdes, një vetvete e rreme e krijuar nga vet ai. Në mes të vetvetes publike dhe përjetimit të tij të vërtetë është një humnerë e thellë. Kjo humnerë dhe përjetimi i tij i brendshëm janë jashtë vetëdijes së tij.

Pastaj, papritur, humnera në mes të realitetit të brendshëm dhe dukjes së jashtme do të ekspozohet. Gjërat që nuk i ka ditur apo nuk i ka pranuar për vetveten janë fryrë brenda tij dhe kanë shkatërruar iluzionin e jetës që është paraqitur. Epshi e ka çuar në marrëdhënie seksuale me një grua që ai po e këshillonte, por edhe lakmia e kishte shtyrë të keqpërdorte fondet e kishës më herët. Teksa këto gjëra u bënë publike, jeta e tij e rreme doli në shesh. Ishte një gënjeshtër të cilën e kishte jetuar para familjes së tij, miqve të ngushtë, kishës së tij, Perëndisë dhe vetes. Ishte gënjeshtër që u rrit nga toka e vet-injorancës.

Nuk ka nevojë ta identifikojmë këtë person e as t'i japim një emër të shpikur. Historia e tij është shumë e njohur. Ai na e kujton mësimin e Jezusit për rrezikun që kanoset kur i verbri i prin të verbrit (Mateu 15:14), të dy mbase shumë lehtë mund të bien në humnerën e dhimbjes dhe dëshpërimit. Mirëpo sa serioze është kjo? Sipas Jezusit është më mirë të të hedhin në det me një gur mulliri rreth qafës sesa t'ia shkaktosh dikujt një vështirësi të tillë (Mateu 18:6). Ky pastor dhe shumë

të tjerë si ky nuk kanë shkaktuar vetëm një por me mijëra vështirësi dhe i kanë shkaktuar njerëzve plagë shkatërruese.

NJOHURI QË MBUSH

Ky person nuk është se nuk e ka njohur fare vetveten dhe Perëndinë. Mirëpo asnjëra nga këto nuk ishin të dobishme për të. Asnjëra nga këto nuk ia vlente të cilësohej si *njohuri transformuese*.

Jo të gjitha njohuritë transformojnë. Disa vetëm na ngrenë në ajër si një tullumbace e stërfryrë. E dini pastaj se çka ndodh me tullumbacet e stërfryra.

Aktori dhe regjisori Woody Allen shpesh flet publikisht për seancat e psikanalizës që ai ndjek prej disa dekadash. Tre apo katër seanca në javë, i ulur në divan, ku thoshte gjithçka që i vinte në mendje dhe ia lejonte analistëve të bënin interpretime periodike të kuptimit të këtyre mendimeve të lira që do ta udhëzonin më vonë zbulimin e tij. Megjithatë ka pak dëshmi se njohja e vetvetes i ka sjell Allenit lirinë apo shëndetin psikologjik. Në fakt, duke qenë se beteja e vazhdueshme nervore e tij është shenjë dalluese e karakterit të tij publik, ai shpesh e përqendron humorin e hidhur të tij në kufirin e kuptimit të vetvetes dhe e përdor si një mjet për ndryshim.

Njohja e vetes që kërkohet veçmas njohjes së identitetit në relacion me Perëndinë na qon lehtësisht në vet-krekosje. Kjo është fryrja, vetvetja madhështore për të cilën na paralajmëron Pali (1Korintasve 8:1), një arrogancë ndaj të cilës ne jemi të cenusshëm kur njohuria vlerësohet më shumë sesa dashuria. Kjo na qon edhe në vet-shqetësim. Përderisa nuk përqendrohemi në Perëndinë po aq sa përqendrohemi në vetveten, njohja jonë për vetveten thjesht do të na shtyjë tej e më tej drejt një humnere të vet-ndreqjes.

Mirëpo është shumë e mundur që të kemi njohuri të

mjaftueshme për Perëndinë por që nuk na ndihmon aspak që ne të njohim me të vërtetë Perëndinë apo vetveten. Posedimi i informacionit për Perëndinë nuk është më transformues sesa posedimi i informacionit për dashurinë. Teoritë dhe idetë për Perëndinë mund të qëndrojnë në kuti të fortifikuara brenda mendjes sonë dhe që nuk na hyjnë fare në punë. Nëse e dyshoni këtë, rikujtoni fjalët e ashpra të Jezusit drejtuar udhëheqësve fetarë të asaj kohe të cilët e njihnin ligjin e Perëndisë por nuk e njihnin zemrën e Perëndisë.

Pastori, historinë e të cilit sapo e ndava me ju, kishte informacione të mjaftueshme për Perëndinë. Ai dukej sikur dinte shumë edhe për vetveten. Por kjo njohuri ishte e gjitha objektive e jo personale. Kështu që, ishte relativisht e padobishme për të.

Për shembull, ai më tha se e dinte që Perëndia është falës. Por ai nuk e kishte përjetuar kurrë këtë falje së paku jo në lidhje me ndonjë dështim të madh. Do të ishte më e saktë të thuhej se ai *besonte* që Perëndia është falës por ai nuk e *njihte* këtë si një të vërtetë të cilën e kishte përjetuar. Duke jetuar gënjeshtërën e vetvetes së trilluar, ai çdoherë kishte rrëfyer para Perëndisë mëkate jo të mëdha dhe që nuk kishin pasoja por kurrë nuk kishte guxuar të ekspozojë para Perëndisë realitetin e botës së tij të brendshme. Për ta bërë këtë do të duhej që ai vet të përballej me këtë realitet. Ai nuk kishte qenë kurrë i përgatitur që ta bënte një gjë të tillë.

Ai më tha se armiku i tij kishte qenë përtacia, dembelia shpirtërore. Ai më tha se shpesh i kishte kërkuar Perëndisë falje që nuk po punonte më shumë për mbretërinë. Por rrëfimi i një mëkati të tillë ishte më shumë një shpërqendrim. Ai kishte zhvendosur shpërqendrimin (dhe ndoshta shpresonte se edhe Perëndia kishte zhvendosur shpërqendrimin) nga gjërat më të thella të tij që ishin tërësisht të çorientuar.

Ai më tha gjithashtu që e dinte se Perëndia është dashuri. Por sërish, ky ishte një besim e jo një përjetim. Për ta njohur

dashurinë me të vërtetë duhet ta pranojmë atë në gjendje të pambrojtur – të ndjeshme, e të ballafaqohemi me të “ashtu siç jemi”. Ky person nuk ka qenë në gjendje kurrë që t’ia lejojë vetvetes këtë shkallë të cenueshmërisë para të tjerëve, as para gruas së tij, as para fëmijëve të tij, as para shokëve të ngushtë e as para Perëndisë.

Pastaj, nuk është befasi se njohuria e tij për vetveten ishte mjaft sipërfaqësore. Teksa dëgjoja gjërat që m’i tregonte për jetën e tij më dukej sikur lexoja një roman të hedhur anash apo sikur po shikoja një film të dorës së dytë. Rolin që ai po e luante, kishte mungesë të thellësisë dhe realitetit. Ishte një realitet dydimensional. Teksa po më tregonte për vetveten ai po e përshkruante një person të cilin e kishte vështruar nga distanca. Njohuria që kishte pasur për këtë person ishte objektive dhe e largët. Në këtë formë ajo nuk kishte pasur ndonjë vlerë transformuese. Kjo ishte thjesht një përpjekje dëshpëruese për t’i dhënë gjallëri vetvetes së rreme që ai pretendonte të ishte. Vetja që ai e kishte menduar ta shfaqte para botës ishte vetëm një iluzion.

Edhe pas kësaj krize, ky person kishte vështirësi të mëdha të tregohej i singertë. Prirja e tij e gjatë dhe e rrënjosur thellë për të paraqitur vetveten e pretenduar dhe ideale i ka mbijetuar edhe prishjes së shërbesës dhe martesës së tij. Problemi më i madh nuk ishte se ai kishte thënë gënjeshtria por se ai i kishte jetuar ato. Kjo është tragjedia e vetes së rreme, por fatkeqësisht, ky person nuk kishte monopol në falsitet. Është pjesë e të gjithë neve, në një formë apo në një tjetër.

NJOHURIA QË TRANSFORMON

Njohuria e vërtetë transformuese është çdoherë personale, dhe asnjëherë vetëm objektive. Kjo nënkupton *njohjen e vërtetë* dhe jo vetëm *njohje sipërfaqësore*. Njohuria është

gjithmonë e lidhur me diçka. Ajo rritet nga marrëdhënia me objektin që është i njohur, qoftë ai Perëndia apo vetvetja.

Njohja objektive mund të ndodh në relacion me diçka që ne e shqyrtojmë nga distanca. Kjo lloj njohurie është e pavarur nga ne. Për shembull, ju mund të dini për orbitat e tokës rreth diellit apo që Kolombo arriti në Amerikë në vitin 1492, pa ndonjë përjetim personal të asnjërës prej tyre, vetëm duke pranuar dëshmitë e të tjerëve. Kjo ndodh me shumicën e gjërave të cilat i besojmë.

Në anën tjetër njohja personale bazohet në përjetim. Andaj është subjektive. E di se gruaja ime më do për shkak të lidhjes që kam me të. Unë mund ta përshkruaj dashurinë e saj për dikë tjetër por nuk mund ta vërtetoj atë. Nuk mund ta shndërroj këtë në objektive. Megjithatë kjo nuk e zbeh vlerën e njohurisë sime.

Për shkak se njohuria personale është e bazuar në përjetim, kjo kërkon që ne të jemi të hapur ndaj përjetimit. Njohja e dashurisë së Perëndisë kërkon që ne të pranojmë dashurinë e Perëndisë dhe ta përjetojmë atë e jo vetëm ta pranojmë si teori. Njohuria personale nuk është kurrë vetëm një çështje e kokës. Për shkak se ajo është e rrënjësuar në përjetim, ajo gjendet në vendet më të thella të qenies sonë. Ato gjëra që i njohim nga përjetimi ynë janë përtej asaj çka besojmë. Njohuria e tillë nuk është në mospërputhje me besimin por nuk varet nga ai.

Unë nuk besoj vetëm që gruaja ime më do, por e di se ajo më do. Edhe pse mund të duket arrogante, mund të them se nuk besoj thjesht në Perëndinë por e njoh Perëndinë, jo tërësisht por e njoh në të vërtetë.

Ata që nuk kanë arritur kurrë ta njohin thellë dhe personalisht Perëndinë do të jenë të kufizuar në njohjen e thellë e personale të vetvetes. Duke dështuar ta njohin Perëndinë ata nuk do të jenë në gjendje të njohin vetveten, sepse Perëndia është

konteksti i vetëm në të cilin qenia e tyre ka kuptim. Ngjashëm, ata që kanë frikë të kërkojnë thellë brenda vetes së tyre do të kenë po ashtu frikë të kërkojnë thellë brenda Perëndisë. Për personat e tillë, idetë për Perëndinë zëvendësojnë përjetimin e drejtpërdrejtë të Perëndisë.

Andaj, njohja e Perëndisë dhe njohja e vetes janë të ndërvarura. Asnjëra nuk mund të shkojë larg pa tjetrën. Në mënyrë paradoksale, arrijmë ta njohim Perëndinë më mirë jo duke e njohur vetëm Perëndinë, por duke e njohur Perëndinë pastaj vetveten, e pastaj duke e njohur sërish Perëndinë e sërish vetveten. Kjo është edhe mënyra si arrijmë ta njohim më mirë veten. Në këtë formë si Perëndia ashtu edhe vetja janë plotësisht më të njohur në marrëdhënie me njëri tjetrin.

NJOHURIA TRANSFORMUESE E PJETRIT

Për ta ilustruar se si shpaloset kjo, merrni parasysh rrugëtimin shpirtëror të Pjetrit. Shkëmbin mbi të cilin Krishti premtoi se do ta ndërtonte kishën e tij ishte mjaft i thyeshëm. Por asnjëri nga dishepujt nuk tregoi pjekuri më të madhe kur bie fjala tek kuptimi i vetes dhe Perëndisë përgjatë tre viteve sa ishin në shoqërimin e Krishtit.

Le të shohim sa e njihte Pjetri vetveten në disa faza të rrugëtimit të tij. Së pari është takimi i tij fillestar me Krishtin dhe thirrja e Krishtit për ta ndjekur. Çka mendojmë se dinte Pjetri për veten dhe Perëndinë në këtë kohë?

Andreu, vëllai i Pjetrit, e takoi i pari Jezusin dhe e pranoi menjëherë ftesën për ta ndjekur Atë. Andreu pastaj shkoi tek Pjetri, i tregoi atij se e kishte gjetur Mesian dhe e solli Pjetrin tek Jezusi që ai ta shihte vet. Përgjigja e Pjetrit ishte e njëjta me të vëllait të tij. Ai menjëherë la rrjetat e peshkimit dhe e ndoqi Jezusin (Mateu 4:18-22). Nga ky tregim mund të thuhet sigurt se Pjetri e pranoi Jezusin si Mesia. Nëse po, atëherë mund të themi se Jezusi ishte çliruesi i shumëpritur

që do t'i çlironte nga shtypja e romakëve. Në këtë pikë kjo njohuri ishte vetëm si besim, një shpresë e bazuar në bindjet e të vëllait dhe nga kontakti i shkurtër që ai kishte pasur me Jezusin.

Mirëpo çka ka mundur të dijë ai për vetveten? Tani natyrisht se po spekuloj, por nëse do ta kishim pyetur për vetveten mbase do të na thoshte se ishte një peshkatar. Ndoshta, do të kishte shtuar edhe se ishte pak temperament dhe shpërthyes. Pastaj, ndoshta, do të na thoshte se mezi priste një shpëtimtar për popullin e tij dhe kjo do të na tregonte se ai ishte njeri i shpresës dhe besimit. Megjithatë është shumë e mundur që ai të mos e dinte se sa e madhe ishte frika brenda tij dhe sa e madhe ishte krenaria. Këto nivele të njohjes së vetvetes kanë pritur një njohje më të thellë të Perëndisë.

Pastaj më vonë kur ndodh takimi i tij me Jezusin që ecën mbi ujë (Mateu 14:22-23), duket e arsyeshme të thuhet se tashmë besimi i Pjetrit se Jezusi është Krishti, ishte më i fortë. Pjetri i kishte parë mrekullitë e shumta të Jezusit, e kishte dëgjuar të predikonte për turmat e mëdha dhe të fliste me individët dhe e kishte pasur mundësinë ta shihte nga afër.

Mirëpo atë natë, Pjetri nuk po mendonte për asnjërën nga këto. Në mes të detit dhe në një barkë që po përballej me një stuhi të fuqishme Pjetri dhe dishepujt e tjerë ishin të brengosur për sigurinë e tyre. Kur papritur e panë Jezusin që po ecte mbi ujë në drejtim të tyre, ata u tmerruan.

Fjalët e Jezusit drejtuar atyre duhet të kenë qenë si një siguri e menjëhershme:

“Kini zemër! Jam unë! Mos kini frikë!

Pjetri menjëherë iu përgjigj Jezusit dhe i tha: “Nëse je ti, më urdhëro të vij tek ti mbi ujëra.”

Krishti e ftoi atë që të zbriste nga barka dhe të shkonte tek Ai dhe Pjetri e bëri pikërisht këtë.

Nëse do ta kishim pyetur tani, pas kësaj përvoje, se çka dinte për Perëndinë, Pjetri do të mund të na tregonte për rritjen e bindjes së tij se Jezusi ishte më të vërtetë Krishti. Ai do të mund të na tregonte edhe për rritjen e shpresës së tij bazuar në përjetimin e mrekullive të Krishtit. Ai do të mund të na thoshte se ndihej i sigurt kur e dinte se Perëndia i kishte dëgjuar lutjet e popullit të tij dhe më në fund e kishte dërguar Shpenguesin.

Po ta pyesnim se sa e njihte veten ndoshta tani do të mund të fliste për frikën e tij. Përderisa pati guximin të dilte nga barka dhe të ecte në ujë drejt Krishtit ai përjetoi edhe frikën e fundosjes kur filloi të shikonte valët e detit e jo Krishtin. Por mbase shumë shpejt do të na thoshte se kjo i shërbeu vetëm që ta forconte besimin e tij në Krishtin.

Kur e shohim pastaj larjen e këmbëve të dishepujve nga ana e Jezusit (Gjoni 13), e shohim fillimisht refuzimin e Pjetrit i cili nuk donte ta lejonte Krishtin t'ia lante këmbët e pastaj Krishti bën parashikimin për tradhtinë e Pjetrit. Çka do të thoshte Pjetri për njohjen e Perëndisë dhe vetes në këtë pikë?

Duket shumë e mundur që Pjetri tani të flas me vetëbesim për dashurinë e tij për Jezusin, për entuziazmin e besimit të tij se Jezusi është Krishti dhe më pas për mosbesimin e plotë dhe për tronditjen nga parashikimi i Jezusit rreth mohimit të pashmangshëm të tij. Kjo puna e mohimit mund ta ketë lënë me mëdyshje të mëdha. Mund të ketë qenë e pakuptueshme për të që ai do ta mohonte ndonjëherë Jezusin. A nuk e njihte Jezusin thellësinë e dashurisë së tij? A nuk e njihte Jezusi guximin heroik dhe fuqinë e bindjeve të tij? Ndoshta ka menduar se Krishti kishte gabuar me parashikimin e Tij. Dyshimi tek Jezusi ishte më i lehtë sesa dyshimi tek vetja. Ai ende nuk ishte ballafaquar as me krenarinë e tij e as me nivelin e frikës.

Nëse ia hedhim një shikim të shkurtër Pjetrit pas mohimit të Krishtit (Gjoni 18:15-27), ndoshta mund ta shohim të zhytur

në keqardhje dhe vuajtje. Për një çast ai ishte ballafaquar me mungesë të guximit, me mungesë të theksuar të besnikërisë dhe me frikë të madhe. Ndoshta edhe ka menduar se sa lehtë krenaria e tij është lënduar nga parashikimi i Jezusit për mohimin e Tij. Mbase ka kujtuar edhe kundërshtimin e tij kur kishte thënë se “edhe nëse të gjithë do ta humbin besimin, unë nuk do ta humb” (Marku 14:29). Thënë shkurt, ai ishte ballafaquar me veten e tij më të dobët dhe më të neveritshme dhe dukej se ishte i mbushur me neveri për veten.

Në fund, çka mund të themi për njohurinë e Pjetrit për vetveten dhe Perëndinë në momentin e ballafaqimit me Krishtin e ringjallur (Gjoni 21:15-25)? Pas vdekjes së Krishtit, Pjetri dhe disa prej dishepujve të tjerë i ishin kthyer peshkimit. Çfarë i kishte mbetur tjetër? Pas një nate të gjatë ku nuk kishin kapur asnjë peshk, e takuan një njeri të panjohur në breg, në agim të diellit, një njeri që u interesua për peshkimin e tyre dhe i inkurajoi ata që të hidhnin rrjetat në anën tjetër të barkës. Menjëherë rrjetat e tyre u mbushën sa u shqyen nga peshqit. Dhe menjëherë pas kësaj ata e njohën Zotin e tyre. Pjetri u hodh menjëherë nga barka dhe filloi të notonte kah bregu.

Duke e ditur mënyrën si e kishte mohuar, Jezusi e pyeti tre herë nëse ai e donte më shumë sesa dishepujt e tjerë. Kjo i dha Pjetrit tre mundësi të deklaronte dashurinë e tij, aq herë sa e kishte mohuar. Përgjigja e Jezusit ishte që të përsëriste të njëjtën ftesë që Pjetri ta ndiqte (Gjoni 21:19), pikërisht e njëjta ftesë që kishte bërë kur marrëdhënia e tyre filloi.

Çka do të na thoshte Pjetri në këtë pikë për njohjen e Perëndisë dhe vetes? Mendoj se ai së pari do të thoshte se sa pak kishte ditur për veten dhe Jezusin para se kjo të ndodhte. Sa i përket Jezusit, mendoj se do të përsëriste me habi se sa falës ishte Jezusi. Atë që ai kishte ditur si informacion objektiv nga ballafaqimet e Jezusit me të tjerët tani po e

njihte më thellë dhe më personalisht. Jam i sigurt se ai do të fliste edhe për nivelin e tanishëm të gatishmërisë për të ndjekur Krishtin të cilin tani po e njohte me gjithë zemër e jo vetëm me mendje.

Gërshetimi i njohjes së thellë të vetes dhe Perëndisë që mund ta shohim tek përjetimi i Pjetrit ilustron mënyrën se si ndodh njohja e vërtetë e vetes dhe Perëndisë. Pjetri nuk do të mund ta njohte Jezusin pa e njohur veten në relacion me Jezusin. Ai nuk e njohu veten derisa Jezusi nuk ia shfaqti se kush ishte. Mirëpo me njohjen e vetvetes ai arriti të njohë me të vërtetë edhe Jezusin.

Njohja e thellë e Perëndisë dhe vetes gjithmonë zhvillohen në mënyrë bashkëvepruese. Rezultati është transformimi autentik i vetvetes që është në thelb të anës shpirtërore të krishterë.

FTESA HYJNORE

Çka keni mësuar për veten si rezultat i përvojës suaj me Perëndinë? Dhe çka dini për Perëndinë si rezultat i ballafaqimit të vërtetë me vetveten?

Gjëja e parë që do të thoshin të krishterët se dinin për veten si rezultatet e marrëdhënies së tyre me Perëndinë është natyra e tyre mëkatore. Me shumë gjasë, gjëja e parë që do të thoshin se kanë mësuar për Perëndinë do të ishte falja dhe dashuria e Perëndisë. Këto janë gjëra të rëndësishme për t'i ditur dhe do të flas më shumë për to në kapitujt në vazhdim. Mirëpo çka dini tjetër për veten dhe Perëndinë që është vënë në dukje pas ballafaqimit tuaj me hyjnoren?

Përderisa shumica prej nesh e kemi ndjekur Jezusin për më gjatë sesa tri vjet, për dallim nga rrugëtimi i Pjetrit që e kemi parë më lart, ne shpesh nuk ia kemi lejuar prezantimit fillestar që të thellohemi në njohuri më intime dhe të thella. Edhe pse, shumë lehtë flasim për një marrëdhënie personale

me Perëndinë, shumë nga ne e njohim Perëndinë më pak se sa një të njohur të rastësishëm. Njohjen e Perëndisë e kemi marrë si shumë të lehtë. Shumë lehtë, marrëdhënia jonë me Perëndinë është shndërruar në sipërfaqësore. Andaj, a është befasi se nuk kemi mësuar shumë për veten për shkak të kësaj qasjeje?

Nëse kjo është përvoja juaj, atëherë mos e lejoni veten të bëheni pre e fajit. Dëgjoni thirrjen e Perëndisë për një takim të thellë dhe personal me të dhe merreni si një ftesë e jo si një qortim. Kjo është një ftesë që ju ta lini barkën tuaj të sigurt dhe ta takoni Jezusin në cënueshmërinë dhe kaosin e stuhisë suaj të brendshme. Është një ftesë për të tejkaluar objektivat personale të njohjes së vetes. Është një ftesë për të njohur Perëndinë më të vërtetë.

Njohja e Perëndisë



Është lehtë të jesh jo i sinqertë kur flasim për njohjen e Perëndisë. Shpesh bisedat tona klishe për Perëndinë, seriozisht janë shumë të largëta me përjetimin tonë aktual.

Shpresoj se shoqërimi im me Vikin do të më ndihmojë që ta shmang këtë gjë. Në mendjen time, ajo është e ulur krah meje teksa shkruaj këtë kapitull, duke e lexuar nga prapa shpatullave të mia.

Viki dëshiron që ta njohë Perëndinë më shumë se çdo gjë tjetër në botë. Kjo ka qenë dëshira e saj më e madhe për më shumë se një dekadë si ndjekëse e Krishtit. Kjo është një dëshirë aq e thellë e saj, saqë refuzon të pranojë ndonjë zëvendësim, veçanërisht gënjeshttrat për të cilat e di se do ta shtynin të fliste nëse përdor gjuhën e “marrëdhënies personale me Perëndinë” dhe t’i bënte ato pjesë të përjetimit të saj. Ajo ndihet shumë e vetmuar, duke e bërë të ndihet se disi po dështon të bëjë gjërat si duhet apo se ka ndonjë të metë brenda saj dhe është e paaftë të përjetojë Perëndinë. Por ajo nuk është aq e vetme sa ndihet. Ajo është thjeshtë më e sinqertë. Dëshira e saj e zjarrtë për intimitet me Perëndinë është më me pasion.

J. I. Packer thotë se njohja bëhet edhe më komplekse teksa lëvizim nga njohja e objekteve tek njohja e njerëzve dhe nga

njohja e njerëzve tek njohja e Perëndisë: “Sa më kompleks të jetë objekti aq më komplekse bëhet njohja e tij.”¹ Kështu që, pasi njohja e vërtetë e një personi tjetër, në vetvete është detyrë e vështirë, njohja e Perëndisë së padukshëm duket se është krejtësisht e pamundur. Do të ishte kështu po qe se nuk do të ekzistonte fakti se kjo është diçka që Perëndia e do më shumë sesa vet ne.

Është mjaft befasuese që Perëndia dëshiron të njihet nga qenia njerëzore. Mirëpo asgjë nuk i jep më shumë kënaqësi Perëndisë (Hosea 6:6). Zbulesa është thelbësore për karakterin hyjnor. Perëndia mezi pret të na zbulohet.

Zbulesa nuk është diçka që ka ndodhur dikur larg në të kaluarën. Nëse do të ishte kështu, e vetmja gjë për të cilën do të shpresonim do të ishin disa informata nga ajo ngjarje historike. Mirëpo “Perëndia nuk ka reshtur së Zbuluari ashtu siç nuk ka reshtur asnjëherë së qeni Dashuri.”² Lajmi i mirë është se Perëndia mund të njihet personalisht dhe të përjetohet nga qeniet njerëzore. Ky është thelbi i jetës së përjetshme (Gjoni 17:3). Asgjë tjetër në këtë botë nuk ka vlerë më të madhe (Filipianëve 3:7-10).

Atëherë, cila është kjo njohje e Perëndisë që ka vlerë kaq të madhe, që i jep Perëndisë kaq shumë kënaqësi dhe që na jep neve jetë me bollëk dhe jetë të përjetshme? Është njohja personale, njohje që fillon me besim por thellohet përmes marrëdhënies.

Shumicën e gjërave që i dimë për Perëndinë janë njohuri objektive që i pranojmë si fakte në dëshmitë e besuara të Shkrimit dhe të komunitetit të besimit. Këto janë baza e njohjes personale që na shërben si spirancë në periudhat e dyshimit dhe si kornizë e përjetimit që i jep kuptim përjetimit tonë. Ky themel i besimit tonë do të zbërthehet nga përjetimi por asnjëherë nuk do të zëvendësohet nga ai. Synimi i Perëndisë është që të njohim dashurinë hyjnore duke e përjetuar atë. Por edhe kur i Dashuri ynë Hyjnor duket larg,

ne mund të mbahemi tek shpresa e natyrës së palëkundur të dashurisë së Perëndisë për shkak të dëshmisë së Shkrimeve dhe dëshmisë së të tjerëve.

Sado e vlefshme të jetë kjo njohuri objektive, Packer na kujton se edhe “njohja më e vogël e Perëndisë është më e vlefshme sesa një mal njohurish *rreth* Tij.”³ Njohja transformuese e Perëndisë vjen nga njohja intime dhe personale e dashurisë hyjnore. Për shkak se Perëndia është dashuri, Ai mund të njihet vetëm përmes dashurisë. Ta njohësh Perëndinë do të thotë ta duash Perëndinë dhe ta duash Perëndinë do të thotë ta njohësh Perëndinë (1Gjoni 4:7-8). Perëndia i krishterimit njihet vetëm përmes devotshmërisë e jo një ndarjeje objektive. Kjo është arsyeja pse lutja e Palit është që ne të mund të njohim dashurinë e Krishtit që tejkalon çdo njohuri, që të mbushemi në të gjithë plotësinë e Perëndisë (Efesianëve 3:19). Kjo është njohuri transformuese.

Njohja e Perëndisë kërkon edhe dorëzim. Thomas Merton shkruan se: “duhet ta njohim të vërtetën, duhet ta duam të vërtetën që njohim dhe duhet të veprojmë sipas masës së dashurisë sonë. E vërteta është vetë Perëndia i cili nuk mund të njihet përveç përmes dashurisë dhe nuk mund të njihet pa iu dorëzuar vullnetit të Tij.”⁴ Njohja e vërtetë kërkon përgjigje. Njohja e Perëndisë kërkon që ne të jemi të gatshëm të prekemi nga dashuria hyjnore. Kur prekemi nga dashuria e Perëndisë ne do të ndryshohemi përgjithmonë. Kur i dorëzohemi dashurisë hyjnore ne gjejmë strehën e shpirtit tonë, vendi dhe identiteti për të cilin jemi të etur në çdo qelizë të qenies sonë.

NJOHJA E JEZUSIT

Nëse Perëndia i padukshëm nuk do të bëhej asnjëherë i dukshëm, njohja jonë për këtë Perëndi do të ishte shumë e kufizuar. Mirëpo vet-zbulimi hyjnor u bë i plotë në Jezusin.

Andaj, kur njohim Jezusin, ne njohim Perëndinë (Gjoni 14:9). Jezusi është “shëmbëllimi i Perëndisë së padukshëm” (Kolosianëve 1:15). Prandaj Ai është filtri nëpër të cilin duhet të kalojmë të gjitha idetë që kemi për Perëndinë teksa kërkojmë të kalojmë nga njohja e Perëndisë tek takimi personal i Perëndisë në Jezusin.

Disa të krishterë flasin për takimin personal me Jezusin sikurse të ishte takim që ndodh vetëm një herë, diçka që ndodh në momentin e kthimit tek Jezusi. Kjo është një ngatërresë tragjike në mes të takimit të parë dhe marrëdhënies. Takimi i parë është vetëm takimi i fillimit. Ajo që Perëndia kërkon që ne të përjetojmë është njohja intime që vjen nga marrëdhënia e vazhdueshme me Të.

Mendoni sërish për Pjetrin nëse doni të kuptoni se si marrëdhënia me Jezusin e rrit njohjen e Perëndisë. Si jude palestinez i shekullit të parë, Pjetri dinte shumë gjëra për Perëndinë edhe para se ta takonte Jezusin. Kjo njohuri bazohej më shumë në të qenit pjesë e një komuniteti besimi që tregonte vazhdimisht histori për të bëmat e mrekullueshme të Perëndisë për popullin e tyre. Ai, për shembull, do të duhej ta dinte se Perëndia është Krijuesi i të gjitha gjërave. Ai me siguri e dinte se Perëndia i kishte shpëtuar paraardhësit e tij nga skllavëria në Egjipt. Ai e dinte se ky Perëndi i Abrahamit, Isakut dhe Jakobit ishte Perëndia i Shenjtë.

Mirëpo e gjithë kjo njohuri objektive u rrit në mënyrë dramatike kur Pjetri e njohu Jezusin. Dy letrat e tij janë të mbushura me njohje personale të Perëndisë që erdhën për shkak të tre viteve të kaluara me Jezusin. Kjo njohje e bazuar në marrëdhënie e prezantoi Pjetrin me një Perëndi që ai nuk do të mund ta njihnte kurrë pa Jezusin. Le të shohim vetëm disa nga gjërat që ai mësoi, e të cilat gjinden në letrat e tij:

- Perëndia është burimi i jetës së re dhe një shpresë e gjallë që vjen nga Krishti i ringjallur (1Pjetri 1:3).

- Perëndia është burimi i besimit që është më i çmuar se ari (1 Pjetri 1:7).
- Perëndia është burim i gëzimit të papërshkrueshëm (1Pjetri 1:8).
- Perëndia gjykon me paanësi dhe drejtësi (1Pjetri 1:17).
- Perëndia na lejon të ndajmë vuajtjet e Krishtit si një mënyrë për të njohur Jezusin përmes identifikimit (1Pjetri 4:12-13).
- Perëndia është besnik dhe mund të besohet se e bën të drejtën (1Pjetri 4:19).
- Perëndia e kundërshton krenarinë por i jep hir atyre që përulen (1Pjetri 5:6).

Kur lexoj letrat e Pjetrit habitem dhe them a është ky i njëjti peshkatar gjaknxehtë që e hasim tek ungjijtë! Diçka dramatike i ka ndodhur atij. Nga njohja, si e Perëndisë ashtu edhe e vetvetes, ai i është nënshtruar një ndryshimi radikal për shkak të njohjes me Jezusin.

Marrëdhënia zhvillohet kur njerëzit kalojnë kohë së bashku. Kalimi i kohës me Perëndinë duhet të jetë thelbi i lutjes. Megjithatë, siç shpesh praktikohet, lutja duket sikur është më shumë një seri e e-maileve apo mesazheve në telefon sesa i një takimi të përbashkët. Shpesh lutja përmban më shumë fjalë sesa dëgjim. Nuk duhet të befasohemi kur rezultati i kësaj është një marrëdhënie sipërfaqësore.

Pika fillestare për të mësuar që thjesht të kalojmë kohë me Perëndinë është të mësojmë ta bëjmë këtë gjë me Jezusin. Të kalosh kohë me Jezusin na mundëson ta bazojmë njohjen tonë me Perëndinë në ngjarje konkrete të një jete konkrete. E në fakt, si mund ta bëjmë një gjë të tillë? Këtë e bëjmë përmes një meditimi mbi Ungjijtë, të udhëhequr nga Fryma.

TAKIMI ME JEZUSIN NË UNGJJI

Meditimi mbi ungjijtë na jep mundësi të hyjmë në momente specifike të jetës së Jezusit dhe të ndjejmë përjetimin e tij. Ndarja e përjetimit është thelbi i çdo shoqërie. Meditimi i udhëhequr nga Fryma mbi jetën e Jezusit na e mundëson këtë gjë.

Meditimi të cilin po e rekomandoj nuk është i njëjtë me studimin e Biblës. Është më shumë si ushtrim i imagjinatës sesa si intelekt. Kjo nënkupton që ta lejosh Frymën e Perëndisë t’ju ndihmojë që në mënyrë imagjinare të hyni në një ngjarje të jetës së Krishtit siç është paraqitur në ungjij.

Më lejoni ta ilustroj se çka dua të them me këtë sugjerim duke ua dhënë një shembull të thjeshtë bazuar në tregimin e Markut për Jezusin dhe të riun pasanik.

Fillimisht, merrni pak minuta që të qetësoheni në praninë e Perëndisë. Mbyllini sytë dhe kërkojini Perëndisë të marrë fjalët e Shkrimit dhe me fuqinë e Frymës së Tij, t’i bëjë ato Fjalë të Perëndisë për ju. Kërko dhuntinë e takimit të shkurtër imagjinar me Jezusin, të udhëhequr nga Fryma. Pastaj ngadalë, lexo disa herë ngjarjen më poshtë, mundësisht me zë:

“Tani kur po bëhej gati për rrugë, i doli përpara dikush me vrap; u gjunjëzua para tij dhe e pyeti: ‘Mësues i mirë, çfarë duhet të bëj që të trashëgoj jetën e përjetshme?’ Dhe Jezusi i tha: ‘Pse më quan i mirë? Askush nuk është i mirë, përveç një të vetmi, domethënë Perëndisë. Ti i njeh urdhërimet: *“Mos shkel kurorën. Mos vrit. Mos vidh. Mos bëj dëshmi të rreme. Mos mashtro. Ndero atin tënd dhe nënën tënde”*. Dhe ai, duke iu përgjigjur, i tha: ‘Mësues, të gjitha këto i kam ruajtur që nga fëmijëria ime’. Atëherë Jezusi e vështroi, e deshi dhe i tha: “Një gjë të mungon; shko, shit të gjitha ato që ke dhe jepua të varfërve dhe do të kesh thesar në qiell; dhe eja, merre kryqin tënd dhe më ndiq”. Por ai u trishtua për këto fjalë dhe u largua me keqardhje, sepse kishte shumë pasuri.” (Marku 10:17-22).

Tani lejoni veten që të “ëndërroni me sy hapur” për situatën

e paraqitur në këtë histori. Së pari paramendojeni të riun që i afrohet Jezusit përderisa Ai po nisej për rrugë. Pastaj, sikur të ishit spektator, vështroni ngjarjet teksa ndodhin. Shikoni, dëgjoni dhe jeni të vëmendshëm për lëvizjet e Krishtit. Mos u shpërqendroni nga i riu pasanik. Mos u mundoni ta analizoni historinë dhe të mësoni nga ajo. Vetëm ndjeni praninë e Jezusit dhe jini të hapur ndaj reagimeve tuaja. Tani, lëshojeni librin dhe kaloni katër apo pesë minuta dhe mundohuni ta provoni këtë ushtrim të thjeshtë.

Unë fillova të meditoj rregullisht mbi jetën e Krishtit në këtë mënyrë, vetëm këto vitet e fundit. Pas disa dekadash leximi të Biblës, e kuptova që marrëdhënia ime me Perëndinë ishte e bazuar më shumë në atë që besoja sesa në atë që përjetoja. Kisha shumë informacione për Perëndinë por mundohesha ta thelloja njohjen personale. Njohja më e mirë e Jezusit dukej se ishte pika më e mirë ku duhej të filloja. Dhe ishte e tillë.

Megjithatë, rrugëtimi nuk ishte i lehtë. Kam vështirësi t'i parafytyroj gjërat dhe imagjinata ime është mjaft e kufizuar. Shpesh e kuptoj se detajet e pamjeve të vendit të ngjarjes në mendjen time janë ekskluzivisht ato që paraqiten në ngjarjet biblike. Duket se kam vështirësi që t'ia lejoj Frymës që të pasurojë pamjen duke shtuar detaje tjera të ndjeshme, ashtu siç bën për njerëzit e tjerë. Por pasi e kaloj zhgënjimin dhe ndjenjën e dështimit, e kuptoj se meditimi për ngjarjen, duke ia lejuar vetes të "ëndërroj me sy hapur", është sikur të bashkëndjesh me Jezusin përjetimin e Tij. Në fakt, ngadalë, jam duke arritur një nivel të ri të njohjes personale të Jezusit.

Unë gjithashtu ballafaqohem më përvojën e paevitueshme të shpërqendrimin të vëmendjes. Edhe ju mund ta keni përjetuar të njëjtën gjë kur e keni provuar meditimin e shkurtër më lart. Nëse ju ka ndodhur, mos u brengosni. Mendimet e shpërqendruara janë të paevitueshme. Sapo ta shohësh që kjo po të ndodh, thjesht ktheje vëmendjen tek meditimi. Mendimet e shpërqendruara tregojnë se Perëndia

e ka krijuar trurin tonë në atë mënyrë që të ndjek shtigje të lidhjes së mendimeve, kështu që kur kjo ndodh mos ia lejon vetes të mërziteni.

Një sfidë tjetër që kisha, ishte ndjenja se meditimi ishte humbje kohe. Doja ta gjykoja nga këndi i përfitimit që kisha nga ai. Kur e praktikoj, shpeshherë më dukej se ishte një praktikë joefikase shpirtërore. Mirëpo produktiviteti dhe efikasiteti nuk e arsyetojnë thelbin. Ajo që do Perëndia është thjesht prania jonë, edhe pse mund të ndihemi sikur po humbin kohën tonë produktive. Këtë gjë e bëjnë shokët kur rrinë së bashku, ata e humbin kohën me njëri tjetrin. Vetëm qëndrimi së bashku është i mjaftueshëm, pa pasur ndonjë pritje se do të “marrësh diçka” nga shoqërimi. Nuk duhet të jetë ndryshe edhe me Perëndinë.

Kalimi i kohës me Jezusin, duke medituar në ungjij, ka filluar t’i japë formë Perëndisë që unë jam munduar ta njoh për shumë vite. Teksa Jezusi ka filluar të bëhet më njerëzor dhe më real për mua, Perëndia i padukshëm, që është shëmbëllyer në Jezusin, është bërë më i arritshëm. Jezusi e lidh qiellin me tokën, njerëzoren me hyjnoren. Nëse Ai është aq hyjnor sa të mos mund ta takojmë anën e tij njerëzore, Perëndia mbetet tërësisht i Huaj. Por në Jezusin, Perëndia është i pranishëm. Kjo është e vërteta e Emanuel, Perëndia me ne.

Nuk ka zëvendësim për meditimin mbi jetën e Jezusit nëse kërkojmë të bazojmë njohjen e Perëndisë përmes ungjijve. Dëgjimi i predikimeve dhe leximi i Biblës na japin informacione për Jezusin, por kjo nuk është e njëjtë me takimin personal me Të përmes ngjarjeve të jetës së tij. Meditimi duhet të jetë pjesë e jetës së lutjes së secilit të krishterë i cili është serioz dhe kërkon njohjen e vërtetë të Perëndisë. Ungjijtë na ofrojnë mundësi të mëdha për ta takuar Jezusin kur mësohemi t’i përdorim këto mundësi në këtë mënyrë.

Meditimi në ungjij është sikur t'ia ngulësh sytë Jezusit. Kur Jezusi e krahasoi veten me gjarprin e bronzit që Perëndia ia kërkoi Moisiut ta bënte, që fëmijët e Izraelit ta shikonin kur po vdisnin nga kafshimi i gjarpërinjve (Gjoni 3:14-15), një nga gjërat që Ai po thoshte ishte se kur shikojmë tek Krishti me besim dhe përkushtim, Fryma e Perëndisë na mundëson ta marrim jetën e tij dhe ta bëjmë tonën.⁵ Perëndia na ka dhënë Jezusin si Shëmbëllimin Hyjnor që ne të mund të shikojmë tek Ai dhe të mund ta njohim Perëndinë. Kjo është arsyeja pse meditim në ungjij ka kaq fuqi transformuese.

TAKIMI ME PERËNDINË PËRMES NGJARJEVE TË JETËS

Burimi i dytë më i pasur për të kaluar kohë më Perëndinë është të kuptuarit se Prania Hyjnore është pjesë e përjetimit të përditshëm. Siç shkruan Carolyn Gratton, jeta vazhdon të ecë.⁶ Llojllojshmëria e situatave të jetës, disa të dëshirueshme e disa më pak, na japin mundësi ta njohim më mirë veten dhe Perëndinë. Secila na jep një mundësi të shohim ku është Perëndia në atë përjetim dhe cilat dhuntia po na ofron Perëndia për rritjen tonë.

Mënyra e dytë e njohjes së Perëndisë nuk është aq e ndryshme nga e para sa duket. Të dyja përmbajnë takimin me Perëndinë në rrethana konkrete të jetës. Andaj të dyja mbështesin zhvillimin e anës shpirtërore praktike dhe me këmbë në tokë, ku ballafaqohemi me Perëndinë në pjesët e zakonshme dhe të njohura të jetës sonë. Paul Stevens e përshkruan një anë të tillë shpirtërore në këtë formë: “Nëse Perëndia ka ardhur në mish dhe nëse Perëndia vazhdon të vijë tek ne në mishin tonë atëherë e gjithë jeta është plot kuptim. Toka është e mbushur me parajsë, dhe parajsa (kur më në fund të arrijmë atje) do të jetë e mbushur me tokë. Asgjë nuk shkon dëm. Asgjë nuk humbet. Asgjë nuk është laike. Asgjë nuk është absurde... Të gjitha janë drithë për mullirin e shpirtërores me këmbë në tokë.”⁷

Perëndia i gjithëpranishëm, emri i të cilit është Emanuel, nuk është i largët por është më afër se sa ne mendojmë. Perëndia nuk është i huaj ndaj rrethanave të jetës sonë por vjen tek ne përmes tyre. Sfida jonë është të demaskojmë natyrën e Hyjnores dhe të shpallim praninë e Perëndisë në jetën tonë.⁸

Një shoqe e imja më shkroi kohëve të fundit duke më treguar për dëshpërimin dhe shpresën e humbur teksa shihte vuajtjet e shumë njerëzve në vendin e saj. “Por”, tha ajo, “unë guxoj të shpresoj se edhe në këtë dëshpërim do të takoj Perëndinë i cili qan bashkë me mua për ata që kanë dhimbje të madhe dhe për të cilët shpresa është e rrezikshme.” Ajo kishte të drejtë. Perëndia është bashkë me të në përjetimin e dëshpërimit, duke pritur që ajo të kuptojë Praninë Hyjnore dhe ta pranojë si shoqëruese të rrugëtimit që shpesh është i vështirë për qenien njerëzore.

Është relativisht e lehtë të takosh Perëndinë në kohë lumturie apo hareje. Në këto situata ne me të drejtë e llogarisim veten si të bekuar nga Perëndia. Sfida është të besojmë dhe të kuptojmë praninë e Perëndisë edhe në mes të mëdyshjeve, dëshpërimit, ankthit, konfliktit apo dështimit. Por Perëndia që është Emanuel është i njëjti si në ato momente që nuk do t'i zgjidhnim kurrë si në ato të cilat do t'i zgjidhnim me kënaqësi.

Richard Rohr na kujton se: “nuk mund ta arrijmë praninë e Perëndisë. Ne tashmë jemi tërësisht në praninë e Perëndisë. Ajo që na mungon është vetëdija.”⁹ Ky është thelbi i rrugëtimit shpirtëror, të mësojmë ta shohim qartë praninë e Perëndisë, ta shohim atë që është, por nuk ka asgjë më të rrezikshme sesa të supozojmë se shohim kur në fakt nuk shohim.

E vërteta është se Perëndia duhet të shihet tek të gjitha gjërat, e veçanërisht tek gjërat që na sjellin dhimbje, ato tragjike apo të pakëndshme. Jezusi ishte Shpëtimtari i vuajtur që njihte çdo tundim dhe përjetim negativ njerëzor. Zemra e Perëndisë përmban çdo emocion që mund të përjetojë njeriu. Brenda

asaj zemre jemi edhe ne pavarësisht çdo përjetimi. Perëndia i gjithëpranishëm i krishterimit, miqësia me të cilin nuk mund të shmanget as duke shkuar në ferr, në skajin e detit apo nëse ngjitemi në qiell (Psalmi 139:7-12), është një Perëndi që është i pranishëm në ne, në çdo moment të jetës sonë.

Shumica nga ne mësojnë të shohin praninë e Perëndisë duke shikuar së pari në pasqyrën e pasme. Kjo është vlera e rishikimit të ditës me anë të lutjes, diçka që e kam përshkruar edhe diku tjetër e që mund të konsiderohet si një vlerësim ditor.¹⁰ Lucinda e ka përshkruar përjetimin e parë të kësaj si më poshtë:

“Pasi isha ulur në karrigen time të preferuar dhe i kisha kërkuar Perëndisë që të bëj një vlerësim të ditës, menjëherë më shkoi mendja tek një takim jo fort i këndshëm që kisha pasur me një kolege atë mëngjes. Ajo e futi kokën tek dera e zyrës sime dhe më pyeti për vizitën që e dinte se do t’ia bëja prindërve të mi për fundjavë. Edhe pse flas me të pothuajse çdo ditë, nuk kisha folur më herët me të për familjen time dhe papritur ndjeva një lloj turpi që të flas me të. Nuk kishte asgjë të turpshme që doja t’i tregoja, por çuditërisht, fillova të ndjehesha sikur doja të fshihesha. E përfundova bisedën shpejt dhe nuk mendova më për të.

Ishte e frikshme t’ia kërkoja Perëndisë që të më ndihmonte të reflektoja për këtë situatë. Nuk isha e sigurt nëse doja t’i njihja këto ndjenja. Më dukeshin ndjenja të njohura dhe që i kisha shmangur por që ishin të fshehura brenda përjetimit tim. Më kujtoheshin edhe herë të tjera kur kisha ndjerë diçka të ngjashme. Më përpara ikja nga këto ndjeja sa më shpejt që mundja. Këtë herë vendosa të qëndroj në to nëse Perëndia do të më ndihmonte.

Ende nuk jam e sigurt se nga vjen kjo ndjenjë apo çka nënkupton ajo. Kam reflektuar vetëm për një ngjarje, përgjatë një dite. Por mendoj se kam hedhur një hap të rëndësishëm.”

Ia ktheva letrën Lucindës dhe e pyeta nëse kishte mësuar ndonjë gjë për Perëndinë nga kjo përvojë. Ajo u përgjigj:

“Qëndrimi në praninë e Perëndisë me turpin tim më ndihmoi të shihja se Perëndia nuk ishte i tronditur nga kjo. Në fakt, dukej sikur ai dinte gjithçka. Dhe ai sërish më pranoi! Unë e kuptova se sido që të ishte turpi, nuk kisha nevojë të fshihesha nga ai sepse Perëndia dinte gjithçka për të. Kur e ndava me Perëndinë mu bë e mundur të përjetoja dashurinë e Tij për një pjesë të cenueshme dhe të ndjeshme brenda meje.”

Përjetimi i Lucindës tregon se si njohja e Perëndisë dhe njohja e vetvetes shkojnë paralel. Njohja transformuese e Perëndisë vjen nga takimi i Perëndisë në thellësinë tonë e jo në abstrakten e propozimeve të pluhurosura teologjike.

Qëllimi i vlerësimit të përvojave jetësore të kohëve të fundit përmes lutjes nuk është analiza e vetvetes. Synimi nuk është që t'i heqim një e nga një shtresat dhe të gjejmë probleme apo keqkuptime. Por qëllimi është që thjeshtë të rrisim vetëdijen për praninë e Perëndisë në ngjarjet e jetës dhe të kuptojmë thellësinë e qenies sonë. Është sikur të jesh pjesëmarrës bashkë me Perëndinë që është tashmë i pranishëm. Në përgjithësi pyetjet që fillojnë me “çka” (si: Çka po ndjeja? Çka më ka shqetësuar në lidhje me komentin? Çka më ka bërë të ndihem në ankth?) janë më të mira sesa pyetjet me “pse” (Pse u ndjeva i/e kërcënuar? Pse më shqetësoi diçka e tillë?). Dhe mos bëni kërkesa ndaj vetes apo Perëndisë. Vetëm pranoni çfarëdo që vjen nga secili përjetim apo ditë.

A JENI GATITA NJIHNI PERËNDINË MË THELLË?

Nëse ideja e meditimit në ungjill dhe e vlerësimit me anë të lutjes së përvojave të kohëve të fundit zgjon interes në ju, atëherë mundohuni të përkushtoheni për pesëmbëdhjetë minuta në fund të ditës, gjatë javës së ardhshme dhe bëni si më poshtë:

1. Së pari, merreni ditarin tuaj (apo diçka ku mund të shkruani) dhe gjeni një vend të qetë ku mund të uleni pa u shqetësuar dikush.
2. Zgjidhni një pjesë të ungjillit ku paraqitet një ngjarje e jetës së Krishtit. Pas një lutje të shkurtër ku e ftoni Perëndinë që t’ju mundësojë që në mënyrë imagjinare të përjetoni dhe ta takoni Jezusin, kaloni pesë minuta duke “ëndërruar me sy hapur” mbi pasazhin.
3. Pasi e falënderoni Perëndinë për kohën e kaluar me Jezusin, kërkon ndihmë që të reflektoni për ditën tuaj që të kuptoni më mirë Praninë Hyjnore.
4. Lejoni ngjarjet e ditës të përsëriten në mendjen tuaj. Pranoni si dhuratë nga Perëndia, çkado që ju vjen në mendje, pa marrë parasysh se sa e parëndësishme mund të duket në fillim. Kërkon ndihmë Perëndisë që të kuptoni Praninë Hyjnore në këtë përjetim.
5. Mbaroni duke falënderuar Perëndinë për atë që keni pranuar gjatë këtij procesi.

Nuk ka një formulë të thjeshtë për njohjen e thellë të Perëndisë. Viki, që në mendjen time ka qenë e ulur afër meje derisa e kam shkruar këtë kapitull, ka mësuar të shmang çdo gjë apo çdokënd që ka sugjeruar diçka ndryshe. Edhe ju duhet të bëni të njëjtën gjë.

Ky kapitull, nuk i prek as për së afërmi të gjitha format që mund të përdoren për ta njohur Perëndinë. Mirëpo reflektimi i sinqertë dhe me anë të lutjes rreth ungjillit dhe përjetimeve të përditshme na japin mundësi të mëdha që të takojmë Perëndinë në mënyra që do t’ju ndryshojnë. Siç e kemi parë, kjo ua mundëson të ballafaqoheni me vetveten në vende edhe më të thella.

Hapat e parë drejt njohjes së vetvetes



Edhe pse për disa njerëz të caktuar themi se janë të krijuar vetë, asnjëri nga ne nuk jemi krijesa të vetvetes. Individualiteti nuk është arritje, por është dhunti. Siç do ta shohim në kapitullin gjashtë, vetvetja jonë e vërtetë, në Perëndinë, është diçka që pranojmë nga Perëndia. Çdo identitet tjetër është krijim i yni dhe si i tillë është iluzion.

Andaj njohja e vetvetes duhet të fillojë me vetveten që është e njohur edhe nga Perëndia. Nëse Perëndia nuk na njeh, atëherë ne nuk ekzistojmë. Siç Morton e ka shprehur (me një gjuhë të ashpër), “të jesh i panjohur nga Perëndia është plotësisht privatesi”¹

Mundësia për të njohur veten është e bazuar në faktin se ne jemi tashmë të njohur për Perëndinë. Po ashtu, edhe mundësia jonë për të njohur Perëndinë është e bazuar në faktin se Perëndia tashmë të njeh. J. I. Packer, në mënyrë të saktë e përmbledhë prioritetin e kësaj njohjeje: “Ajo që ka më shumë rëndësi, pikë së pari, nuk është fakti se unë e njoh Perëndinë, mirëpo fakti që e mbizotëron këtë është se *Ai më njeh mua.*”² Ne jemi të gdhendur në pëllëmbët e duarve të Perëndisë dhe asnjëherë larg nga sytë hyjnorë. E gjithë njohuria jonë për Perëndinë varet në iniciativën e pandërprerë të Perëndisë

për të na njohur neve. Ne e njohim Perëndinë sepse ai na njohu i pari dhe vazhdon të na njeh.

Njohja e vërtetë e vetes fillon me sytë nga Perëndia dhe të kuptojmë se si Perëndia na sheh neve. Kur e bazojmë njohjen e vetes në njohurinë e Perëndisë për ne, atëherë rrënjosemi në realitet. Kjo na rrënjos edhe në Perëndinë.

NJOHJA E VETES SI SHUMË TË DASHUR

Pyetja është, si ndihet Perëndia me ju? Sa ju njeh Perëndia juve?

Një grua e re më tha njëherë se ndihet e frikësuar sepse ishte e sigurt se Perëndia është i zemëruar me të. Ajo mendonte se Perëndia është i brengosur për mëkatet dhe gabimet e saj dhe e shikon atë me zemërim dhe me turp. A ka të drejtë ajo?

Po mendoja edhe për një shok timin i cili nuk beson më se Perëndia ka një interesim personal për njerëzimin. Si një nga miliarda njerëzit në rruzullin tokësor, ai dyshon nëse ai vetë dhe të gjithë ne të tjerët jemi të regjistruar në ndërgjegjen e Perëndisë. Ai më thotë se do të dëshironte të besonte se Perëndia e do por nuk mund të bindet se kjo gjë është e mundur. A ka të drejtë ai?

Unë jam i bindur se Perëndia e do secilin prej nesh me thellësinë, këmbënguljen dhe intensitetin të cilin ne as që mund ta paramendojmë. Perëndia nuk është se vetëm ju pëlqen. Nuk është se Perëndia ka vetëm disa ndjenja ngrohtësie ndaj jush për shkak se jeni krijuar në shëmbëllimin hyjnor. E vërteta është se Perëndia ju do me një dashuri që Hanah Hurnard e quan “interesim i zhytur në pasion.”³ Perëndia nuk mundet ndryshe veçse t’ju shohë përmes syve të dashurisë.

Është edhe më e jashtëzakonshme kur shohim se dashuria e Perëndisë nuk ndërlihet aspak me sjelljen tuaj. As besimi i pakët e as mungesa e besimit nuk e ulë dashurinë hyjnore

për ju për as edhe një shkallë. Ashtu sikurse dashuria e atit në shëmbëlltyrën e djalit plangëprishës, dashuria hyjnore është krejtësisht e pakusht, e pakufi dhe plotësisht ekstravagante.

Të krishterët e pohojnë një lloj themeli të identitetit që është unik në “tregun” e besimeve. Nuk ka rëndësi nëse e kuptojmë apo jo, qenia jonë është e rrënjosur në dashurinë e Perëndisë. Dashuria krijuese e Perëndisë është origjina jonë. Dashuria e Perëndisë që na rrethon, e mban ekzistencën tonë. Dashuria e pashuar e Perëndisë është e vetmja shpresë për përmbushjen tonë. Dashuria është identiteti dhe thirrja jonë sepse jemi fëmijë të Dashurisë. Të krijuar nga dashuria, në dashuri dhe për dashuri, ekzistenca jonë nuk ka kuptim pa dashurinë hyjnore.

As njohja e Perëndisë e as njohja e vetes nuk mund të përparojnë aq shumë nëse nuk fillon me njohjen e asaj se sa shumë duhemi nga Perëndia. Derisa nuk guxojmë të besojmë se *asgjë* nuk mund të na ndajë nga dashuria e Perëndisë, asgjë që ne do të mund të bënim apo të dështonim e as ndonjë gjë që mund ta bëjnë të tjerët ndaj nesh (Romakëve 8:31-39), atëherë ne ngelim në klasat e para të shkollës së transformimit shpirtëror të krishterë.⁴

Në mënyrë që njohuria jonë për dashurinë e Perëndisë të jetë me të vërtetë transformuese, ajo duhet të bëhet baza e identitetit tonë. Identiteti ynë është ajo që ndiejmë se jemi, “Uni” që është brenda secilit prej nesh. Identiteti i rrënjosur në Perëndinë nënkupton që kur ne mendojmë se kush jemi, gjëja e parë që do të na vinte në mendje është statusi ynë si persona shumë të dashur nga Perëndia.

Me trishtim e rrëfej se sa rrallë më ndodh kjo. Edhe pse gjithmonë kam dashur të mos njihem për shkak të rolit tim profesional, kur më kërkohet të prezantoj veten, unë jam i prirë të shkoj drejt praktikës së zakonshme sociale që të vë në pah arritjet profesionale. Mirëpo, nëse shkoj edhe më thellë, kur vetëbesimi im kërcënohet dhe ndjehem sikur identiteti

im është paksa i cënueshëm, reagimi im i parë pothuajse automatik është të mendoj për të arriturat apo projektet e se kaluarës ose të ardhmes. Mësimi që nxjerr nga kjo është se, më shumë sesa që jam i vetëdijshëm, identiteti im është i bazuar në atë që bëj e jo në atë që jam.

Krishti përfaqëson një kontrast të dhimbshëm me këtë. Identiteti i Tij ishte i definuar nga marrëdhënia e Tij me Atin. Ky ishte Ai. E tërë jeta e Tij ishte e drejtuar nga kjo. Ajo që Ai bënte nuk ishte baza e identitetit të tij por vetëm e theksonte se kush Ai ishte: "...sepse veprat që Ati më ka dhënë të përmbush, po ato vepra që bëj unë, dëshmojnë për mua, se Ati më ka dërguar" (Gjoni 5:36).

Gjatë pagëzimit të tij, Jezusi dëgjoi një deklaratë hyjnore të dashurisë ndaj tij si Biri me të cilin Perëndia ishte shumë i kënaqur (Mateu 3:17). Dukej se Jezusi nuk dyshoi asnjëherë në këtë gjë. Marrëdhënia e Tij me Atin ishte bazë se si e përjetonte dhe e kuptonte Ai veten. Ai ishte një me Atin në dashuri, Perëndia ishte në Të dhe Ai ishte në Perëndinë (Gjoni 14:11). Asgjë nuk ishte më e sigurt për të sesa dashuria e Atit të Tij, dashuri që e dinte se kishte ekzistuar qysh para krijimit të botës (Gjoni 17:24). Bërja e vullnetit të Atit të tij buroi nga kjo marrëdhënie dashurie që ishte edhe baza e identitetit të tij.

Edhe kur Jezusi u ndje sikur Ati e kishte braktisur në Kopshtin e Gecemanit, besimi i Tij për dashurinë e Atit ishte aq i fortë sa Ai ende donte ta bënte vullnetin e Atit e jo të tijin. Jezusi e dinte se Ai e kishte dashurinë e Perëndisë pavarësisht a e *ndjente* apo jo. Identiteti i Tij ishte i rrënjësuar në Perëndinë.

Mirëpo në rast se e zini veten duke menduar se, *patjetër që Perëndia e donte Jezusin, tek e fundit Ai ishte Jezusi*, atëherë do të ishte e dobishme të rikujtonim se Bibla është e mbushur me shembuj të tjerë që tregojnë se si njohja e dashurisë së Perëndisë e transformon jetën e dikujt. Për shembull, gruaja samaritane e cila e takoi Jezusin tek pusi (Gjoni 4:7-30), ishte e përjashtuar nga judenjtë por u befasua nga trajtimi që Jezusi

i bëri. Në vend se t'i shmangej ai u afrua tek ajo, biseda me të dhe madje të kërkonte diçka nga ajo duhet ta ketë befasuar atë shumë. Madje edhe pas vënies në pah të dështimeve të saj morale, nuk ndodhi ajo çfarë pritej. Ai nuk e qortoi. Ai madje nuk i tha as shko e mos mëkato më. Përkundrazi, pasi ia zbuloi vetveten e saj, ia zbuloi edhe vetveten e Tij duke ia shfaqur identitetin e tij si Mesia.

Zbulesa zakonisht fillon, sikurse edhe në rastin e kësaj gruaje, kur Perëndia na e shfaq vetveten tonë. Vetëm atëherë Perëndia na e zbulon personin Hyjnor para nesh.

E prekur nga dashuria e përsosur, ajo nuk do të ishte më i njëjti person. Ajo ishte takuar me Zotin.

Njohja dhe besimi i dashurisë së Perëndisë është një proces që zgjat gjithë jetën. Duke e bërë këtë njohuri themelin e identitetit tonë, apo më mirë, duke lejuar që identiteti ynë të ri-formësohet rreth këtij fakti themelor të ekzistencës sonë – megjithatë nuk do të ndodhë kurrë menjëherë. Të dyja këto gjenden në thelbin e transformimit shpirtëror që është edhe rezultat i pritur i ndjekjes së Krishtit.

Sa herë guxoj të takoj Perëndinë në cenueshmërinë e mëkatit dhe turp të tim, kjo njohuri forcohet. Sa herë hyj në zgafellen e përmirësimit të vetvetes dhe përpiqem të sjell para Perëndisë vetveten time më të mirë, njohuria dobësohet. Unë e njoh dashurinë hyjnore të pakusht, radikale dhe guximtare për mua vetëm kur guxoj t'i afrohem Perëndisë ashtu siç jam. Sa më shumë që kam guxim të takoj Perëndinë në dobësinë time aq më shumë e njoh veten si të vërtetë dhe shumë të dashur nga Perëndia. Sa më shumë që e njoh këtë dashuri aq më e lehtë do të jetë t'i besoj asaj ashtu siç bëri Krishti, duke e parapëlqyer më shumë vullnetin e Perëndisë sesa timin.

Lëreni anash librin për pak çaste dhe mendoni mbi njohuritë tuaja për dashurinë e Perëndisë. Sa e formëson kjo njohuri themelin e identitetit tuaj? Në çfarë mënyre e përjetoni

dashurinë Hyjnore? Si e dini që ajo dashuri është e vërtetë edhe kur nuk e përjetoni?

Nëse nuk ju pëlqejnë përgjigjet e këtyre pyetjeve, apo nëse ndiheni të ngujuar në këtë aspekt të rrugëtimit, thuaja Perëndisë sa shumë ke dëshirë të njohësh dashurinë e përkryer. Lutuni para Perëndisë që t'ju drejtojë tek dikush me të cilin mund të ndani këtë dëshirë, dikush që ka pjekuri shpirtërore që të ecë bashkë me ju teksa përpiqeni të njihni dashurinë e Perëndisë me anë të përjetimit.

Zhvendosja e të vërtetave si “Perëndia më do” nga koka tek zemra jonë është shpesh e vështirë. Është e mundur, mirëpo vetëm duke e bërë rrugëtimin bashkë me të tjerët. Perëndia që është një bashkësi hyjnore njihet vetëm përmes bashkësisë njerëzore. Njohja e thellë e dashurisë së përkryer, ashtu si njohja e thellë e vetvetes, kërkon që ne të jemi në marrëdhënie të shoqërisë shpirtërore.⁵ Askush nuk duhet të presë që mund të bëjë rrugëtimin i vetëm. Njohja e vetes dhe Perëndisë siç e kam përshkruar në këto faqe varet nga shoqërimi që të tjerët na bëjnë gjatë rrugëtimit tonë për tek zemra e Perëndisë.

NJOHJA E PJESËS TËNDE TË INJORUAR

Njohja e vërtetë transformuese e vetvetes gjithmonë përfshin ballafaqimin dhe përqaqimin e pjesëve të padëshiruara të vetes më parë. Teksa përpiqemi të mendojmë se ne jemi një person i vetëm dhe i unifikuar, ajo që ne e quajmë “Uni” është në të vërtetë një familje e shumë pjesëve të vetes. Në vetvete, ky nuk është problemi. Problemi qëndron në faktin se shumica e këtyre pjesëve të vetes janë të panjohura për ne. Edhe pse zakonisht ato janë të njohura për të tjerët, ne jemi të pavetëdijshëm për ekzistencën e tyre.

Të thuhet se jemi një familje e shumë pjesëve të vetes nuk është e njëjtë si të thuash se luajmë role të ndryshme. Shumica

nga ne e dimë çka do të thotë të jesh shok, punëmarrës, anëtar i kishës e ndoshta edhe prind e bashkëshort-e. Secili prej këtyre roleve është i ndryshëm dhe shumica nga ne lëvizim në mes të këtyre roleve pa shumë mund. Ky nuk është problemi.

Problemi është se ka aspekte të rëndësishme të përjetimit tonë që ne i injorojmë. Shumica nga ne, ashtu si ajo gruaja që përmendëm në kapitullin dy, refuzojmë të përballemi me ndjenjat tona të turpërta. Ato na bëjnë të ndihemi shumë të cënueshëm. Kështu që shtiremi sikur ato ndjenja nuk ekzistojnë dhe shpresojmë se do të largohen. Mund të ndodh që përpiqemi ta mohojmë edhe veten tonë të thyer apo të lënduar. Kur bëjmë një gjë të tillë, këto pjesë të padëshiruara të vetes nuk largohen. Ato thjesht fshihen brenda nesh.

Për shembull, nëse unë e njoh vetëm veten time të fortë dhe kompetente dhe nëse nuk jam në gjendje të ballafaqohem asnjëherë me veten time të dobët dhe të pasigurt, atëherë jam i shtyrë të jetoj në gënjeshtëri. Duhet të shtirem sikur *jam* i fortë dhe kompetent, jo vetëm se *kam* pjesë të forta apo kompetente ose në rrethana të caktuara unë *mund të jem* i fortë dhe kompetent. Pra, nëse refuzoj të përballem me veten time mashtruese, unë jetoj në një iluzion sa i përket integritetit tim. Ose nëse nuk kam vullnet të pranoj veten time krenare, jetoj në një iluzion të modestisë së rreme.

Është një vlerë e çmueshme nëse arrijmë të emërtojmë dhe të njohim këto pjesë të përjashtuara të vetes. Vetja argëtuese, vetja e kujdesshme, vetja ekspozuese, vetja tërheqëse, vetja garuese dhe fytyra të tjera të vetes sime janë pjesë të miat, pa marrë parasysh nëse unë e pranoj praninë e tyre apo jo. Kushtëzimi i fuqishëm në fëmijëri na nxit të pranojmë vetëm pjesët më të pranueshme të vetes. Pjesët e vetes të cilave nuk u jepet hapësirë në sofrën familjare bëhen më të fuqishme, jo më të dobëta. Duke funksionuar jashtë vëmendjes dhe ndërgjegjes sonë, ato kanë ndikim të madh në sjelljen tonë.

Ana shpirtërore e krishterë kërkon që ne të pranojmë të gjitha pjesët e vetes sonë, t'i ekspozojmë ato para dashurisë së Perëndisë dhe t'ia lejojmë atij të punojë me to në personin e ri që po krijon tek ne. Që kjo të ndodh, ne duhet të kemi vullnet t'i mirëpresim këto pjesë të lëna anash dhe t'i konsiderojmë si anëtarë të plotë të familjes së vetvetes, t'i japim hapësirë brenda sofrës së familjes dhe ngadalë t'ia lejojmë të zbuten dhe të shërohen nga dashuria dhe të integrohen në personin në të cilin po shndërrohem.

NGA VETJA TEK PERËNDIA

Për të ilustruar këtë proces të njohjes së vetvetes dhe pranimit të pjesëve të padëshiruara të vetes si dhe mënyrën se si kjo mund të na dërgojë tek njohja e Perëndisë, më lejoni të tregoj historinë e dikujt që do ta quaj Judith.

E takova Judith-ën si studente te kursi që po ligjëroja në Kolegjin Universitar St. Michael, një nga kolegjet Katolike të lidhura me Universitetin e Torontos. Kursi për Psikologji dhe Anën Shpirtërore të Krishterë ishte i hapur për të gjithë pesëdhjetë e pesë mijë studentët e vitit të parë të universitetit dhe ishte çdo herë interesante të shihja kush regjistrohej. Judith e prezantoi veten pas ligjëratës së parë duke e identifikuar veten si hebreje e cila ishte rrugës për t'u bërë e krishterë.

Judith ishte rritur në një shtëpi sekulare hebreje. Ajo më tha se të jesh hebre është më shumë çështje etnie sesa religjioze. Kjo e fundit nuk i kishte zgjuar ndonjë interes deri para pak kohe. Ajo që kishte zgjuar interes ishte njohja e vetes. Përveç diplomës në psikologji ajo kishte mbajtur edhe seanca të psikanalizës për disa vite dhe përmes këtyre ajo kishte arritur të njohte vetveten në thellësi. Ajo më tregoi për guximin që kishte fituar teksa kishte mësuar të ballafaqohej me pjesët e frikshme të vetvetes, në veçanti për anën seksuale. Ajo

më tregoi edhe për lirinë që kishte për t'i dashur të tjerët dhe me të vërtetë kishte rezultuar të ishte vetvetja. Mirëpo ajo që më tërhoqi vëmendjen ishte deklarata e saj se puna me një psikoanalist hebre agnostik e kishte drejtuar drejt krishterimit.

Interesimi i Judith-it për Perëndinë filloi për shkak se analistët psikik të saj vazhdimisht e inkurajuan që të ballafaqohej me të vërtetën. Ajo tha se kjo ishte motoja e saj terapeutike. Teksa mësoi të ballafaqohej me të vërtetën për veten, ajo u vetëdijesua për dëshirat shpirtërore që kishin fjetur për kohë të gjatë apo ishin të pa zbuluara. Hapi i parë për t'iu përgjigjur kësaj ishte të zbulonte anën shpirtërore të judaizmit duke shkuar në sinagoga dhe filloi të lexonte disa nga shkrimet e judaizmit. Pas një kohe në këtë rrugëtim, ajo lexoi diçka për jetën e Terezës së Avilës dhe kjo zgjoi interesin e saj për krishterimin. Pasi lexoi *Brendësinë e Kështjellës së Terezës*, ajo filloi të lexojë sa më shumë që mundi letërsi klasike për anën shpirtërore të krishterë. Kjo ishte koha kur vendosi të regjistrohej në kursin tim.

Më pas Judith u kthye në të krishterë. Kur filloi të njohë dhe të dojë Perëndinë që së pari kishte filluar ta shihte në jetën e shenjtorëve të krishterë, njohuria e saj për vetveten u rrit. Edhe më e mrekullueshme ishte mënyra si e zbuloi që Perëndia e pranoi në tërësinë e saj dhe kjo e ndihmoi punën që ishte duke bërë në psikanalizë. Edhe analistët e saj folën për këtë gjë. Ballafaqimi me pjesët e vështira të jetës së saj në praninë e Perëndisë dhe kur e kuptoi se Perëndia e pranoi siç ishte i dha guxim që ngadalë të ndalojë ndrydhjen që ia kishte bërë anës së saj seksuale. Pak nga pak ajo guxoi që pjesët e turpshme dhe të vështira të jetës së saj t'i sjellë përpara dashurisë së Perëndisë dhe pak nga pak ajo arriti të njohë më thellë edhe veten edhe Perëndinë.

Historia e Judithit nuk është më e pazakontë sesa që duket. Të gjithë njerëzit janë krijuar si qenie shpirtërore që kanë shumë

dëshirë të gjejnë identitetin e tyre në Perëndinë. Ata që duan me të vërtetë të njohin veten patjetër se do të ballafaqohen me këto dëshira dhe do të ballafaqohen me zgjedhje se si do t'i përgjigjen atyre. Njohja e thellë e vetvetes na jep mundësi të njohim thellë edhe Perëndinë ashtu sikur njohja e thellë e Perëndisë na jep mundësi të njohim vetën më mirë. Na del të jetë ashtu si edhe tha John Calvin.

PRANIMI DHE NJOHJA E VETES

Kur ia lejoj Perëndisë të më pranojë ashtu siç jam, kjo më ndihmon të pranoj edhe unë veten në të njëjtën mënyrë. Kjo është thelbësore në transformimin e vërtetë shpirtëror.

Pranimi dhe njohja e vetes janë shumë të ndërlidhura. Që të njohësh me të vërtetë diçka për veten atëherë duhet ta pranosh veten. Edhe ato gjëra brenda vetes që dëshiron me të vërtetë t'i ndryshosh, së pari duhet të pranohen dhe madje të përqafohen. Transformimi i vetvetes gjithmonë paraprihet nga pranimi i vetvetes. Dhe vetja që duhet ta pranoni është në fakt vetja që ju jeni me të vërtetë, *para se të filloni projektin e përmirësimit të vetvetes*.

Çdo shpresë se ju mund ta njihni veten pa i pranuar gjërat brenda jush, për të cilat do të dëshironit të mos ishin të vërteta, është një iluzion. Realiteti duhet të pranohet para se ai të mund të ndryshohet. Njohja e vetes nga ana e jonë do të mbetet sipërfaqësore deri sa të jemi në gjendje të pranojmë veten ashtu siç na pranon Perëndia, në tërësinë tonë dhe pa kushte, ashtu siç jemi.

Pranimi ynë nga ana e Perëndisë ashtu siç jemi, nuk është në asnjë formë në konflikt me dëshirën hyjnore për tërësinë tonë. Nuk është as pranimi i vetvetes nga ana jonë. Mirëpo derisa të mos jemi të gatshëm të pranojmë veten ashtu siç jemi, ne bllokojmë veprën transformuese të Perëndisë për të na shndërruar në veten e vërtetë që është e fshehur brenda

Perëndisë. Duhet të jemi miq me veten që mundohemi ta njohim. Duhet ta pranojmë me mikpritje jo me armiqësi. Asnjë njohje, as ajo e vetes, nuk mund të arrihet pa një mikpritje të tillë.

Më lejoni ta ilustruj këtë duke u rikthyer tek historia e Pjetrit. Nuk besoj se tradhtia e tij ndaj Jezusit ishte hera e parë kur ai u ballafaqua me frikën e cila ishte prapa këtij akti. Jam pothuajse i sigurt se ai e ka gjetur veten në situata kur frika e ka bërë të stepet nga ndonjë veprim që ka dashur të ndërmarrë. Përveç nëse i ka ndrydhur tërësisht këto përjetime sepse përndryshe do të ishte në gjendje t'i rikujtonte. Megjithatë, posedimi i një informacioni të tillë për veten nuk do të ishte i njëjtë me njohjen e vërtetë të vetes.

Dallimi qëndron tek pranimi i vetes. Derisa nuk jemi të gatshëm të pranojmë të vërtetat e pakëndshme të ekzistencës sonë, ne gjithmonë e arsyetojmë apo e mohojmë përgjegjësinë për sjelljen tonë. Andaj, duke refuzuar të ballafaqohesh dhe ta pranojë frikën dhe druajtjen, Pjetri ndoshta, i ka shmangur veprimet frikacake duke u përqendruar tek rrethanat. Ka mundur ta ndjek të njëjtën strategji edhe pas mohimit të Jezusit. Ndoshta kjo është ajo që Jezusi është përpjekur të vë në pah duke folur publikisht për mohimin e Pjetrit. Mirëpo zgjedhja se a duhet të pranohet realiteti dhe vetvetja i takonte Pjetrit dhe vetëm atij.

Nëse Perëndia ju do dhe ju pranon si mëkatarë, si nuk mund ta pranoni ju një gjë të tillë? Ju kurrë nuk mund të jeni ndryshe nga ata që jeni derisa nuk jeni të gatshëm të pranoni realitetin e asaj që jeni. Vetëm atëherë mund të shndërroheni në atë që jeni thirrur të jeni.

Disa të krishterë mërzhiten shumë kur dëgjojnë të thuhet se pranimi i vetvetes duhet t'i paraprijë transformimit. Ata argumentojnë se pranimi i vetes është plotësisht e kundërta e asaj që duhet të bëjmë me pjesët e vetes që nuk e nderojnë Perëndinë. Ata thonë se ajo që duhet të bëjmë është që t'i kryqëzojmë këto gjëra dhe jo t'i pranojmë.

Shkrimet duken mjaft të qarta rreth rëndësisë së kryqëzimit të natyrës sonë mëkatore (Romakëve 8:13). Mirëpo, përpjekjet për të eliminuar ato që gjejmë brenda vetes dhe që fillimisht nuk i pranojmë si pjesë tonat i takojnë më shumë mohimit e jo kryqëzimit. Kryqëzimi duhet të jetë i drejtuar më shumë kah natyra jonë mëkatore. Dhe duhet ta pranojmë fillimisht si natyrë *tonën* e jo thjesht natyrë *njerëzore*. Vetëm pasi të kemi njohur dhe pranuar gjithçka kemi gjetur brenda vetes vetëm atëherë mund të fillojmë të zhvillojmë të kuptuarin se çka duhet të kryqëzohet dhe çka duhet të pranohet si pjesë e jona.

Frojdi ka thënë se gjërat rreth vetes që ne refuzojmë t'i pranojmë marrin fuqi të mëdha dhe ndikim nga dështimi ynë për t'i pranuar. Ai shtoi se ato gjëra që ne i shmangim do të na shtypin më shumë. Pranimi i vetvetes nuk e rrit fuqinë e gjërave që kanë nevojë të eliminohen, mirëpo në fakt pranimi i dobëson ato. Kjo ndodh sepse ato zhvishen nga fuqia që kanë zhvilluar, kur operojnë jashtë vetëdijes dhe kur ne e pranojmë veten.

Para se ta dorëzojmë veten ne duhet të bëhemi vetja, sepse askush nuk mund të dorëzojë diçka që fillimisht nuk e ka.⁶ Jezusi e thotë kështu: “nëse je i kënaqur vetëm më të qenit vetvetja, do të bëheni më shumë se vetvetja” (Luka 18:14, parafrazim). Para se të mund të bëhemi vetvetja ne duhet ta pranojmë vetveten, ashtu siç jemi. Pranimi i vetvetes gjithmonë i paraprin vet-dorëzimit dhe vet-transformimit.

KËRKIMI I ÇELËSIT SHPIRTËROR

Nasradini⁷, protagonist i shumicës së tregimeve popullore të Lindjes së Mesme, Greqisë dhe Rusisë, një natë ishte duke iu afruar derës së shtëpisë së tij kur papritmas e kuptoi se e kishte humbur çelësin. U mundua ta kërkonte aty rrotull mirëpo ishte errësirë aq e madhe saqë mezi e shihte tokën. Kështu që ai ra përtokë me duar e këmbë dhe po kërkonte

në vendin ku ishte duke qëndruar. Mirëpo prapë ishte shumë errësirë dhe nuk shihej gjë. Ai eci mbrapa dhe arriti tek një dritë e rrugës dhe sërish ra në gjunjë dhe filloi të kërkonte më me kujdes rreth e rrotull.

Aty po kalonte një shok i tij dhe kur e pa e pyeti se çka po bënte. Nasradini iu përgjigj: “E kam humbur çelësin dhe po mundohem ta gjej.” Kështu, edhe shoku i tij ra në gjunjë dhe filloi të kërkonte bashkë me të.

Pas një kohe shoku e pyeti: “A të kujtohet ku ke mundur ta humbasësh çelësin?”

“Patjetër” - iu përgjigj Nasradini. “E kam humbur brenda në shtëpi”

“Atëherë pse po e kërkon këtu jashtë?”

“Sepse” - iu përgjigj Nasradini, “ka më shumë dritë këtu jashtë.”

Ne i ngajmë Nasradinit më shumë sesa që duam ta pranojmë. Ne e kërkojmë çelësin e humbur shpirtëror mirëpo mundohemi ta gjejmë atë jashtë vetes ku duket më e lehtë për ta kërkuar. Mirëpo çelësi është brenda, në errësirë.

Jezusi tha: “Por ti, kur lutesh, futu në dhomëzën tënde, mbylle derën dhe lutju Atit tënd në fshehtësi...” (Mateu 6:6). Vendi i fshehtë ku ne e takojmë Perëndinë në mënyrë plotësisht transformuese është vendi brenda nesh. Lutja është takimi me Perëndinë në errësirë dhe të vetëm në vendin e fshehtë. Asgjë tjetër përveç takimit me Perëndinë në thellësinë e shpirtit tonë nuk do të na japë qasje në njohjen e thellë të Perëndisë dhe vetes.

Ajo që e bën të mundur këtë takim është mbajtja e syve tek Perëndia që na shikon neve. Kur e shohim sa shumë na do Perëndia, në thellësinë tonë, kompleksitetin, tërësinë dhe natyrën tonë mëkatore, atëherë guxojmë t'i lëmë Perëndisë qasje më të plotë tek pjesët e errëta të shpirtit tonë që kanë më së shumti nevojë për transformim. Dhe Perëndia na prin në këtë rrugëtim, duke pritur që të na takojë në thellësinë e vetes sonë.

Ta njohësh veten ashtu siç je



Njohja e thellësisë së dashurisë personale të Perëndisë për secilin prej nesh si individë është themeli i njohjes së vërtetë të vetes. Mirëpo ka ende shumë për të mësuar nga reflektimi mbi njohjen e Perëndisë për ne.

Vetja ime që Perëndia e do me këmbëngulje nuk është vetja e zbukuruar që unë pretendoj por vetja e vërtetë, ai që jam. Mirëpo, si mjeshtër i mashtrimit që jam, kam vështirësi të depërtoj brenda rrjetës së mashtrimit të vetes dhe të njoh veten time mirë. Vazhdimisht e përziej këtë me veten time ideale që do të doja të isha.

Rrënjët e vetes sonë të shtirur janë në ngjarjet e fëmijërisë që na thonë se mund të marrim dashuri duke e paraqitur veten sa më mirë që mundemi. Një vajzë e vogël e fsheh urrejtjen për vëllain e saj sepse e di që duhet ta dojë atë. Kjo mungesë e integritetit përforcohet më pas nga prindërit e saj, të cilët e urdhërojnë këtë sjellje me dashuri. Një djalë i ri e mohon fyerjen pas dështimit për të marrë diçka që dëshiron. Duke bërë kështu, ai e bën edhe një hap më përpara drejt humbjes së vetëdijes në lidhje me atë që ndjen me të vërtetë. Thënë shkurt, ne mësojmë të mashtrojmë, dhe paraqitemi ashtu

siç është e rëndësishme për të tjerët dhe injorojmë praninë e të kundërtës.

E gjithë kjo mund të duket e pafajshme. Mirëpo, ne zhvishemi nga pafajësia kur e humbim kontaktin me përjetimin tonë, sepse pafajësia e zvogëlon aftësinë tonë për t'u bazuar në realitet.

Thomas Merton na paralajmëron se: "Nuk ka shkatërrim më të madh në jetën shpirtërore sesa të zhytesh në irealitet, sepse jeta mbahet dhe lulëzon në ne nga marrëdhënia jonë me realitetin."¹ Jeta e vërtetë shpirtërore nuk është largim nga realiteti mirëpo një përkushtim i plotë ndaj tij.

Shumica nga ne janë shumë të gatshëm ta përqafojnë realitetin kur ai përshtatet me mënyrën se si e shohim veten dhe botën edhe kur gjërat nuk janë shumë të pakëndshme. Megjithatë kur përjetimet e jetës sonë na ballafaqojnë me gjërat e jetës që nuk kemi vullnet t'i pranojmë atëherë i zgjojmë mekanizmat mbrojtës psikologjik që të na ndihmojnë të ruajmë ndjenjën e sigurisë dhe stabilitetit. Përderisa këto strategji të pavetëdijshme na ndihmojnë me ballafaqimin afat-shkurtër, ato e bllokojnë rritjen afat-gjatë. Kjo ndodh për shkak se ato e shtrembërojnë realitetin. Në fund të fundit, funksioni i tyre është që të na mbrojnë nga e vërteta e pakëndshme.

Aftësia e njeriut për të mashtruar veten është mahnitëse. Kjo na mësohet në Shkrime (Jeremia 17:9) dhe konfirmohet edhe nga psikologjia. Disa njerëz janë shumë të aftë të mashtrojnë të tjerët. Mirëpo, mashtrimi i tyre zbehet në krahasim me mënyrat e pafundme kreative përmes së cilave secili prej nesh e mashtrojmë veten.

Mashtrimi i vetes ndodh në mënyrë automatike. Kjo është pjesë e asaj që nënkuptojnë psikologët kur thonë se mekanizmat mbrojtës veprojnë në pavetëdije. Kjo është pjesë e asaj që teologët nënkuptojnë kur flasin për mëkatin fillestar. Në të vërtetë ne nuk e zgjedhim mashtrimin e vetes.

Po të përdorim zhargonin bashkëkohor të kompjuterëve, kjo vjen në mënyrë automatike (by default).

Zakonisht jemi mjaft të aftë të dallojmë mashtrimin që të tjerët ia bëjnë vetes. Tek të tjerët ne shumë lehtë vërejmë përqafim të vakët të së mirës si çmim të njohjes së zemërimit dhe fyerjes. Ky është mekanizmi mbrojtës i *formësimit të reagimit*: një ndjenjë apo impuls i papranueshëm eliminohet nga vetëdija jonë duke e shprehur krejtësisht të kundërtën e asaj që ndjejmë. Tek dikush tjetër ne identifikojmë një *justifikim* kur japin arsye për sjelljen e tyre por nuk vërejmë arsyen e vërtetë. Sërish, tek dikush tjetër, mohimi i ndjenjave që janë dukshëm të pranishme tregon formën më bazike të mashtrimit të vetes.

Njohja e të njëjtave gjëra tek vetvetja është shumë e vështirë. Thellësia e mashtrimit tonë është shumë sfiduese. Na duhet një përkushtim i pashoq ndaj të vërtetës dhe të kemi një ndjenjë të thellë lirie nga frika e refuzimit. Asgjë nuk e lehtëson këtë gjë sikurse rehatia e të qenit thellësisht i dashur.

Transformimi shpirtëror përfshin edhe qartësimin e pamjes. Jezusi tha se nëse syri ynë është i pastër, atëherë gjithë trupi ynë do të jetë i ndriçuar (Luka 11:34). Duhet të mësohemi të shohim dhe të pranojmë atë që kemi përpara. Zhveshja nga iluzionet tona është pjesë e këtij procesi sepse na orienton për tek realiteti. Të shohim Perëndinë ashtu siç Ai është, nënkupton se duhet të shohim edhe veten ashtu siç jemi. Sepse e njëjta re e iluzioneve e errëson pamjen si për Perëndinë ashtu edhe për veten.

NJOHJA E VETES SI MËKATAR

Njohja e vetes ashtu siç jemi në të vërtetë na sjellë në mënyrë të paevitueshme para asaj që Bibla e quan mëkat. Nuk kërkohet shumë vetëdije të kuptojmë se ka disa gjëra bazike në ne që nuk janë ashtu siç duhet. Le të flas për veten time.

Unë bëj gjëra që nuk dua t'i bëj dhe më duket vetja i paaftë të bëj ato gjëra që do të doja t'i bëja. Duket se jam i programuar për egoizëm dhe egocentrizëm dhe jo për dashuri. Nëse jam i singertë, duhet ta pranoj se motivi im nuk është çdo herë i pastër dhe fisnik ashtu siç do të doja të ishte. Aftësia për ta njohur potencialin tim si person i krijuar në imazhin e Perëndisë duket se sabotohet nga një agjendë e brendshme mbi të cilën unë nuk kam kontroll. Kjo është pjesë shumë e rëndësishme e asaj se çka nënkupton të jesh mëkatar.

Përjetimet e mia të përditshme më përballin me faktin e dhimbshëm se zemra ime e ka dëgjuar më shumë gjarprin sesa Perëndinë. James Finley thotë me sinqeritetin më të madh se: "Ka diçka brenda meje që vendos gjethe fiku për t'u mbuluar, që vret vëllain, ndërton kulla të ngatërimit dhe që sjell kaos kozmik në tokë. Ka diçka brenda meje që dashuron errësirën në vend të dritës, që refuzon Perëndinë dhe kështu refuzon edhe realitetin më të madh se si një qenie njerëzore jam i krijuar sipas imazhit dhe në ngjasim me Perëndinë."²

Disa të krishterë e bazojnë identitetin e tyre tek fakti se janë mëkatarë. Mendoj se e kanë gabim, ose vetëm gjysmë të drejtë. Ti nuk je thjesht një mëkatar; ti je mëkatar i pranuar plotësisht. E këtu qëndron dallimi më i madh në mes këtyre të dyjave.

Mëkati është një devijim nga statusi ynë parësor si fëmijë shumë të dashur të Perëndisë. Fillimisht ne jemi dashur si krijesa, të krijuar në imazhin e përkryer dhe të pamëkat të krijesit tonë Perëndi. Edhe pse mëkati e ka shkatërruar atë që ka qenë plotësisht e mirë, na ka mundësuar të zbulojmë se dashuria e Perëndisë është dhënë për ne dhe na pranon ashtu siç jemi, si mëkatarë. Renditja është e rëndësishme. Asnjëherë nuk duhet të ngatërrojmë faktin dytësor me të vërtetën parësore.

Njohja e vërtetë e vetes mund të ndodh vetëm atëherë kur e bindim veten se jemi të pranuar dhe të dashur pikërisht

ashtu siç jemi. Fakti se Perëndia na do dhe na pranon si mëkatarë bën të mundur ta pranojmë dhe ta duam veten si mëkatarë. E gjitha fillon me njohjen dhe pranimin e dashurisë së Perëndisë.

Që ta kuptojmë më drejtë, njohja e vetes sonë si mëkatarë duhet të përfshijë më shumë sesa njohjen se në bëjmë mëkate të caktuara. Mëkati është më shumë sesa ajo që bëjmë. Mëkati është ajo që jemi. Në këtë pikë, mund të themi se mëkati është plotësisht çështje e ontologjisë (qenies) e jo thjeshtë e moralit. Të jesh njeri nënkupton se je mëkatar. Nënkupton të jesh i thyer, një qenie e prishur që mbartim thellë në vete një të metë fatale dhe thelbësore, një të metë që maskon krijesën e bukur në të cilën jemi krijuar dhe infekton qenien tonë të vërtetë.

Nëse gjithçka që dimë rreth vetes janë mëkatet specifike që kryejmë atëherë njohja e vetes mbetet sipërfaqësore. Përqendrimi tek mëkatet na çon tek ajo që Dallas Willard e përshkruan si “Ungjilli i menaxhimit të mëkatit”³, një përpjekje për të shmangur mëkatin dhe strategji për t’u marrë me fajin kur kjo pashmangshëm tregohet e pasuksesshme. Mirëpo transformimi shpirtëror i krishterë është më radikal sesa shmangia nga mëkati. Dhe njohja e vetes që kërkohet për këtë lloj transformimi është më e thellë.

Njohja e vetes sonë mëkatore bëhet edhe më e dobishme kur nuk merremi me mëkatin por me thelbin e prirjes sonë për mëkat. Në këtë rast e zhvendosim përqendrimin tonë nga sjellja tek zemra.

ZHVENDOSJA NGA MËKATET TEK ZEMRA E MËKATIT

Stuart-i ishte një pastor që erdhi tek unë për psikoterapi në lidhje me një varësi seksuale. Ai ndihej tmerrësisht fajtor për shikimin e pornografisë për një kohë të gjatë dhe ndihej shumë i pashpresë për ta ndryshuar atë. Pas disa vitesh

rrëfimi të mëkateve, lutjeve për ndihmë dhe pastaj kthimit tek mëkatet e vjetra ai erdhi në përfundim se duhej të largohej nga shërbesa. Mbikëqyrësi i tij e kishte nxitur që të më takonte para se të merrte një vendim përfundimtar. Në depresion dhe me shumë pak shpresë, ai ishte pajtuar.

Veprimet tona të përbashkëta e drejtuan Stuart-in drejt një rrugëtimi të errët dhe të vështirë të kuptimit të vetes. Prapa varësisë seksuale zbuluam një dëshirë për intimitet e jo një rezervuar epshi. Martesa e tij ofronte intimitet të vërtetë po aq sa ai mund të toleronte, mirëpo në fantazi ai kërkonte mënyra për të përjetuar intimitetin që nuk kërkohet nga ai në marrëdhënien e tij të vërtetë. Më e rëndësishmja është se zbuluam një shkallë të lartë të fyerjes dhe një ndjesi të fortë të turpit. Teksa e shqyrtuam këtë gjë, ai u vetëdijesua se meritonte diçka më të mirë sesa ajo që po përjetonte. Kjo ishte pika që na drejtoi për tek thelbi i prirjes për mëkat, që ishte krenaria.

Në thelb, Stuart-i ishte shumë i hidhëruar se askush nuk e kishte kuptuar sa i veçantë ishte. Duke gërmuar në këtë ndjesi, ai ishte në gjendje të gjurmonte deri tek fëmijëria e tij. Ai ishte ndjerë shumë i kontrolluar si pjesë e një familjeje të madhe me gjashtë vëllezër e motra. Ai kishte qenë përgjegjës që të kujdesej për të gjithë por duket se askush nuk e kishte vlerësuar për këtë gjë. Ai kishte qenë edhe personi me arritjet më të mëdha, mirëpo edhe këtu, duket se askush nuk e kishte vënë re këtë gjë.

Stuart i ishte mësuar ta mbulonte fyerjen së bashku me veçantinë e tij me një maskë të përlësisë false. Mirëpo nën këtë shtresë kishte një hidhërim si zjarr që digjet në vetvete. Krenaria i thoshte se ai meritonte një trajtim më të veçantë. Dhe kur nuk e mori këtë trajtim ai gjeti prehje tek dhimbja dhe zemërimi. Si rrjedhojë, kjo e dërgoi tek ndjenja e përjashtimit dhe privimit nga intimiteti. Kjo ishte arsyeja prapa tërheqjes së tij ndaj pornografisë.

Zbulimi se po kërkonte me ngulm për intimitet, jo vetëm kënaqësi seksuale, nuk ishte transformues në vetvete për Stuart-in. Megjithatë, pranimi i djaloshit të vogël me nevojë emocionale i cili kërkonte dashuri por edhe kishte frikë të dashuronte, ishte hap i rëndë. Ballafaqimi i krenarisë thellë brenda tij me ndjenjën e pranimit ishte jashtëzakonisht i vështirë. Mirëpo Stuart-i filloi të gjente lirinë vetëm kur e pranoi veten ashtu siç e kuptoi se pranohej nga Perëndia, edhe përkundër mëkatit të tij.

Stuart-i na e ilustron se si pranimi i vërtetë sjell qartësi dhe mprehtësi për natyrën e problemeve tona. Ai ishte munduar me vite që të kryqëzonte dëshirat e tij seksuale duke qenë i bindur se ato ishin thelbi i problemit të tij. Mirëpo në vend se ta kryqëzonte anën e tij seksuale ai duhej ta pranonte atë, t'ia hapte dyert me mikpritje kësaj pjesë të rëndësishme të tij dhe t'ia lejonte të integrohej brenda fabrikës së madhe të vetvetes. Ai duhej ta mirëpriste këtë pjesë të pabindur të vetes e cila ishte egërsuar për shkak të shumë viteve në mërgim. E trajtuar si armike, ana e tij seksuale kishte filluar të funksiononte si armike. Mirëpo kur e pranoi se ai nuk ishte një përbindësh seksual, por vetëm një mashkull normal me nevoja normale seksuale, atëherë nevojat seksuale duket se u zmbrapsën në fuqi dhe dominim.

Zbulimi i thelbit të prirjeve tona për mëkat është i dobishëm sepse na mundëson të merremi me problemet tona dhe rrënjën e tyre, porse më shumë se kjo, është e dobishme sepse zbulimi i thelbit të prirjeve tona për mëkat do të na mbush me dëshpërim dhe mungesë të shpresës saqë nuk do të kemi mundësi tjetër përveç kthimit tek Perëndia. Transformimi shpirtëror nuk vjen si rezultat i rregullimit të problemeve tona. Ajo vjen nga kthimi tek Perëndia në mes të problemeve dhe ballafaqimi me Perëndinë ashtu siç jemi. Kthimi tek Perëndia është thelbi i lutjes. Kthimi tek Perëndia kur jemi në mëkat dhe turp është zemra e transformimit shpirtëror.

Pjesa më e rëndësishme e punës sime me Stuart-in ishte ta ndihmoja të ndihej mjaftueshëm i lirë nga gjykimi që rrezikonte sinjeritetin dhe vetëdijen. Disa prej zbulimeve të tij për vetveten bënë që ai menjëherë të ndihej me shpresë. Ai filloi të ndihej kështu kur filloi të kuptojë natyrën joseksuale të varësisë së tij nga pornografia. Duke e parë këtë gjë në një dritë plotësisht të re i dha atij një optimizëm të ri sepse iu sugjerua një mënyrë e re e qasjes që ishte shndërruar në problem të pazgjidhshëm. Mirëpo zbulimet tjera, veçanërisht vetëdija e re për ndjenjën e fyerjes dhe thelbin e krenarisë bënë që ai të ndihej i mbingarkuar, i poshtëruar dhe i pa shpresë. Këto gjëra dukej se vinin nga aq thellë brenda tij saqë dukej se nuk do të ishte në gjendje të bënte diçka për t'i ndrequr ato.

Ky vëzhgim ishte një dhunti e vërtetë. Sepse ia mundësoi atij të ballafaqohej me Perëndinë aty ku Perëndia tashmë po priste ta ballafaqonte, në thelbin e thyerjes dhe mëkatit të tij.

NDIHMA ANTIKE PËR NJOHJEN E THELLË TË MËKATITONË

Një mjet që për shumë njerëz ka qenë i dobishëm për identifikimin e prirjeve bazike për mëkat është qasja antike e njohjes së personalitetit e quajtur Eneagram⁴. Për ndryshim nga klasifikimet e personalitetit që bazohen në tipare⁵, parimi organizativ i Eneagramit është më i thellë dhe më pak tërheqës. Ai përqendrohet tek e meta fatale, ose mëkati bazë i të nëntë llojeve të personalitetit. Askush nuk duhet të punojë me Eneagram nëse ajo që kërkojnë është lajka. Por askush nuk duhet të mos e bëjë nëse ajo që kërkojnë është njohja e thellë e vetvetes.

Natyra jonë mëkatore asnjëherë nuk mund të thjeshtohet në një tundim. Mirëpo supozimi prapa Eneagramit është se shkakut themelor i çdo gjëje që bëjmë është një tundim

i madh që është i posaçëm vetëm për ne. Dhe derisa nuk e shohim ashtu siç është, ne do të biem në këtë tundim dhe do të jetojmë të kapluar nga ai.

Mëkatet thelbësore të identifikuara nga Eneagrami janë të lidhura me një nevojë thelbësore.⁶ Nevojat janë gjëra bazike njerëzore si nevoja për dashuri, për siguri apo për mbrojtje. Mëkati paraqitet kur këto nevoja i shndërrojmë në diçka me vlerë thelbësore, do të thotë i barazojmë me Perëndinë.

- Njëshi, ka nevojë të jetë i përkryer dhe zbulimi se as ata e as diçka tjetër në këtë botë nuk është e përkryer sjell tundimin e vendosjes së drejtësisë me zemërim. Shembulli më i mirë biblik për këtë lloj personi është Pali.
- Dyshi, ka nevojë të dashurohet dhe të ndihet i nevojshëm, andaj aftësia e tyre për ta shtyrë këtë të ndodhë sjell deri tek krenaria. Marta është shembulli më i mirë i dyshit.
- Treshi, ka nevojë të jetë i suksesshëm dhe tundohet të mashtrojë, sepse bën çdo gjë që është e mundur që të mos dështojë dhe të paraqitet si është më së miri. Jakobi ilustron këtë personalitet.
- Katërsi, ka nevojë të jetë i veçantë dhe tundohet me lakmi, fantazi të ikjes dhe kompromisit me autenticitetin. Jozefi, patriarku nga Dhiata e Vjetër, ilustron këtë personalitet.
- Pesëshi, ka nevojë për njohuri, dëshirë për përmbushje dhe tundohet për lakmi, koprraci dhe veçim. Toma, i ashtuquajti dishepulli dyshues, i përshtatet këtij personaliteti.
- Gjashtëshi, ka nevojë për siguri dhe tundohet nga frika, dyshimi në vete dhe mungesa e guximit. Timoteu është shembull i mirë i gjashtëshit.
- Shtatëshi, ka nevojë të shmangë dhimbjen dhe tundohet nga grykësia dhe moskokëçarja. Solomoni është shembulli biblik i këtij personaliteti.

- Tetëshi, ka nevojë për fuqi, vetë-mbështetje dhe mundësi për të qenë kundër diçkaje dhe tundohet nga epshi, arroganca dhe dëshira për të pasur nën posedim dhe kontroll të tjerët. Mbreti Saul është ilustrim i mirë i tetëshit.
- Nëntëshi, ka nevojë të ruajë paqen emocionale dhe shmang iniciativën, andaj tundohet nga dembelia, iluzionet e rehatisë dhe mos prishjes së qejfit. Jona ilustron këtë personalitet.

Për herë të parë e zbulova Eneagramin në vitin 1988, gjatë një periudhe të punës intensive me anën shpirtërore personale. Siç ndodh shpesh, lloji i parë që identifikova teksa përpiquesha ta gjeja veten brenda sistemit, ishte gabim.⁷ I paaftë të përballesha me të vërtetat më të thella të vetes, u identifikova me disa nga tiparet sipërfaqësore që ishin të vërteta për mua, por nuk ishin të vërtetat më thelbësore.

Në gjuhën e Eneagramit, fillimisht mendova se jam pesëshi. Mëkati thelbësor i këtij personaliteti është lakmia dhe isha në gjendje të vëreja, edhe përkundër mohimit të madh të kësaj, unë në fakt motivohesha dukshëm nga lakmia. Shumë aspekte të personalitetit të pesëshit përshtateshin plotësisht me mua. Këta njerëz mundohen të jetojnë jetën të udhëhequr nga koka, të shikojnë jetën me veçim, objektivitet dhe mprehtësi. Me një uri të paepur për njohuri, dëshira e tyre për të kuptuar botën dhe veten është e papërmbajtshme. Megjithatë, kjo i largon ata nga intimiteti me të tjerët dhe me njohjen e vërtetë dhe të thellë të vetes. Të gjitha këto më përshtaten mua. Por, duke u identifikuar me këtë personalitet, unë po e mbroja veten nga një ballafaqim më i dhimbshëm me prirjet e mia të vërteta për mëkat.

Një personalitet tjetër në të cilin ndihesha sikur përshtatesha ishte njëshi. Në këtë pikë të jetës, sapo kisha filluar të kuptoja dhe të ballafaqohesha me zemërimin, e zemërimi është mëkati kryesor i njëshit. Unë e identifikova veten edhe me tundimin kryesor të të qenit i përkryer dhe bërjes së gjërave të drejta me arsye të gabuar. Padyshim se kisha një fije

moralisti brenda meje edhe pse mundohesha shumë ta mbaja nën fre. Mund ta identifikoja veten edhe me prirjen për t'u bërë shumë serioz, punëtor dhe i përgjegjshëm. Më dukej se përshtatesha relativisht mirë me këtë personalitet.

Ndihesha edhe sikur po e gjeja veten pak edhe tek dyshi, ku mëkati kryesor është krenaria dhe ku tundimi më i madh është lajka dhe përpjekja për të qenë i dobishëm e që në fund të fundit më shumë është vetëshërbim sesa e kundërta. Nevoja e tyre për t'u pëlqyer nga të tjerët, i shtyn dyshët të manipulojnë me të tjerët dhe në një formë apo në një tjetër të kërkojnë ndihmë nga ta. Në përgjithësi, ky personalitet i kontrollon të tjerët duke i kënaqur ata. Shumë nga këto gjëra dukeshin sikur përshtateshin mjaft mirë me mua.

Mirëpo, edhe pse, deri diku ne të gjithë përshtatemi me të nëntë personalitetet, "përshtatja mjaftë e mirë" nënkupton se nuk keni qenë në gjendje të përballeni me rrënjët e iluzionit dhe mëkatit themelor. Reflektimi im edhe me lutje rreth asaj që po mësoja për veten me anë të Eneagramit, më zbuloi se personaliteti në të cilin unë me të vërtetë përshtatem është Treshi. Ashtu siç ndodh çdoherë kur e gjen personalitetin e vërtetë brenda Eneagramit, fillimisht u ndjeva shumë i poshtëruar. Si guxoja ta emëroja mëkatin tim thelbësor si mashtrim? Sa i gatshëm isha të pranoja secilin nga tetë mëkatet tjera thelbësore. Sa i zbuluar ndihesha papritmas.

Treshët nuk janë domosdoshmërisht gënjeshtarë. Është thjesht për shkak të frikës nga dështimi që na bën të kemi prirje që t'i tjerim gjërat sa më shumë që mundemi. Si pasojë nuk jemi asnjëherë aq të shëndetshëm, kompetentë apo diçka tjetër që vlerësojmë. Ky është thelbi i mashtrimit. Ne gjithashtu adhurojmë efikasitetin e faltores dhe zakonisht jemi shumë të zotë të matim me këtë kriter suksesin e vendosur vetë. Paraqitja e jashtme ka rëndësi për Treshët. Ne nuk themi aq shumë gënjeshtër sa jetojmë me to. Obobo, e dija se e kisha gjetur personalitetin tim, modelin tim të mëkatit.

E vërteta është se asnjë nga këto personalitete nuk është më i keq apo më mëkatar se tjetri. Dhe asnjëri nuk është më larg shpengimit se tjetri. Derisa lloji i personalitetit tonë dhe tundimi thelbësor për mëkat duket se mbetet konstant për gjithë jetën, nuk ka dyshim se mund të ecim përpara drejt një lirie dhe tërësie brenda kornizës së asaj që jemi. Ky është procesi i transformimit shpirtëror.

Transformimi shpirtëror, e jo njohja e vetes, është qëllimi i anës shpirtërore të krishterë. Me ndihmën e Perëndisë ne duhet të thyejmë iluzionet tona dhe ta shohim veten ashtu siç jemi në relacion me Perëndinë.

Njohja e plotë e vetvetes në relacion me Perëndinë përfshin dijeninë e tri gjërave: dijeninë se jemi të dashur nga Perëndia (temë e trajtuar në kapitullin tre), dijeninë se jemi mëkatarë (tema e këtij kapitulli) dhe dijeninë se jemi në proces të shpengimit dhe restaurimit (që do të diskutohet në kapitullin gjashtë). Ballafaqimi me këto të vërteta të mëdha për veten bën të mundur që të pranojmë dhe të njohim veten ashtu siç jemi të pranuar dhe të njohur nga Perëndia.

REFLEKTIMI NË LUTJE

Njohja e vërtetë e vetes ashtu siç ju njeh Perëndia mund të jetë e frikshme. Mirëpo nëse Perëndia ju njeh dhe ende ju do shumë, atëherë ka shpresë se edhe ju mund ta bëni të njëjtën gjë. Njohja e vërtetë e vetes i ofrohet atyre që (1) e duan me të vërtetë këtë gjë, (2) që janë të gatshëm të reflektojnë në lutje për përjetimet e tyre dhe (3) që kanë guximin të ballafaqohen me veten dhe Perëndinë në fshehtësi.

Nëse njohja e vetes është e kufizuar, atëherë reflektoni në lutje se në cilat nga këto tre parakushte keni mangësi. Nëse keni uri ta njihni veten më thellësisht atëherë vazhdoni me rishikimin ditor në lutje, siç sugjerova në kapitullin dy. Gjithashtu, shihni se kur mund të jeni vetëm me veten dhe

me Perëndinë. Këto kohë me veten dhe Perëndinë mund të jenë në ritmin tuaj javor por mbase janë të mbushura me shpërqendrim për t'ju mbajtur larg vetmisë. Disa njerëz e mbajnë muzikën lëshuar sa herë që janë vetëm. Të tjerë ndezin kompjuterin, televizionin apo telefonat e tyre që shërbejnë për qëllim të zbavitjes. Mundësitë për të shmangur vetminë janë të panumërta.

Pas reflektimit në lutje për të identifikuar mënyrat që përdorim për të shmangur vetminë, bëni besëlidhje me Perëndinë dhe veten që të ndani një kohë kur thjesht do të jeni vetëm me Perëndinë në thellësitë e vetes suaj. Mos bëni ndonjë agjendë për këtë kohë përveç qëndrimit me Perëndinë në qetësi.

Filloni me një lutje të thjeshtë ku i kërkonti Perëndisë t'ju ndihmojë të jeni të përqendruar. Mos u ndjeni sikur patjetër duhet ta mbushni këtë kohë me fjalë dhe mendime, vetëm qëndroni në qetësi dhe besoni se jeni në praninë e Perëndisë qoftë nëse e ndjeni apo jo.

Në fund të kësaj kohe, jo gjatë saj, shënojeni përjetimin tuaj në ditar. Shënoni mendimet, reagimet, dhe ndjenjat dhe dorëzojani Perëndisë. Qëllimi nuk është t'i analizoni por t'i identifikoni dhe t'i dorëzoni. Vini re çka po përjetoni dhe dorëzojani Perëndisë. Njohja e vetes është dhuratë e Perëndisë, jo rezultat i analizës së vetvetes. Mbajeni mend, kjo nuk është terapi e vetvetes. Kjo do të thotë të kaloni kohë me Perëndinë dhe ta lejoni Perëndinë t'ju takojë dhe t'ju ndihmojë të njihni veten ashtu siç njiheni nga ai.

Nuk ka zëvendësim të takimit me Perëndinë në thellësinë tuaj nëse me të vërtetë e dëshironi këtë njohje. Lutja që ta shihni veten ashtu si ju sheh Perëndia ju jep guxim. Mirëpo nëse kjo bëhet me sigurinë e plotë se vetja që po kërkonti ta njihni tashmë njihet dhe dashurohet nga Perëndia, e bënë këtë gjë më të mundur. Dhe mbajeni mend, Perëndia dëshiron t'ju takojë me dashuri transformuese në thellësinë tuaj.

Demaskimi i vetvetes së rreme



Ideali i autenticitetit është pothuajse i ngjashëm me idealin e perfeksionit. Ne të gjithë ia kemi idenë e asaj se çka flasim edhe pse mund të mos e kemi përjetuar personalisht një gjë.

Ajo që dimë nga përjetimet personale është se si të kapemi pas asaj që mendojmë se është mundësia më e mirë për përmbushje personale. Ne të gjithë kërkojmë një mënyrë të drejtë që na drejton tek lumturia. Realiteti është se jo të gjitha rrugët janë po aq autentike. Nëse ka një mënyrë të drejtë që është e vërtetë për mua atëherë padyshim se ka plot të tjera që janë të rreme.

Çdo gjë që është e rreme rreth nesh del nga besimi se lumturia jonë më e madhe do të vjen duke jetuar jetën në mënyrën tonë dhe jo në mënyrën e Perëndisë. Edhe pse mund të themi se duam t'i besojmë Perëndisë dhe t'i dorëzohemi vullnetit të tij, thellë në zemrat tona ne kemi dyshime nëse Perëndia është në gjendje të na sigurojë lumturinë.

STILI PERSONAL

Shumica nga ne mësojmë si të kujdesemi për nevojat dhe kënaqësitë tona që nga vitet e para të jetës. Ne e zhvillojmë

atë që Thomas Keating e quan program emocional personal.¹ Ky është plani ynë për t'u përballur me jetën dhe për të arritur lumturinë. Është edhe hamendësimi ynë më i mirë se çka duhet të bëjmë në mënyrë që të ndihemi mirë me veten. Kjo është edhe strategjia jonë për të përmbushur nevojën bazike për dashuri, mbijetesë, fuqi dhe kontroll.

Stili ynë kryesor shpesh është i ndërtuar rreth gjërave që na forcojnë si fëmijë. Zakonisht fillon me gjërat që i bëjmë mirë. Me kalimin e kohës repertoari i kompetencave tona rritet dhe mësohemi të jetojmë në një lloj mënyre që mendojmë se funksionon për ne. Kjo bëhet “mënyra jonë” apo thjesht ajo që mendojmë se jemi.

Problemi nuk është se disa gjëra i bëjmë siç duhet dhe se posedojmë aftësi dhe cilësi që na bëjnë të veçantë. Problemi qëndron tek investimi i tepruar që bëjmë për këtë imazh dhe mënyrë jetese.

Në thelb të vetes së rreme (false) është dëshira për të ruajtur një imazh të vetes dhe një mënyrë që na lidh me botën. Ky është stili ynë personal, se si e mendojmë veten dhe si duam që të tjerët të na shohin dhe të mendojnë për ne. Unë mund të kem një imazh për veten si person i arsyeshëm dhe i kujdesshëm. Ky është thelbi i stilit bazë. Në anën tjetër tipari im më i mirë mund të jetë pamja fizike, intelijenca apo sensi i humorit. Apo mund të ndodh që investimi im është në një imazh të dikujt që është i dashur, artistik, i paparashikueshëm, kreativ, elegant, i hutuar, serioz, shpirtëror apo edhe impulsiv. Zakonisht tiparin që e çmojmë më shumë është në fakt pjesë e asaj që jemi. Mirëpo e vërteta është se ky tipar është vetëm një nga shumë të tjerë. Kur një tipar shndërrohet në thelbin e qenies sonë atëherë jemi duke jetuar në gënjeshtëri.

Vetja jonë e rreme është ndërtuar mbi një shtojcë të tepruar të imazhit të vetvetes që ne mendojmë se na bën të veçantë. Problemi është te shtojca, dhe jo fakti se kemi cilësi që na

bëjnë unikë. Richard Rohr sugjeron se pyetja bazë që duhet të bëjmë është a jemi të përgatitur të jemi dikush tjetër përveç imazhit të cilin e kemi krijuar për veten.² Nëse jo atëherë do të jetojmë në skllavëri të vetes sonë të rreme.

Si shembull të kësaj jete në skllavëri të vetes së rreme mund të merrni Saulin para konvertimit dhe identitetin e tij të ri si Pal. Ambicioz, me zellin fanatik dhe vrasës i pamëshirshëm, Sauli ishte tmerri i të krishterëve të shekullit të parë. Veprat e Apostujve e përshkruajnë si një person që punoi për shkatërrimin e tërësishëm të kishës, duke shkuar shtëpi më shtëpi për të arrestuar ndjekësit e Krishtit dhe duke i dërguar në burg apo ekzekutim (Veprat e Apostujve 8:1-3).

Falsiteti i Saulit mund të shihet qartë nën dritën e asaj që ishte e vërtetë në Palin. Këmbëngulësia e Palit për urrejtje ishte tregues i një jete jashtë rendit, mirëpo çka nuk funksiononte me të vërtetë? Në retrospektivë do të thosha se ai ishte i nxitur nga ambicia personale.

Sauli po bënte emër për vete. Ai dëshironte të njihej si një personi i cili i vetëm e shpëtoi Judaizmin nga herezia e Krishterimit. Ajo që ndryshoi kur e takoi Krishtin në rrugën për në Damask ishte se talentet e tij shkatërruese dhe niveli i jashtëzakonshëm i pasionit ishin zhvendosur nga mbretëria e vetes tek mbretëria e Perëndisë. Në këtë zhvendosje ai gjeti liri nga tirania e ambicies së tij private. Ai e gjeti veten e tij të vërtetë.

Duke mos qenë i drejtuar më nga urrejtja, ai tani ishte i mbushur me dashuri. Jeta e tij si Pal tregoi vendosmërinë e paepur që mund ta shohim edhe në jetën e tij si Saul. Mirëpo tani nuk ishte ambicia për të lënë shenjë dhe për t'i bërë gjërat në mënyrën e tij, që e shtynte përpara. Por tani ishte dëshira e tij për të arritur atë që vet e përshkruan si çmim të thirrjes së lartme të Perëndisë në Krishtin Jezus (Filipianëve 3:14).

SFIDA E AUTENTICITETIT

Diçka tjetër që dimë nga përvoja është si të fshehim dhe si të shtiremi. Në një pikë të caktuar në fëmijëri ne të gjithë zbulojmë se mund të manipulojmë të vërtetën rreth vetes. Fillimisht kjo merr formën e një gënjeshtre të thjeshtë, kryesisht mohimi se kemi bërë diçka gabim. Mirëpo i një rëndësie më të madhe për të zhvilluar veten e rreme (false) është zbulimi se aftësia jonë për të fshehur gjëra nuk kufizohet vetëm në atë që themi apo nuk themi. Ne mësojmë të shtiremi. E zbulojmë artin e kamuflimit të vetvetes.

Ne mësojmë se edhe pse ndihemi të frikësuar, mund të paraqitemi si të guximshëm. Gjithashtu mësojmë të mbulojmë urrejtjen me dashuri sipërfaqësore, zemërimin me qetësi dhe indiferencën me simpati. Thënë shkurt, mësojmë të paraqesim veten në mënyrën më të mirë, një mënyrë e dizajnuar për të krijuar përshtypje të mirë dhe të ruajë vetëvlerësimin.

Edhe pse kjo mund të duket e mirë, ana e errët e shtirjes është se ajo që fillon si rol bëhet më vonë identitet. Fillimisht maskat që vendosim reflektojnë atë se si duam që të na shohin të tjerët. Me kalimin e kohës, këto maska reflektojnë se si duam ne ta shohim veten. Mirëpo, kur arrijmë këtu, jemi konfuz se cila është maska dhe cili përjetimi real. Maskat tashmë janë bërë realiteti ynë dhe ne kemi rënë pre e gënjeshtreve tona. Thënë shkurt, e kemi humbur autenticitetin dhe kemi adoptuar një identitet të bazuar në iluzion. Jemi shndërruar në një dhomë të mbushur me tym dhe pasqyra.

Ekzistojnë vetëm disa gjëra që janë më vështirë për t'i dalluar dhe për t'i zhveshur sesa iluzionet tona më të dashura. Asnjë iluzion i yni nuk është më vështirë për t'u identifikuar sesa ato që gjinden në zemër të vetvetes sonë të rreme (false). Vetja jonë e rreme është sikurse ajri që thithim. Jemi ambientuar aq shumë me praninë e falsitetit sa që nuk e vëmë re më.

Është i pakapshëm sikurse era, që zhduket sapo vëmendja kthehet dhe ndriçon në drejtim të saj.

Shpresa e vetme për të demaskuar falsitetin që banon në thelb të qenies sonë është një ballafaqim radikal me të vërtetën. Asgjë përveç të vërtetës nuk është mjaftueshëm e fuqishme për të çrrënjosur iluzionin. Vetëm Shpirti i të Vërtetës mund të na shpëtojë nga pasojat e dëgjimit të gjarprit në vend të Perëndisë.

DËGJIMI I GJARPRIT

Ngjarja nga Zanafilla rreth tundimit të Adamit dhe Evës na ndihmon të kuptojmë se si shndërrohemi në gënjeshtër që zgjedhim të besojmë. Historia na paraqet një gjarpër, i cili duke njohur prindërit tanë të parë dëshiroi të bëhej sikurse Perëndia, dhe ia ofroi edhe atyre një mënyrë për ta arritur këtë. Dëshira për t'u bërë si Perëndia nuk ishte problemi në vetvete. Sepse Perëndia i kishte krijuar sipas imazhit Hyjnor dhe donte që ata të ngjasonin me Perëndinë. Megjithatë, dhuntia e ngjasimit me Perëndinë ishte ndryshe nga ajo që i ofroi mashtruesi.

Thelbi i gënjeshtres që Adami dhe Eva besuan ishte se ata mund të bëheshin sikurse Perëndia pa Perëndinë përreth. Mirëpo pa Perëndinë, e vetmja gjë që mund të bëhemi është të shndërrojmë veten në perëndi. E vërteta është se nuk mund të bëhemi sikurse Perëndia duke e rrëmbyer autoritetin dhe sovranitetin Hyjnor. James Finley e përshkruan kështu:

“Çdo shprehje e ngjasimit të vet-shpallur me Perëndinë është i ndaluar për ne, jo sepse thyen rëndë ndonjë ligj të dekretuar nga Perëndia por sepse një veprim i tillë është i barasvlershëm me gënjeshtërën fundamentale, vdekjeprurëse dhe ontologjike. Ne nuk jemi Perëndia. Ne nuk jemi origjina jonë dhe as nuk jemi vetëpërmbushja përfundimtare. Kur deklarojmë se jemi të tillë ne kryejmë një akt vetëvrasjeje që

lëndon marrëdhënien tonë të besimit me Perëndinë e gjallë dhe e zëvendëson këtë marrëdhënie me besim të kotë në vetvete që nuk mund të ekzistojë asnjëherë.”³

Në mënyrë paradoksale, Adami dhe Eva e morën atë që deshën, të ishin si Perëndia pa Perëndinë aty, ngjasim që bazohej në pavarësi dhe jo në dorëzim. Pikërisht kjo është arsyeja pse duhet të jemi të kujdesshëm se çka dëshirojmë. Sepse mund ta marrim.

Megjithatë, ajo që marrim kur vendosim një mënyrë jetese të ndarë nga Perëndia është jetë e mbushur me gënjeshtëri. Është gënjeshtëri sepse autonomia që premtohet është një iluzion. Nuk lirohemi nga Perëndia duke shpërfillur vullnetin hyjnor. Përkundrazi, me anë të kësaj shpërfilljeje ne i modelojmë zinxhirët e skllavërisë sonë.

Ajo që marrim kur vendosim të jetojmë të ndarë nga Perëndia është jeta e vetes së rreme (false). Ajo që Sauli mori kur vendosi të jetojë në mënyrën e vet dhe jo sipas asaj të Perëndisë ishte vetja, kuptimi i të cilës varej nga arritja e veprave heroike, që ishte shkatërrimi i kishës. Ajo që Stuart (për të cilin fola në kapitullin katër) mori ishte një ndjenjë iluzioni i të qenit i veçantë, i bazuar në kënaqësinë që i jepte pornografia.

Vetja e rreme është rezultati tragjik i përpjekjes për të vjedhur diçka nga Perëndia e që nuk kemi pasur nevojë ta vjedhim. Po të kishim guxuar të besojmë mirësinë e Perëndisë, do të kishim zbuluar se çdo gjë që do të kishim kërkuar do të ishte e jona në Perëndinë. Duke u përpjekur të fitojmë diçka më shumë sesa që ofron Perëndia, në përfundojmë me më pak sesa asgjë. Duke refuzuar Perëndinë, përfundojmë me një grumbull gënjeshtresh dhe iluzionesh. Duke e zëvendësuar Perëndinë, ne bëhemi perëndi i vetes. Atëherë shndërrohemi në veten e rreme.

PËRBALLJA ME LAKURIQËSINË

Me refuzimin e vetes që është krijuar në ngjasim me Perëndinë, vetja jonë e rreme (false) është ajo që ne krijojmë në ngjasimin tonë. Ky është personi që ne do të donim të ishte, personi i krijuar nga vetë ne, personi që do të kishim krijuar po të ishim Perëndi. Por një person i tillë nuk mund të ekzistojë sepse ai apo ajo është një iluzion.

Bazimi i identitetit në iluzion ka pasoja të rënda. Duke ndjerë mungesën thelbësore të realitetit, vetja jonë e rreme e mbështjell vetveten me përjetime, përjetimin e fuqisë, kënaqësisë dhe nderit. Duke e ditur se kjo nuk është asgjë përveç se një hije, ne përpiqemi të bindim veten për realitetin duke e barazuar atë me vepra dhe arritje. Basil Pennington thotë se thelbi i vetes së rreme është besimi se vlera ime varet nga ajo që kam, çka mund të bëj dhe çka mendojnë të tjerët për mua.⁴ Thomas Merton e përshkruan këtë si “përjetime gjarpëruese përreth meje...si mbështjellës që e bëjnë veten time të pranueshëm para meje dhe para botës, sikur të isha një trup i padukshëm që bëhet i dukshëm vetëm kur diçka e dukshme e mbulon sipërfaqen e saj.”⁵

Për shkak se është e zbrazët në thelb, jeta e vetes së rreme është një jetë e mbushur me shtojca të tepërta. Duke u përpjekur që të shmangë shpërthimin e brendshëm dhe cenimin e qenies, vetja e rreme kërkon diçka që duket se ka substancë dhe pastaj mbërthen ato gjëra me ngulmin e një njeriu që po fundoset në ujë dhe që e shtrëngon gomën e shpëtimit. Disa persona mund të mbërthejnë pasurinë tyre, arritjet apo hapësirën. Disa të tjerë mund të kapen pas ëndrrave, kujtimeve apo miqësive. Secila nga këto mund të jetë ose bekim ose mallkim. Ato janë bekim kur mbahen me duart e hapura të mirënjohjes. Kurse shndërrohen në mallkim kur mbahen nën kthetrat e pronësisë dhe shihen si “unë” apo “e imja”.

Sauli mbahej pas zellit dhe forcës së vullnetit. Kjo tingëllon si tipike për Eneagramin e llojit Një ku bënte pjesë edhe ai dhe pas konvertimit ai e përshkruan këtë gjë si dëshirë për të fituar përsosmërinë me anë të fuqisë së përpjekjeve (Filipianëve 3:6-9). Sa çlirim duhet të ketë qenë për të kur e zëvendësoi përsosmërinë që kishte kërkuar përmes veprave me “përsosmërinë që vjen nga besimi në Krishtin, prej Perëndisë” (Filipianëve 3:9).

Ne i mendojmë këto gjëra shtesë si spiranca të mirëqenies. Ndihe mi mirë kur jemi të rrethuar nga ato që duken si privilegje dhe mendojmë se na japin një kënaqësi e cila nuk do të ishte pjesë e jona nëse nuk i kemi ato privilegje. Në realitet, ato sabotojnë lumturinë tonë dhe janë helmuese qoftë për shëndetin tonë shpirtëror qoftë për atë psikologjik.

Gjërat që ne i shtojmë minojnë lirinë tonë, dukë bërë që lumturia dhe gëzimi ynë të varen nga prania e tyre. Nëse “privilegjet” e mia janë të rrethuara nga pajisjet e fundit teknologjike, atëherë ndihem mirë sa herë që marrë një pajisje të re dhe nuk ndihem mirë kur e shoh një version më të ri në treg dhe nuk mund ta blej. Gjërat që ia shtoj stilit, elegancës apo shijes së mirë veprojnë në të njëjtën mënyrë duke bërë që lumturia ime të varet nga gjërat e jashtme. Gjërat që ne i shtojmë na burgosin në falsitet pasi vrapojmë pas sirenave flakëruese të dëshirave.

Nga ana shpirtërore, shtojcat shërbejnë edhe si idhuj: ne investojmë në objekte dhe përjetime kur duhet të investojmë vetëm në Perëndinë. Çdo gjë pas së cilës mbahemi ka marrë vlerë më të madhe sesa që duhet, vlerë e cila është vjedhur nga Perëndia.

Përfundimisht, shtojcat janë mënyra për të përballuar ndjenjën e cenueshmërisë, turpit dhe pamjaftueshmërisë që gjinden në thelb të mënyrës sonë të rreme të jetesës. Sikurse Adami dhe Eva, reagimi ynë i parë ndaj lakuriqësisë është të rrëmbejmë çfarëdo që gjejmë afër dhe ta mbulojmë shpejtë

lakuriqësinë tonë. Ne fshihemi pas gjetheve të fikut të vetes sonë të rreme. Kjo është mënyra si e kamuflojmë veten për t'i ikur vetëdijes së dhimbshme të lakuriqësisë sonë.

Problemi me veten e rreme është se ajo funksionon. Na ndihmon të harrojmë se jemi lakuriq. Nuk kalon shumë kohë dhe ne më nuk jemi të vetëdijshëm për cenueshmërinë që kemi përbrenda dhe rehatohemi me këtë gjë.

Mirëpo Perëndia dëshiron diçka më të mirë sesa gjethet e fikut për ne. Perëndia do që ne të jemi të vetëdijshëm për pafuqinë tonë dhe të dimë se kemi nevojë për ndihmën Hyjnore. Dëshira më e madhe e Perëndisë është që ne të zëvendësojmë gjethet e fikut me veshje të qëndrueshme dhe të bukura (Zanafilla 3:21). Megjithatë, ne kapemi pas vetes së rreme me gjethë fiku. Ne besojmë që dimë të kujdesemi për veten më mirë sesa Perëndia.

TA DALLOSH VETEN E RREME

Derisa gjërat që të tjerët i shtojnë vetes dhe falsiteti personal i tyre shpesh duken qartë, për ne nuk është kurrë e lehtë të dallojmë gënjeshttrat në jetën tonë. Megjithatë, ka disa shenja të besueshme, nëse guxojmë të jemi mjaftueshëm të sinqertë të ballafaqohemi me to.

Njëra nga to është dëshira për t'u mbrojtur. Për shkak se nuk jetojmë në realitet, vetja e rreme ka nevojë për përkrahje të vazhdueshme. Sedra jonë vazhdimisht na drejton kah mënyrat false të jetesës. Dhe sa më shumë gabime të kesh aq më shumë investon në mbrojtjen e vetes së rreme.

Disa njerëz thyhen lehtë nëse nuk merren seriozisht, duke mos i marrë parasysh nevojat e të tjerëve vetëm për të vënë në pah rëndësinë e tyre, që për ta është mjaft e dukshme. Të tjerë e marrin veten seriozisht, ndoshta sepse nuk janë gati të qeshin me veten. Të dyja reagimet kërkojnë krekosje. Ka të tjerë që janë mësuar të maskojnë

këto prezantime publike të vetëmbrojtjes, mirëpo reagimet e brendshme të bezdisë dhe acarimit ende shfaqin praninë e vetes së rreme.

Asnjëherë nuk më ka pëlqyer të më thërrasin Dave. Ndonjëherë i korrigjoj njerëzit që më thërrasin kështu. Shumë shpesh ia kujtoj vetes se sa i parëndësishëm është ky fakt dhe mundohem ta injoroj acarimin. Pyetja që ia bëj vetes është: pse po e bëj kaq të madhe punën e një bashkëtingëlloreje në fund të emrit.

Përgjigja për këtë gjendet thellë në veten time të rreme. Unë them: emri David duket se përshtatet më shumë me imazhin serioz që dua të paraqes. Dave më duket më i zakonshëm dhe i rëndomtë, mbase edhe shumë i familjarizuar. Në dëshirën për të rritur rëndësinë e vetes që lidhet me veten time të rreme, dua të jem unik dhe dua të jem i rëndësishëm. Nuk dua të kënaqem vetëm me të qenit i zakonshëm.

Kështu funksionon vetja e rreme. Lëndimi është i parashikueshëm. Ndjenja e të qenit i parëndësishëm është karakteristika më e fortë. Gjërat që na pengojnë më së shumti tek të tjerët, ato që na bezdisin, edhe ato nxjerrin në pah falsitetin tek vetja jonë. Lëmishtja që më bezdis në jetën e dikujt tjetër është pothuajse çdoherë sa trau në syrin tim (Mateu 7:3).

Nëse dembelia e të tjerëve është ajo që më bezdis, ka shumë mundësi që disiplina dhe performanca formojnë pjesën kryesore të vetes sime të rreme që e ruaj me ngulm. Nëse është loja dhe spontaniteti i të tjerëve që më pengojnë, atëherë serioziteti mund të jetë pjesa kryesore të cilën e mbroj dhe që mundohem ta paraqes para të tjerëve. Nëse është mungesa e moralit që më acaron tek të tjerët, atëherë mbase vetja ime është e ndërtuar rreth moralit dhe drejtësisë. Dhe nëse e përçmoj anën emocionale të të tjerëve, atëherë kontrolli emocional është kryesor për skenarin që kam zgjedhur ta jetoj.

Një e dhënë tjetër rreth natyrës së vetes sonë të rreme është se sa rrekemi pas diçkaje. Secili person është i prirë të rreket pas diçkaje dhe shumica nga ne mendojmë se pikërisht kjo është karakteristika që na duhet më së shumti. Dikush mund të kërkojë me ngulm suksesin apo respektin, ndërsa të tjerë ndoshta investojnë të njëjtën energji për të shmangur dhimbjen dhe pakënaqësinë emocionale. Nuk ka asgjë të gabuar në asnjërën nga këto. Problemi me rrekjen pas një gjëje është se paraqet një shtesë të tepërt. Rrekja shpesh përmban një të mirë që barazohet me të mirën supreme me anë të rëndësisë së tepërt që ne i shtojmë.

Përsosmëria mund të jetë e dëshirueshme nëse mirëpritet si vepër e Perëndisë në ne, por jo si rezultat i përpjekjeve të shumta që njerëzit si Sauli përpiqen t'i bëjnë për ta arritur atë. Dashuria është po ashtu një e mirë e padiskutueshme, mirëpo përpjekja e vazhdueshme për t'u dashur që karakterizon të tjerët reflekton mohimin e anës së tyre njerëzore dhe çdoherë paguhet me humbje të autenticitetit. Ngjashëm edhe suksesi, bukuria, dija, siguria, kënaqësia, vetë-mbështetja dhe lumturia janë gjëra të mira por jo e mira supreme në të cilën i shndërrojmë kur investojmë në to pavend.

Funksioni më bazik i rrekjes pas gjërave është që të na ndihmojë të ruajmë veten tonë të rreme. Mirëpo, mbajtja e këtij iluzioni është burimi i gjithë palumturisë sonë. Ashtu si e vuri re Basil Pennington, palumturia është çdo herë rezultat i "të mos qenit në gjendje të bëj diçka që dua të bëj, të mos kem diçka që dua të kem apo rezultat i merakut se çka do të mendojnë të tjerët për mua."⁶ Kjo na qon sërish tek thelbi i vetes së rreme, vendosja e vlerës sime në atë që kam, çka mund të bëj dhe çka mendojnë të tjerët për mua.

ILUZIONI I VETES SË RREME

Ndoshta një ilustrim do të na ndihmonte të qartësonim mënyrën e rreme të jetesës. Edhe pse më me dëshirë do të tregoja historinë e dikujt tjetër, atë timen e di më së miri.

Rrënja e vetes sime të rreme ishte zbulimi i fëmijërisë së duke qenë djalë i mirë mund të fitoja dashuri. Natyrisht, më mori pak kohë të mësoja si ta interpretoja “të mirën”. Vetja e rreme kurrë nuk zhvillohet brenda një nate. Megjithatë, me kalimin e kohës bashkëveprimi i dinamikave të familjes sime me ato të personalitetit tim ofruan shumë mënyra për të mbështjellë veten time të zhveshur dhe të cenueshme me shtresa të njëpasnjëshme të arritjeve për të tërhequr dashuri.

Problemi ishte se këto strategji funksionuan. Sa më shumë që arrija, aq më shumë duket se njerëzit më pëlqenin. Si rrjedhojë, unë shndërrohesha çdoherë e më shumë në djalin performues që mendoja se njerëzit e pëlqenin. Kjo më dha një distancë me humnerën e të ndjerit i parëndësishëm. Ajo që ishte më e rëndësishme është se më dha një mënyrë jetesë jo vetëm si dikushi por si dikush i veçantë. Por, tragjikisht, më pamundësoi zbulimin e asaj se sa pëlqehesha nga të tjerët pa u munduar të dukesh mirë. Kjo me vendosi në një garë për të treguar veten.

Pranimi i dashurisë përmes arritjeve të më të varur nga përgjigjet e paqëndrueshme të të tjerëve. Kur i hedh sytë prapa, duket se kisha vuajtur pak teksa kalova nga kërkimi i dashurisë tek kërkimi i respektit, diçka që në mënyrë të pavetëdijshme e kisha kuptuar se dashurinë e kisha më se të sigurt. Përderisa dashuria jepet falas, respekti fitohet.

Investimi im i gjatë për të qenë i respektuar nga të tjerët ka qenë përpjekje për të kontrolluar ambientin tim përreth dhe për të garantuar ndjenjën e veçantisë ndaj të cilës isha bërë i varur. Robëria që sjell vetja e rreme është robëri e detyrimit për të jetuar në iluzion. Unë nuk jam vetëm një djalë që i arrin lehtë gjërat. Unë nuk identifikohem me arritjet e mia. Gjërat që mund t'i bëj ose i kam bërë nuk më bëjnë të veçantë. Në

fakt, përpjekja për të definuar veten në bazë të arritjeve të mia është mjaft e mërzitshme.

Vrapimi me ngulm pas arritjeve dhe respektit të njerëzve që janë të rëndësishëm për mua ka ngulfatur jetën e vetes sime të vërtetë. Këto lidhin dhe pengojnë rritjen time dhe kufizojnë lirinë. Është e rëndësishme që unë t'ia kujtoj vetes se jam qenie njerëzore, dhe jo vepër njerëzore. Vlera ime matet me atë se kush jam, jo se çka mund të bëj apo si shihem nga të tjerët. Kjo është e vërteta e ekzistencës sime.

BETEJA HYJNORE ME VETEN E RREME

Nëse Jezusi ishte ashtu siç besojnë të krishterët, plotësisht njeri dhe plotësisht Perëndi, edhe ai duhej të luftonte me veten e rreme. Edhe ai duhet të ketë qenë i tunduar nga mënyrat e rreme të jetesës dhe nga shtojcat e panevojshme në stilin personal. Në aspektin e tij njerëzor, identiteti i tij në dashurinë e Atit mund të mos ketë qenë i qartë nga momenti i parë i vetëdijes si fëmijë. Ai duhej të gjente veten dhe duke u munduar ta bënte këtë duhet të ketë qenë i tunduar nga mënyrat e shumta të rreme për të jetuar jetën e tij.

E dimë se kjo ka qenë e vërtetë sepse kemi regjistrime të disa prej këtyre tundimeve. Pennington thotë se ngjarja e mirënjohur e tundimit të Jezusit në shkretëtirë (Mateu 4:1-11) kuptohet ndryshe edhe si luftë me tri natyrat potencialisht të rreme brenda vetes.⁷

Pas katërdhjetë ditësh agjërimit, Jezusi duhet të ketë qenë shumë i uritur. Përpjekja e parë e tunduesit për ta joshur ishte ta kthente gurin në bukë, tundimi për të poseduar fuqi. Mirëpo, Jezusi i tha jo ftesës për të krijuar identitetin e tij duke u bazuar në vepra, veçanërisht duke bërë diçka që ishte i pavarur nga nënshtrimi ndaj autoritetit të Perëndisë. Pennington citon se Jezusi kishte “ushqim më të mirë”, Fjalën e Perëndisë (Mateu 4:4).

Më pas, tunduesi e ftoi të hidhej nga maja e tempullit në turmat që ishin poshtë, në mënyrë që ata ta pranonin menjëherë si Mesian. Sërish, Jezusi e refuzoi tundimin. Ai zgjodhi të mos e bazojë identitetin e tij në prestigj. Duke vepruar kështu ai hodhi edhe një hap më tutje drejt themelimit të identitetit të tij në Atin e jo në atë që mendonin njerëzit për të.

Në fund, tunduesi i ofroi atij të gjitha mbretëritë e botës. Por, edhe një herë, Jezusi e refuzoi ofertën duke refuzuar të gjejë identitetin e tij në gjëra që posedon. Ai e njihte veten në aspektin e varfërisë në shpirt dhe vullnetit me plot dashuri të Perëndisë. Andaj, ai e dinte se ky ishte një zëvendësim i dobët.

Jezusi e dinte se kush ishte në Perëndinë. Prandaj ai mund t'i rezistonte tundimit për të jetuar në veten e rreme të bazuar në fuqi, prestigj dhe gjërat që posedonte. Duke i rezistuar këtyre mënyrave të rreme të jetesës, Jezusi po shkonte drejt një identiteti të rrënjosur në marrëdhënien e tij me Atin, identitet në të cilin u bë e qartë thirrja e tij sepse e kuptoi se kush ishte në të vërtetë.

TË DALIM NGA VENDI I FSHEHUR

Në çdo çast të secilës ditë të jetës sonë, Perëndia endet nëpër kopshtin brenda nesh duke kërkuar shoqëri. Arsyeja pse Perëndia nuk mund të na gjejë është se ne fshihemi prapa shkurreve të vetes sonë të rreme. Thirrja e Perëndisë për ne është e butë dhe e vazhdueshme: “Ku je? Pse po fshihesh?”

Sa më shumë që identifikohemi me veten e konstruktuar në mënyrë psikologjike dhe sociale aq më shumë fshihemi nga Perëndia, nga vetja dhe të tjerët. Mirëpo për shkak të natyrës iluzive të vetes së rreme, shumicën e kohës ne nuk jemi të vetëdijshëm se po fshihemi. Të dalësh nga vendi i fshehur kërkon që ne të pranojmë gjërat që na cenojnë, të cilat na kanë detyruar të kërkojmë mbulesë. Përderisa mundohemi

të shtiremi se gjërat nuk janë ashtu siç janë, atëherë ne zgjedhim të jetojmë në gënjeshtëri. Hapi i parë i daljes nga shkurrja është gjithmonë hapi i të qenit i singërtë me veten.

Ne të gjithë priremi të modelojmë një perëndi që i përshtatet falsitetit tonë. Nëse vetja ime e rreme është ndërtuar mbi imazhin e moralit, unë do të mundohem ta përforcoj këtë duke e hedhur Perëndinë në të njëjtën anë. Nëse investimi im është përqendruar në prezantimin e vetes si tekanjosh, spontan dhe shakatar është pothuajse e pashmangshme që të paraqes një pamje të Perëndisë që është e pikturuar me po këto ngjyra. Duke e krijuar fillimisht veten sipas imazhit që e kemi formuar vetë, ne mundohemi që më pas të krijojmë një perëndi që në fakt mund të na krijojë neve. Deri këtu mbërrin perversiteti i vetes së rreme.

Kur zbulohemi ose dalim në dritë, atëherë e pranojmë Perëndinë sipas kushteve të Tij. Kjo është rruga e vetme drejt të qenit vetja jonë unike në Krishtin.

Nëse kjo është dëshira jote, merr pak kohë dhe bëji dy gjëra. Së pari, kërkoji Perëndisë që të ndihmojë të kuptosh se çka të bën të ndihesh i cënueshëm dhe që të bën të kërkossh mbulesë. Mund të jetë konflikti. Ose ndoshta është dështimi, dhimbja, çrregullimi emocional apo humbja e fytyrës. Lejojani vetes të ndjeni shqetësimin që do ishte në ju nëse nuk i shmangeni këtyre gjërave. Pastaj, duke dëgjuar ftesën e Perëndisë që të dilni nga shkurrja në të cilën jeni fshehur, bëjeni hapin dhe lejojani Perëndisë t'ju përqafojë ashtu siç jeni.

Se dyti, reflektoni në lutje mbi imazhin e vetes suaj ndaj të cilit jeni i/e dhënë më së shumti. Mendoni se si do të donit ta mendonit veten, për çka jeni më së shumti krenarë. Kërkoni Perëndisë të ju ndihmojë të shihni mënyrat që përdorni për të mbrojtur ndjenjat e cënueshmërisë. Pastaj, kërkon Perëndisë t'ju përgatisë që të besoni mjaftueshëm dhe të largoni gjethet e fikut nga stili juaj personal.

DHUNTIA E TË QENIT VETVETJA

Ka një alternativë të vetes suaj të rreme. Ajo kërkon më pak energji dhe punë. Mënyra e jetesës që është e bazuar në jetën tonë në Krishtin është mënyra e vërtetë që na qon drejt thirrjes sonë dhe përmbushjes më të mirë të mundshme.

Shndërrimi në veten e vërtetë



Vetja e vërtetë është saktësisht e kundërta e të gjithë asaj që e përshkrova si vetja e rreme. Vetja e vërtetë është ajo që në realitet jeni dhe ajo në të cilën po shndërroheni. Nuk është diçka që duhet ta ndërtoni përmes procesit të vet-përmirësimit apo ta rrënoni përmes analizës psikologjike. Nuk është një objekt pas të cilit duhet të mbahemi. As nuk është prototip që duhet aktualizuar. Nuk është as ndonjë pjesë e juaja e brendshme dhe e fshehur. Por, ajo është vetja juaj e plotë e krijuar nga Perëndia dhe e shpenguar nga ana e Krishtit. Është imazhi i Perëndisë në të cilin jeni, fytyra unike e Perëndisë që është veçuar nga përjetësia për ju.

Ne nuk e gjejmë veten tonë të vërtetë duke e kërkuar atë. Por e gjejmë atë duke e kërkuar Perëndinë. Ashtu siç e kam thënë, kur e gjejmë Perëndinë, e gjejmë veten tonë të vërtetë dhe të thellë. Pyetja antropologjike (Kush jam unë?) dhe pyetja teologjike (Kush është Perëndia?) janë të pandashme.¹ Duke e humbur veten në Perëndinë ne e zbulojmë identitetin tonë të vërtetë. Nuk ka jetë të vërtetë përveç marrëdhënies me Perëndinë. Andaj, nuk mund të ketë vetvete të vërtetë jashtë kësaj marrëdhënieje. Themeli i identitetit tonë gjendet në marrëdhënien me Burimin e jetës. Çdo identitet që ekziston jashtë kësaj marrëdhënieje është një iluzion.

Vetja e rreme

Siguria dhe rëndësia e arritur përmes asaj që kemi, çka mund të bëjmë dhe çka mendojnë të tjerët për ne.

Lumturia që kërkohet në autonomi nga Perëndia dhe tek gjërat që i shtojmë.

Identiteti është vetja jonë e idealizuar (kush duam që të tjerët të mendojnë se jemi).

E arritur përmes shtirjes dhe praktikës.

E ruajtur me anë të përpjekjes dhe kontrollit.

Mbërthen iluzionin si mjet për t'u bërë perëndi.

Vetja e vërtetë

Siguria dhe rëndësia e arritur përmes të qenit i dashur nga Perëndia.

Përmbushja e themeluar në dorëzimin tek Perëndia dhe të jetuarit e thirrjes sonë.

Identiteti është se kush jemi dhe si po shndërrohemi në Krishtin.

E pranuar si dhuratë me mirënjohje dhe dorëzim.

E ruajtur me anë të hirit.

Mbërthen realitetin si vendi i takimit dhe transformimit nga Perëndia.

IDENTITETI I RRËNJOSUR NË PERËNDINË

Për shkak se vetja e vërtetë mund të ekzistojë vetëm e lidhur për Perëndinë, ne e shohim të shprehet më qartë në jetën e një personi i cili e jetoi të gjithë jetën e tij i lidhur për Perëndinë, Jezusi. Jezusi është vetja e vërtetë i cili na tregon me jetën e tij se si ta gjejmë veten të lidhur për Perëndinë. Vetja që gjejmë të fshehur në Krishtin është vetja jonë e vërtetë sepse Krishti është burimi i qenies sonë dhe rrënja e identitetit tonë të vërtetë (1Korintasve 15:22).

Askush nuk lind me një identitet, e as Jezusi nuk bënte përjashtim. Disa njerëz brengosen se zbulimi i anës njerëzore

të Jezusit komprometon anën hyjnore të Tij. Mirëpo, duke qenë plotësisht njeri dhe plotësisht Perëndi, do të thotë se ai nuk ishte asgjë më pak se sa me natyrë njerëzore.² Dhe duke qenë plotësisht njeri nënkuptohet se edhe ai, si të gjitha qeniet njerëzore, duhej ta zbulonte se kush ishte. Edhe Jezusi duhej ta gjente mënyrën e Tij, veten e Tij. Çka dimë rreth asaj se si e bëri këtë gjë?

Ungjijtë na rrëfejnë mjaft pak për fëmijërinë e tij. Përveç disa tregimeve për disa vizitorë derisa ishte foshnje dhe shpërnguljet si familje nga dhe për në Egjipt, në ungjij paraqitet vetëm një ngjarje në mes të lindjes dhe pagëzimit ku përshkruhen veprimet e Tij, dhe ajo është vizita në tempull kur ishte dymbëdhjetë vjeç. Mirëpo para se ta shohim këtë ngjarje le të spekulojmë se si ka mundur të ishte jeta e Jezusit në vitet para këtij incidenti publik.

Të gjithë fëmijët janë të lidhur me prindërit e tyre. As Jezusi nuk ka qenë ndryshe. Maria, natyrisht se ka qenë një grua për dallim nga të tjerat “e favorizuar” nga Perëndia dhe “më e bekuara nga të gjitha gratë” (Luka 1:29, 42). Dorëzimi i saj nënshtrues ndaj vullnetit të Perëndisë, “le të më ndodhë sipas fjalës sate” (Luka 1:38), e shtron rrugën që edhe Jezusi të mësojë të jetojë jetën të lidhur për Perëndinë. Me kalimin e kohës, Jezusi pa dyshim se filloi të përvetësojë besimin e palëkundur të Marisë në vlerën e dashurisë së Perëndisë. Me kalimin e kohës Jezusi do ta kishte absorbuar edhe bindjen e thellë se Ai ishte “Biri i shumë të Lartit” (Luka 1:32). Ai duhet të ketë qenë rritur duke i dëgjuar të gjitha historitë e ngjarjeve të jashtëzakonshme mbi lindjen e Tij dhe fëmijërinë e hershme. Ai duhet të ketë dëgjuar për vizitën e barinjve dhe dijetarëve, dhe për profecitë e Simeonit dhe Anës në ditën e rrethprerjes. Ai do ta dinte se familja e Tij e shihte si shpëtimtarin e premtuar dhe të shumëpritur, Krishtin i cili do të sillte shpëtimin për Izraelin dhe dritën për paganët (Luka 2:32).

Jezusi do të mund t'i përgjigjej këtyre pritjeve duke krijuar një ndjesi të pronësisë që do ta bënte të sillej si zotëri para të afërmve, shokëve apo edhe prindërve. Duke qenë Biri i Perëndisë, Ai do të mund të ndërmerre hapa shkatërrues. Mirëpo, nuk e shohim që kjo të ndodhë. Përkundrazi, ndjesia e Tij për të qenë i lidhur me Perëndinë e qoi Atë drejt një varësie në dashuri dhe dorëzim tek Perëndia. Ngjarja e moshës dymbëdhjetë vjeçare na jep një pamje të vetes që Jezusi po e krijonte në atë kohë.

Ashtu siç paraqitet tek Luka 2:41-50, ky incident ndodhi kur Jezusi dhe familja e Tij po shkonin në udhëtimin e përvitshëm për në tempull me rastin e festës së Pashkës. Në përfundim të festës, Maria dhe Jozefi u larguan me karvanin e familjes duke menduar se Jezusi ishte me të afërmit e Tij. Një ditë me pas, kur ata e kuptuan se Ai nuk ishte me ta, ata u rikthyen në Jerusalem që ta gjenin. Pas tri ditësh kërkimi, të mbushura me frikë, ata më në fund e gjetën në tempull “i ulur në mesin e mësuesve, duke i dëgjuar dhe duke u bërë atyre pyetje” (vargu 46).

I befashuar nga shqetësimi i prindërve të Tij, Jezusi u përgjigj në atë mënyrë që tregonte se e kuptonte mirë se kush ishte: “Pse më kërkonit? A nuk e dinit se duhet të merrem me punët e Atit tim?” (vargu 49).

Jezusi kishte filluar të mendonte jo vetëm për lidhjen me prindërit e tij tokësore por edhe për lidhjen me Prindin qiellor. Ai po fillonte ta kuptonte që më vonë, ky aspekt thelbësor i identitetit të Tij do të bëhej burimi nga i cili do të dilte thirrja e Tij. Ai po fillonte të kuptonte se punët e Atit ishin punët e Tij, prioritetet e Atit ishin prioritetet e Tij.

Jezusi më vonë do t'i pyeste dishepujt e Tij “kush thonë njerëzit se jam unë” dhe “ju kush thoni se jam unë” (Mateu 16:13-20). Kjo do të ishte pyetje e rrezikshme nëse nuk do ta kishte tashmë të qartë përgjigjen. Jezusi nuk e pranonte vetëm identitetin që të tjerët i ofronin. Nëse do ta kishte bërë këtë gjë, atëherë edhe ai sikurse ne do të tërhiqej në shumë drejtime.

Juda, në mes tjerash, shpresonte se Jezusi do të ishte një shpëtimtar politik nga tirania romake. Të tjerët e shihnin si profet. Këto dhe identitetet tjera të mundshme ishin si mundësi për të shpërqendruar Jezusin e vërtetë. Mirëpo, Ai nuk i mori parasysh pritjet e të tjerëve për të kuptuar se kush ishte. Përkundrazi, Ai mori parasysh marrëdhënien e tij me Perëndinë.

Qartësia në mendime dhe veprime që më vonë do të karakterizonin shërbesën publike të Jezusit rrodhën nga shumë vite përgatitje në fshehtësi dhe anonimitet. Thelbi i kësaj përgatitje ishte ballafaqimi me Perëndinë në vendin sekret të vetes së brendshme. Përmes ballafaqimit me Perëndinë në vendet më të fshehta, Jezusi e zbuloi identitetin e Tij dhe u rrit në intimitet me Perëndinë.

Jezusi i dha lavdi Perëndisë duke qenë vetvetja - thellësisht, në të vërtetë dhe vazhdimisht. Thomas Merton thotë se “të jesh shenjtor do të thotë të jesh vetja.”³ Shenjtëri është të gjejmë veten tonë të fshehtë dhe të vërtetë në Krishtin dhe të jetojmë jetën që rrjedh nga kjo vetvete duke iu dorëzuar vullnetit dhe pranisë së Atit qiellor. Kështu, Jezusi drejton shumë bij dhe bija të Tij për tek Ati dhe për tek liria e të qenit vetja.

THIRRJA

Mirëpo identiteti nuk është statik (i palëvizshëm). Ai na jep drejtim se si e jetojmë jetën. Zbulimi i vetes sonë të vërtetë nuk sjell vetëm liri. Por sjell edhe thirrje.

Thirrja është fjala më e vjetër dhe më teologjike për atë që ne ndonjëherë i referohemi si “thirrje qiellore”. Të dyja këto na qojnë në një drejtim, drejt qëllimit të jetës që është e rrënjësuar në Perëndinë e jo në vetveten. Thirrja jonë, sikurse vetvetja, mund të kuptohet vetëm nëse jemi të lidhur me Atë që Thërret.

Mund ta kuptojmë thirrjen e Perëndisë për ne në shumë nivele. Së pari, jemi të thirrur të jemi qenie njerëzore. Për *Qenien*

Njerëzore, Jean Vanier na përkujton rëndësinë e madhe të kësaj thirrje për të zbuluar dhe jetuar si qenie të përbashkëta njerëzore. Ai e quajti këtë si “rrugëtimi nga vetmia në dashuri që rritet përbrenda dhe përmes përkatësisë,” një dashuri që “na liron nga dëshirat vetjake dhe lëndimet e brendshme... që gjen përmbushje në falje dhe dashurinë për ata që janë armiq të tanë.”⁴ Kjo, dhe asgjë më pak, është ajo që kërkohet nga thirrja për të qenë plotësisht qenie njerëzore.

Niveli i dytë i thirrjes është që të jemi të krishterë. Kjo ndërtohet fillimisht duke na e shfaqur rrugën e përmbushjes së qenies sonë njerëzore. Ndjekja e vërtetë e Krishtit do të na bëjë më njerëzor, e asnjëherë më pak njerëzor. E dimë që diçka nuk po shkon nëse nuk ndodh kështu. Jezus Krishti, Njeriu-Perëndi i përkryer, lidh humnerën në mes të Perëndisë dhe njeriut. Duke u bërë plotësisht njeri, Jezusi na udhëheq drejt përmbushjes së anës njerëzore. Duke qenë plotësisht Perëndi na drejton për tek Perëndia.

Nga ana tjetër mund ta mendojmë thirrjen tonë edhe në aspektin e misionit tonë në botë, mënyrën si e jetojmë pjesën tonë unike brenda thirrjes së përgjithshme për t’u bërë plotësisht njeri teksa e ndjekim Jezusin dhe ecim drejt bashkimit me Perëndinë. Gordon Smith thotë se: “më shumë sesa në karrierë, punë apo profesion, thirrja unike bazohet në dhuntitë dhe aftësitë tona, do të burojnë nga dëshira jonë e madhe dhe do të ofrojë përgjigje për nevojat e botës.”⁵

Koncepti i krishterë për thirrjen rrjedh nga besimi në “krijuesin Perëndi i cili modelon njerëzimin dhe të gjithë natyrën me dashuri, që kërkon lulëzimin dhe përmbushjen e të gjitha krijesave.”⁶ Andaj, thirrja është mënyra jonë e jetesës që është e mirë si për ne ashtu edhe për botën. Pikërisht këtë e nënkupton edhe Frederick Buechner kur thotë se: “vendi në të cilin na thërret Perëndia është aty ku përmbushet gëzimi juaj më i madh dhe uria më e madhe e botës.”⁷

Thirrja jonë është përherë përgjigje ndaj thirrjes Hyjnore që të marrim vendin që na takon në mbretërinë e Perëndisë. Thirrja jonë është që t'i shërbejmë Perëndisë dhe njerëzve në mënyrën më të mirë që përputhet me formën e qenies sonë. Në një mënyrë apo një tjetër, thirrja e krishterë duhet çdo herë të përmbajë kujdesin ndaj krijimit të Perëndisë dhe njerëzve. Kjo na rreshton krahë botës së krijuar dhe fqinjëve tanë duke na zhvendosur nga përqendrimi tek vetja në shërbim vet-sakrifikues dhe kujdes.

Natyra e zakonshme e mbretërisë së Perëndisë gjithashtu na e tërheq vëmendjen kah fakti se e zbulojmë thirrjen, dhe ashtu siç e kam thënë më herët vetveten tonë të vërtetë, në komunitet. Me ndihmën e atyre që na njohin mirë, mësojmë të dallojmë dhuntitë tona dhe gjejmë zërin autentik si dhe thirrjen tonë. Të gjithë jemi të thirrur të ndjekim Krishtin dhe t'i shërbejmë me dashuri Perëndisë dhe fqinjëve. Mirëpo thirrja specifike që është e rrënjësuar në identitetin tonë unik, në dhunti dhe personalitet gjendet tek njohja e Perëndisë dhe vetes në komunitetin e krishterë.

Kur jetojmë një jetë larg nga ndjenja e thirrjes së Perëndisë është sikur jetojmë të orientuar thjesht drejt zgjedhjeve tona se kush duam të jemi dhe çka duam të bëjmë. Thirrja sjell liri dhe përmbushje sepse na orienton kah diçka më e madhe se vetja.

THIRRJA E RRËNJOSUR NË IDENTITET

Jezusi kishte nevojë të kuptonte identitetin e tij si dhe të dallonte thirrjen në jetën e Tij. Sikurse ne, edhe ai kishte nevojë të kuptonte bashkë me Perëndinë të vërtetën e qenies së Tij. E kemi parë se si kjo po zhvillohej në moshën dymbëdhjetë vjeçare. Pamja tjetër që Ungjijtë na ofrojnë për Të është rreth tetëmbëdhjetë vite më pas, kur Ai shkoi tek kushëriri i Tij Gjoni për pagëzim. Këtu e shohim shpalosjen e vërtetë të thirrjes së Tij.

Gjoni nuk ishte rehat me idenë e pagëzimit të kushëririt të tij Jezus. Ai për shumë kohë e kishte parë Jezusin si Mesia dhe e kishte kuptuar thirrjen e tij si personi që do të përgatiste rrugën për Jezusin. Ai tha se Jezusi duhej ta pagëzonte atë dhe jo e kundërta. Mirëpo Jezusi ishte këmbëngulës. “Lejo të bëhet për tani” i tha Ai, “sepse në këtë mënyrë përmbushim çdo drejtësi” (Mateu 3:15). Gjoni u dorëzua dhe e pagëzoi Jezusin.

Veçoria më mahnitëse dhe që më lë më shumë përshtypje në këtë tregim është natyra njerëzore e Jezusit. Ai e dinte se nuk kishte njohur mëkat dhe nuk kishte nevojë për pagëzimin e pendimit. Mirëpo përfshirja në punët e Atit të Tij, kërkonte edhe përmbushjen e drejtësisë. Nuk tregoi madhështi sa të mos mund t’i nënshtrohej kushëririt të tij të përulur dhe shumë ekscentrik. Megjithatë, Ai ishte i gatshëm t’i nënshtrohej kushëririt të tij sepse ai fillimisht ishte i përgatitur t’i nënshtrohej vullnetit të Perëndisë. Asgjë nuk kishte rëndësi më shumë se kjo.

Mënyra e vetes tonë të vërtetë është gjithmonë mënyra e përulësisë. Krenaria dhe arroganca na qojnë drejt vetes sonë të rreme por përulësia dhe dashuria na mundësojnë të jetojmë të vërtetën e qenies sonë. Jezusi ishte në rrugën e njohjes së thirrjes së tij sepse ai ishte përsosmërisht dhe plotësisht në Vetën e Tij të Vërtetë.

Ndoshta ngjarja më domethënëse në Ungjij rreth kuptimit të thirrjes nga ana e Jezusit është e paraqitur tek Luka 4. Teksa mbërrin në Nazaret në ditën e Shabatit në fillim të shërbesës së Tij publike, Jezusi bëri atë që ishte në traditën e tij dhe shkon në sinagogë. U ngrit për të lexuar dhe mori shkrimet e profetit Isaia. Teksa i hapi shkrimet, ai zgjodhi të lexojë fjalët e mëposhtme:

“Fryma e Zotit është mbi mua,
sepse ai më vajosi për të ungjillëzuar të varfrit;
ai më dërgoi për të shëruar ata që e kanë zemrën të thyer,

për të shpallur çlirimin e të burgosurve
dhe kthimin e të parit të verbërve,
për të dërguar në liri të shtypurit,
dhe për të predikuar vitin e pranueshëm
të Zotit” (Luka 4:18-19).

Kur përfundoi, të gjithë sytë a tyre që ishin në sinagogë u drejtuan kah Jezusi. Pyetja që askush nuk guxonte ta bënte ishte *Kush është ky njeri që guxon të veshë mantelin e Mesias?*

Jezusi e dëgjoi këtë pyetje që nuk u shtrua nga askush dhe u përgjigj në mënyrë shumë të drejtpërdrejtë: “Sot ky Shkrim u përmbush në veshët tuaj” (Luka 4:21).

Si mundi Jezusi ta kuptonte se Ai do të përmbushte premtimet e Dhiatës së Vjetër? Çka i dha Atij këtë siguri kaq të madhe sa të fliste me bindje se shkrimet që ishin lexuar aty shpesh nëpër sinagogat e Izraelit i referoheshin Atij? Përgjigja pjesërisht gjendet tek ato që ai po bënte disa ditë para këtij incidenti të jashtëzakonshëm.

Kjo siguri e madhe e thirrjes erdhi menjëherë sapo Jezusi filloi dyzetë ditët e tundimit në shkretëtirë (Luka 4:1-13). Jezusi e kuptoi thirrjen e tij duke luftuar me Perëndinë, me veten dhe djallin në vetminë e shkretëtirës.⁸ Duke i rezistuar tundimit të vetes së rreme i bazuar në forcë, prestigj apo gjërat që posedonte, Jezusi zgjodhi identitetin e tij të vërtetë si Biri shumë i dashur i Perëndisë. Identiteti nuk ishte problemi i Tij. Për këtë arsye ai nuk u shpërqendrua nga fjalët që u përpoqën ta paraqisnin vetëm si birin e Jozefit (Luka 4:22). Jezusi e dinte kush ishte Ati i Tij, dhe për rrjedhojë e dinte se cila ishte thirrja e tij, të bënte vullnetin e Atit.

Asgjë nuk ishte më e rëndësishme në pikëpamjen e Jezusit për thirrjen e tij sesa të bënte vullnetin e Perëndisë. Teksa shpjegon varësinë në Perëndinë që mund të duket si jo e shëndetshme dhe fëmijërore, Jezusi tha që Ai nuk mund të bënte asgjë i vetëm sepse synimi i tij nuk ishte të bënte

vullnetin e Tij por vullnetin e Perëndisë (Gjoni 5:30). Bërja e vullnetit të Perëndisë ishte aq e rëndësishme për qenien e tij saqë në raste të tjera Ai i quan si të afërmit të Tij ata që, sikurse Ai, i binden vullnetit të Perëndisë. Lidhja me “të afërmit në thirrje” ishte aq e fortë saqë, sikurse në incidentin në tempull në moshën dymbëdhjetë vjeçare, Ai ishte i gatshëm të ofendonte familjen e tij natyrale duke i dhënë përparësi familjes qiellore. Asgjë nuk kishte përparësi më të madhe tek Jezusi sesa dorëzimi ndaj vullnetit të Atit, as edhe obligimi për të dashur familjen dhe fqinjët.

Thirrja jonë, sikurse thirrja e Jezusit, është të jetojmë jetën tonë në të vërtetën dhe varësinë ndaj vullnetit të Atit tonë të dashur. Sikurse në rastin e Jezusit, siguria e thirrjes përshkohet edhe nga lufta me Perëndinë, veten dhe djallin në vetminë e shkretëtirës sonë private. Ashtu sikurse për Jezusin, kjo siguri duhet përherë të ndodhë nën dritën e rrethanave të tanishme në jetën tonë. Kjo do të thotë që vëmendja ndaj thirrjes së Perëndisë është çështje që zgjat gjithë jetën.

Të kuptuarit e thirrjes nga ana e Jezusit vazhdoi të rritet edhe deri në momentet e vdekjes së Tij. Ai kishte parashikuar vdekjen qysh në ditët e para të shërbesës së Tij (Marku 8:31). Andaj në njërën anë, nuk ishte befasi për të teksa e shihte që ai moment po afrohej. Megjithatë, teksa ngjarjet po shkonin drejt fundit, në Kopshtin e Gecemanit, ndoshta ka filluar të dyshojë në vete nëse e kishte lexuar drejtë vullnetin e Perëndisë. Mbase ka thënë: *Sigurisht që ky nuk mund të jetë vullneti i Perëndisë. Sigurisht që një vdekje e parakohshme para fillimit të shërbesës publike nuk do të mund të ishte qëllimi i ekzistencës sime!* Por duke mos u lëkundur asnjëherë, fjalët e Jezusit ishin: “jo si dua unë, por si do ti” (Mateu 26:39). Besimi i tij i palëkundur ishte në Perëndinë. Asgjë nga ato që dinte nuk ishte më e rëndësishme sesa bërja e vullnetit të Perëndisë. Kjo ishte arsyeja që erdhi në tokë.

Shumë shpesh ne e mendojmë thirrjen e Perëndisë vetëm në kuadër të asaj që bëjmë. Njerëzit thonë se janë të thirrur në shërbesë apo ndihen të thirrur të punojnë në shëndetësi apo arsim. Megjithatë edhe këtu përfshihet bërja e vullnetit, thirrja është më shumë sesa profesioni ynë. Ne jemi të thirrur nga përjetësia që të paraqesim fytyrën e Krishtit tek bota. Kjo është thirrja jonë se kush duhet të jemi.

TË JETOJMË TË VËRTETËN E TË QENIT UNIK

Si adoleshent, gjithmonë e kam pasur frikën e madhe se Perëndia do të më thërrasë të jem misionar, sikurse xhaxhai im, emrin e të cilit e mora, dhe heronjtë e tjerë të familjes që admiroheshin aq shumë nga të tjerët. Vullneti i Perëndisë më ishte paraqitur në kuadër të asaj që bëja e jo se kush isha. Edhe vendi ku isha drejtuar të gjeja këtë vullnet ishte i jashtëm. Ishte Bibla.

Pa e lënë anash vlerën e Biblës në njohjen e thirrjes sime, e kisha kuptuar se kishte edhe një vend më të thjeshtë në të cilin më ishte komunikuar vullneti i Perëndisë. Ky vend ishin dhuntitë e qenies sime. Temperamenti, personaliteti, aftësitë, interesat dhe pasionet e mia, të gjitha tregojnë diçka për atë se kush jam thirrur të jem, jo thjesht vetëm se kush jam. Nëse njëmend besoj se jam krijuar nga Perëndia dhe jam ftuar të gjej vendin tim në mbretërinë e tij, atëherë duhet të marrë seriozisht atë që Perëndia tashmë më ka zbuluar se kush jam.

Për shembull, nuk mund të imagjinoj që Perëndia të më japë ide që më interesojnë e të mos i bëjë ato pjesë të rëndësishme të vendit për të cilin jam i thirrur ta mbush në mbretëri. Mendimet gjithmonë kanë qenë shoqëruesi im i brendshëm. Mundohem që përmes dialogut të hulumtoj dhe organizoj këto pjesë jo të përkryera në arkitekturën e brendshme. Tërhiqem gjithashtu nga shkrimi si pjesë e rëndësishme. Ngjashëm, edhe interesimi im për njerëzit, veçanërisht takimet dhe kuptimi i

tyre në thellësi, ishte pjesë e tërheqjes sime ndaj psikologjisë dhe interesit tim për drejtimin shpirtëror. Gjithashtu, edhe interesi im afatgjatë për dinamikën e shpirtit ka qenë pjesë e rëndësishme e gjetjes së rrugës drejt thirrjes për kujdes ndaj shpirtit.

Thirrja ime nuk është që thjesht të jem ligjërues, shkrimtar ose psikolog, por, të jem shërbëtor i mbretërisë së Jahveh-it. Mirëpo, mënyra se si duhet ta bëj është e rrënjësuar në veten që Perëndia ka krijuar. Dhe kjo më ka drejtuar tek kuptimi dhe promovimi i mirëqenies së brendshme të njeriut. Kjo është arsyeja për të cilën David Bener është krijuar dhe ky është konteksti në të cilin jam thirrur të jetoj të vërtetën e ekzistencës dhe varësisë në Perëndinë.

Teksa zbulimi i parë i thirrjes sonë është në dhuntitë e qenies sonë, është e rëndësishme të theksohet se vullneti i Perëndisë për ne nuk rritet natyrshëm nga dëshirat tona. Jona është shembull i mirë, thirrja e të cilit ishte plotësisht e kundërt me dëshirat e tij sipërfaqësore. Moisiu nuk i pëlqente fjalimet në publik dhe Gideoni nuk ishte mjaft i guximshëm. Edhe Jezusi nuk është se mezi priste të kryqëzohej. Kjo është disiplina e të bërit atë që nuk duam të bëjmë por e dimë se duhet ta bëjmë. Kur e bëjmë këtë gjë atëherë mund edhe të transformohemi.

Perëndia ndonjëherë thërret njerëzit për një kauzë e cila as nuk buron nga aftësitë e tyre as nga dëshirat sipërfaqësore. Mirëpo thirrja e Tij është çdo herë në harmoni me fatin tonë, me veten tonë të vërtetë, identitetin tonë dhe formën e qenies sonë.

Ne të gjithë jemi të thirrur të jetojmë të vërtetën e anës sonë unike. Krijimi hyjnor nuk ka hapur asnjëherë një linjë prodhimi apo të montimit. Rezultatet e veprës krijuese të Perëndisë janë shumë origjinale dhe vepër e mirëfilltë e artit. Ti dhe unë nuk bëjmë përjashtim.

Mirëpo Perëndia nuk na ka krijuar vetëm në mënyrë unike. Perëndia na takon në uniken tonë. Për shembull, mendo për

mënyrat e ndryshme ku Jezusi i takoi njerëzit në ungjij. Disa thjesht u ftuan që ta ndjekin, disa të tjerë u përfshinë në dialog sokratik, disave iu dhanë shëmbëlltyra provokuese si përgjigje ndaj pyetje të tyre, disa u shëruan, disave iu tha se mëkatet e tyre iu janë falur. Asnjëherë nuk ka pasur një mënyrë standarde për të takuar Perëndinë.

Perëndia na takon në individualitetin tonë sepse Perëndia dëshiron të përmbush këtë individualitet. Perëndia dëshiron që ta ndjekim dhe t'i shërbejmë në këtë individualitet dhe përmes tij. Perëndia nuk do që ne të asgjësojmë anën tonë unike gjersa e ndjekim Krishtin. Përkundrazi, ndjekja e Krishtit na qon drejtë vetes sonë të vërtetë.

Jeta shpirtërore e një personi nuk duhet të jetë kopje identike e një tjetri. Pjetri dhe Gjoni kishin personalitete mjaft të ndryshme dhe rrugëtime transformuese mjaft të ndryshme gjatë ndjekjes së Jezusit. Maria dhe Marta, dy motrat që Jezusi i donte aq shumë, secila prej tyre e shprehin dëshirën për të në mënyrë unike. Dhe Ai i pranoi të dyja, duke mos e dekurajuar Martën ngaqë ishte shumë e zënë në shërbimet e saj por thjeshtë duke e inkurajuar që të mos shqetësohej e të lodhej shumë (Luka 10:38-42).

Vullneti i Perëndisë për ne është që të jetojmë nga shprehja e harmonizuar e dhuntive, temperamentit, pasioneve dhe thirrjeve në varësi të vërtetë nga Perëndia. Asgjë tjetër nuk ia vlen ta quajmë si veten tonë të vërtetë. Asgjë tjetër përveç kësaj nuk na qon tek përmbushja e vërtetë. Dhe asgjë tjetër nuk do të na mundësojë që të shfaqim më së miri fytyrën e Krishtit tek bota, ashtu siç jemi thirrur nga përjetësia për ta shfaqur.

THIRRJA JONË, PËRMBUSHJA JONË

Mënyra e Krishtit për vetëpërmbushje nuk është ashtu siç do të mund ta paramendonim. Mënyra e tij kërkon humbjen e jetës sonë që të mund ta gjejmë jetën e vërtetë, të vdesim që

të mund të jetojmë. Mënyra e Tij është ajo e kryqit. Vdekja çdoherë sjell jetë të re.

Lumturia jonë është e rëndësishme për Perëndinë. Mirëpo ajo që Ai dëshiron për ne është shumëfish më e madhe sesa ndjenjat sipërfaqësore që vijnë nga kërkimi i lumturisë që e bëjmë ne. Ajo që ai do të na japë është gëzimi i vërtetë që vjen nga gjetja e vetes në Krishtin që është të qenit i varfër në frymë, vajtimi, zemërbutësia, uria për drejtësi, mëshira, zemra e pastër, paqebërja dhe përndjekja për shkak të drejtësisë (Mateu 5:1-10).

Përmbushja jonë është gjithashtu e rëndësishme për Perëndinë. Mirëpo vetja që Ai do të përmbushë nuk është vetja e ekzistencës autonome. Nuk është as ndonjëra nga vetja jonë e rreme që ne kemi krijuar. Mirëpo është vetja jonë e vërtetë dhe e thellë.

Lumturia dhe përmbushja janë bekime që vijnë nga dorëzimi ndaj vullnetit të dashur të Perëndisë. Të dyja janë idhujtari nëse kërkohen nga vetë ne. Të dyja na shpërqendrojnë nga thirrja jonë e vërtetë në Krishtin. Kjo është vetja jonë e vetme në të cilën do të mund të gjejmë autenticitetin e plotë.

Është sikur të veshim një fustan apo kostum të qepur për dikë tjetër. Vetja jonë në Krishtin është vetja që përputhet plotësisht sepse jemi ne në tërësi. Është vetja që na mundëson të jemi të lirë nga i gjithë ankthi se si duhet të jemi dhe kush jemi. Dhe na mundëson që të jemi plotësisht vetja, unik jo nga përpjekjet tona për individualitet por pafundësisht origjinale për shkak se kjo është se kush jemi dhe çka jemi.

Thirrja e Perëndisë për përmbushje është një thirrje që ne të zëmë vend në agjendën e restaurimit dhe bërjes së gjërave të reja në Krishtin. Thirrja jonë është e rrënjësuar në veten tonë që Perëndia e ka menduar qysh nga përjetësia. Thirrja jonë është të bëhemi ashtu si e ka menduar Perëndia dhe pastaj t'i shërbejmë Atij dhe qenieve njerëzore në atë mënyrë

që paraqet përmbushjen e vetes. Identiteti ynë nuk është thjeshtë një gjë që posedojmë. Është thirrje.

Në mënyrë paradoksale, përmbushja jonë gjendet në shuarjen e agjendave tona për përmbushje. Gjendet edhe në kryqëzimin e të gjitha mënyrave egoiste të jetesës larg nga dorëzimi i plotë tek Perëndia. Prandaj, nuk gjendet tek ndonjë vend ku ne presim ta gjejmë. Rugët e Krishtit gjithmonë i kthejnë përmbys rrugët tona. Por vetëm në botën e përmbysur të mbretërisë së Krishtit ne do të gjejmë veten për të cilën jemi thirrur nga përjetësia dhe Perëndinë të cilit jemi thirrur t'i shërbejmë. Vetëm në Perëndinë gjendet e vërteta e qenies sonë.

HAPI I RADHËS

Idetë dhe idealet e këtij kapitulli janë të mëdha. Cinikët postmodernë i buzëqeshin nocionit se ka një mënyrë ekzistimi për secilin nga ne e që është e vërteta. Mirëpo, nëse identiteti ynë është i rrënjosur në të Vërtetën, atëherë vetja që gjejmë aty, për secilin prej nesh, do të jetë e vërteta unike që është thirrja jonë.

Tani na mbetet që këto ideale t'i kthejmë në praktikë. Supozoj se pasi keni mbërritur deri këtu me leximin, tashmë keni bërë një punë parapërgatitore të njohjes së vetes dhe Perëndisë si dhe takimit me Perëndinë thellë brenda jush. Askush nga ne nuk mbaron punë me kaq, kështu që vazhdoni të lexoni sepse e dini se ka ende shumë punë për të bërë në këtë fushë. Ne nuk duhet të presim që njohja të përfundojë dhe atëherë të kuptojmë thirrjen tonë. Dallimi apo njohja e thirrjes sonë është një proces i vazhdueshëm dhe afatgjatë. Duhet të mësohemi të jetojmë të vërtetën e ekzistencës sonë dhe jo vetëm të luajmë role të caktuara apo të arrijmë pritshmëri të caktuara.

Mund të ndiheni sikur thirrja juaj ka qenë e qartë tashmë për disa vite. Ndoshta i jeni përgjigjur tashmë Perëndisë në

ndonjë lloj shërbese. Ose ndoshta ndiheni sikur e keni gjetur thirrjen tuaj në punën që bëni. Mirëpo në një pikë të caktuar në të ardhmen e afërt, merrni pak kohë me Perëndinë për të rishikuar këtë thirrje, jo për të përcaktuar nëse duhet të ndryshoni atë që po bëni mirëpo për t'ju ndihmuar të jetoni të vërtetën me më shumë përqendrim dhe pasion. Rishikimi periodik i thirrjes me anë të lutjes mund të jetë ndihmë e madhe në ruajtjen e ndjekjes së Krishtit në mënyrë personale dhe të përqendruar.

Në anën tjetër, akoma mund të jesh duke pasur vështirësi me thirrjen në jetën tënde. Mund të ndihesh sikur nuk ke nevojë vetëm për një rishikim por që Perëndia të zbulojë përfundimisht dhe qartësisht thirrjen tënde. Nëse po, atëherë shqyrtoni sugjerimet më poshtë me durim. Mbani mend që të mos e ngatërroni thirrjen tuaj me punën apo karrierën. Mos mendoni se deri më tani nuk e keni jetuar atë thirrje. Shpesh ndodh që kur shikojmë prapa se kush kemi qenë na ndihmon të kuptojmë se kush jemi thirrur të jemi.

Pavarësisht vetëbesimit për thirrjen tuaj apo ndjesisë së përparimit në zhvillimin e vetes së vërtetë, më lejoni t'ju sugjeroj dy gjëra për rishikimin në lutje.

1. Ndani pak kohë që të meditoni për ngjarjen nga ungjilli rreth shkuarjes së Jezusit në tempull në moshën dymbëdhjetë vjeçare (Luka 2:41-50). Bëni një bisedë imagjinare me Jezusin dhe pyeteni se ku e ka gjetur ndjesinë e pastër të identitetit të Tij. Dëgjojeni derisa flet dhe shiheni teksa vepron. Shihni se çka mund të mësoni për njohjen e vetes së Tij në relacion me Perëndinë. Pastaj përmbledhjeni këtë bisedë me Jezusin derisa meditoni për deklaratën e Tij publike mbi thirrjen e tij derisa ishte në sinagogë, e cila është e regjistruar tek Luka 4:16-22.
2. Në lutje shkruaj një deklaratë misioni për jetën tënde. Mendo për jetën tënde prej të kaluarës e deri më tani duke

i rikujtuar dhuntitë e qenies suaj dhe kërko të dallosh thirrjen brenda tyre. Shto këtu edhe drejtimin që beson se ke marrë nga Perëndia, bashkë me to. Filloje deklaratën e misionit me fjalët: “I thirrur për...” dhe lejo të reflektosh mbi arsyen për të cilën beson se je krijuar dhe fytyra unike e Krishtit që je thirrur të jesh. Diskutoje këtë me dikë që të njeh mirë dhe të cilit i beson, kërko mendimin e tyre por mos e adopto si mendim tëndin përveç nëse konfirmohet me lutje dhe me reflektim të kujdesshëm.

Identiteti dhe rrugëtimi shpirtëror



Ana shpirtërore e krishterë është një rrugëtim transformues. Është sikur të marrësh mendjen dhe zemrën e Krishtit pasi e njohim si të vërtetën më të madhe të qenies sonë. Nuk nënkupton vetëm të bëhemi si Krishti por aktualizimi i Krishtit brenda nesh. Është një rrugëtim i bashkimit me Perëndinë. Dhe nëse këto nuk e sfidojnë dhe nuk e transformojnë themelin e identitetit tonë atëherë nuk kemi arritur aq larg në këtë rrugëtim.

IDENTIFIKIMI I IDENTITETIT

Identiteti është diçka që ne e marrim si të mirëqenë. Mund të kemi kujtime se sa shumë kemi luftuar që të gjejmë një mënyrë të qenies si adoleshentë dhe supozojmë se sapo kemi shkelur në moshën e pjekurisë së hershme çështja e identitetit tonë është lënë prapa. Mirëpo kjo e ngatërron personalitetin tonë dhe identitetin. Personaliteti ynë është ajo që të tjerët duam ta shohin. Identiteti ynë është se si e shohim dhe kuptojmë veten. Kjo vazhdon të zhvillohet gjatë gjithë jetës. Nëse nuk do të kishte vazhdimësi, transformimi i vetes sonë nuk do të ishte i mundshëm. Megjithatë, për shkak se transformimi i qenies njerëzore në thelb është

transformim i identitetit, të gjitha ndryshimet tjera që janë pjesë e rrugëtimit të transformimit rrjedhin nga kjo.

E çka është identiteti në të vërtetë? Edhe pse mund të tingëllojë si tautologji (përsëritje e të njëjtës gjë), identiteti ynë është i bazuar në gjërat me të cilat identifikohemi më së shumti. Për shembull, nëse identifikohemi me fuqi, identiteti ynë do të bazohet në ndjenjën e fuqisë. Ose nëse identifikohemi me sukses atëherë identiteti ynë do të bazohet në ndjenjën e suksesit.

Për të marrë një ndjesi të identitetit, vini re se si e prezantoni veten tek të tjerët. Ndoshta e përshkruani veten me terma të punës, arritjeve, familjes apo bindjeve. Secila prej tyre ju japin një pamje të identitetit tuaj. Natyrisht se secila prej tyre reflekton edhe diçka nga personaliteti juaj (si dëshironi që të tjerët t'ju shohin), mirëpo më e rëndësishmja është se secila prej tyre na jep një pamje mjaft të mirë se si e shohim veten.

Sapo të filloni të përqendroheni tek identiteti juaj dhe ta shqyrtoni atë me më shumë kujdes do të shihni se si ai reflekton atë që psikologët e quajnë mosidentifikim, ku vëreni njerëzit të cilëve nuk do të dëshironit në asnjë mënyrë t'i ngjasonit. Shpesh kjo fillon me njërin apo të dy prindërit mirëpo nuk kufizohet vetëm me familjen apo fëmijërinë. Kur vëreni mos-identifikim shpesh do të goditeni nga energjia dhe fuqia e emocioneve që është e lidhur me të. Ky lloj investimi i energjisë emocionale çdoherë nxit nevojën për shtojca, qoftë shtojcë e identifikimit apo mosidentifikimit. Të dyja në mënyrë të fuqishme i japin formë vetes tonë.

Duke vëzhguar dhe reflektuar edhe më thellë në identitetin tuaj ju shpesh do të vëreni se ai qëndron në një themel edhe më të thellë. Në thelb, identiteti me automatizëm i shumë njerëzve në përfundim është ai i vetes së ndarë. Pa dyshim se ka shumë vende ku mund të ngremë paralele mes vetes dhe jo-vetes. Ndarja ekstreme e vetes përfshin një ndjenjë ekzistenciale të tjetërsimit dhe vetmisë. Mirëpo kjo zbutet kur përkufizimet formësohen sërish për të përshkruar veten në

bazë të familjes apo duke iu përshtatur atyre që kanë gjininë time, orientimin seksual, etninë, politikën, fenë, teologjinë apo diçka tjetër.

Por, transformimi i identitetit të cilin po e përshkruaj kur flas për të kuptuarin se vetja ime është në Krishtin, është më shumë sesa heqja e këtyre kufizimeve. Kjo nënkupton diçka më të thellë. E fashit dallimin në mes të vetes dhe jo-vetes që priremi ta jetojmë. Gjithashtu, e sfidon ndjenjën e ndarjes që zakonisht e formon thelbin e identitetit tonë.¹

TRANSFORMIMI I IDENTITETIT

Rrugëtimi për tek Perëndia që është në zemër të ndjekjes së Krishtit na çon tek zbulimi se themeli i vetes sonë është të qenit në Perëndinë. I kuptuari ynë rritet vazhdimisht për ndërlidhjen e pashmangshme të vetes sonë në Perëndinë dhe Perëndisë në ne. Kjo nuk nënkupton as humbjen e vetes as bërjen sikur Perëndia. Kjo nënkupton shndërrimin gjithmonë e më shumë në të vërtetën e qenies sonë në Perëndinë. Edhe pse vetja jonë nuk është Perëndi, aty është vendi ku ne takojmë Perëndinë. Andaj, nuk mund të ketë transformim të mirëfilltë shpirtëror nëse kërkojmë një vend tjetër për ta takuar Perëndinë. Shtëpia e synuar e Perëndisë është zemra jonë dhe takimi me Perëndinë në thellësi të shpirtit është ai që na transformon nga brenda. Ky është shkaku pse vetja është aq e rëndësishme në rrugëtimin e transformimit të krishterë. Vetja duhet të ballafaqohet dhe jo të anashkalohet. Ajo duhet të përqafohet dhe të njihet dhe si i tillë të transformohet.

Disa nga ne i qasemi anës shpirtërore të krishterë si kërkesë për të njohur Perëndinë. Kjo është vetëm një pjesë e tregimit. Tregimi i plotë na kërkon që përqendrimi ynë të jetë po aq sa në njohjen e vërtetë të vetes po aq edhe në njohjen e të vërtetave të Perëndisë, dhe njohja e vetes që nënkuptohet në krishterim është njohje e vetes në relacion me Perëndinë. Edhe njohja e Perëndisë, që është në thelb të transformimit të

krishterë, është njohje e Perëndisë në relacion me veten time.

Misteri i ungiillit është se vetja jonë e vërtetë nuk është ajo që e mendojmë si të ndarë mirëpo vetja që është një me Krishtin. Kjo është arsyeja pse vetja që niset në rrugëtimin e ndjekjes së Krishtit nuk është e njëjta me atë që mbërrin në fund. Vetja që fillon rrugëtimin shpirtëror është vetja që ne e kemi krijuar, vetja që e kemi modeluar të jetë. Kjo është vetja që vdes gjatë rrugëtimit. Vetja që arrin në destinacion është vetja që është dashur në ekzistencë nga dashuria Hyjnore. Ky është personi që jemi destinuar qysh nga përjetësia, UNË që është e fshehur tek “UNË JAM”.

VAZHDIMI I RRUGËTIMIT

Teksa ktheni kokën prapa, shpresoj se mund të shihni se si vetja që e filloi rrugëtimin shpirtëror nuk është vetvetja që tani është duke vazhduar atë. Shpresoj që keni arritur të njihni më mirë “UNË JAM-in” dhe “UNË-in tuaj të fshehur në Krishtin”. Për shkak se po e lexoni këtë libër, besoj se jeni plotësisht të hapur për pjesëmarrje sa më gjithëpërfshirëse në rrugëtimin e transformimit.

Andaj, më lejoni t’ju ofroj disa fjalë përfundimtare si këshillë, për t’ju ndihmuar ta bëni këtë gjë.

1. Merrni pak kohë dhe reflektoni mbi atë që keni mësuar për veten dhe Perëndinë gjatë procesit të leximit të këtij libri. Shumë njerëz më thonë se e lexojnë librin më ngadalë për herë të dytë, e shpesh për herë të tretë e të katërt. Lexoni edhe ju (edhe nëse e bëni sa për të kujtuar nënvizimet apo shënimet që keni marrë) më shumë për të medituar mbi ato që keni lexuar sesa për të marrë njohuri. Lejojeni Frymën t’ju drejtojë tek ajo që do t’ju mbërthejë. Lini vend për të reflektuar në atë që ju mbërthen dhe në lutje prisni për përgjigje.

2. Shihni mundësitë që të flisni me dikë që i besoni për zbulimet që keni bërë. Nëse nuk po e lexoni librin për qëllime të ndonjë grupi diskutimi, mundohuni të gjeni edhe disa të tjerë që ju bashkëngjiten në diskutim. Jepni kohë që ta lexojnë paraprakisht teksa ju e rilexoni librin dhe pyetjet në Shtojcë, pastaj takohuni si grup që ta ndihmoni njëri-tjetrin me librin dhe më e rëndësishmja të ndihmoni njëri-tjetrin që t'i përgjigjeni Frymës në ftesën që po ju bëhet.
3. Lutja juaj le të jetë sikurse lutja e Shën Augustinit: "*Novem te, novem me*" (Le të njoh veten, le të njoh ty).² Kjo është një lutje e krishterë sepse na shpie në zemër të rrugëtimit të transformimit të krishterë. Shihni cilat janë mundësitë të njihni veten dhe Perëndinë çdo ditë e më shumë. Merrni kohë në fund të çdo dite që të reflektoni dhe vini re reagimet tuaja për përjetimet gjatë ditës. Vini re gjithashtu, lëvizjet brenda jush që kanë ndodhur gjatë ditës, ndryshimet në disponim dhe ndryshimet e tjera në përjetimet brenda jush. Reflektoni në lutje, duke i kërkuar Perëndisë t'ju ndihmojë të kuptoni ku ishte Perëndia në ato momente dhe në ato përjetime. Kërkoni po ashtu ndihmën e Frymës që të kuptoni ftesën që Perëndia ju bën për të njohur veten dhe Perëndinë. Pastaj përfundoni kohën e lutjes me falënderim ndaj Perëndisë për dhuntinë e pranisë së Tij në atë ditë.
4. Kultivimi i pranisë tënde (meditimit, qetësisë) është një mënyrë tjetër e fuqishme përmes së cilës mund të njohësh më mirë veten dhe Perëndinë. Mos e mendo praninë tënde si një kohë kur mendon për ditën tënde apo kur analizon veten, mirëpo si një kohë kur largohesh nga mendimet dhe thjesht je i pranishëm. Prania në diçka apo te dikush fillon së pari me prani ndaj vetes. Mirëpo prania që përjeton nënkupton edhe Praninë e Perëndisë që është rrënja e ekzistencës tënde dhe që e bën të mundur praninë e vetes. Perëndia është gjithmonë i pranishëm dhe prania juaj, edhe kur nuk mendon për asgjë përfshirë edhe Perëndinë, është

prani brenda Pranisë Hyjnore. Mirëpo për shkak se prania e menduar nënkupton qetësimin e mendjes (veçanërisht mendimeve), ajo përbën një shkallë të lartë të hapjes ndaj njohjes. Prania është vendi ku e përjetojmë këtë njohje. Është edhe vendi ku ballafaqohemi me Perëndinë dhe veten në mënyra që ngacmohen më pak nga paramendimet dhe gjykimet. Është vendi ku e takojmë veten dhe Rrënjën e Të Gjitha Qenieve.

5. Meditimi apo soditja është praktika e pranisë.³ Andaj nëse tashmë e praktikoni lutjen me meditim apo praktika tjera të meditimit dhe soditjes tashmë jeni duke e praktikuar praninë. Të gjitha këto të qojnë në vendet më të thella brenda vetes ku mund ta njohësh veten dhe Perëndinë, e jo vetëm të kesh informacion. Bëni pak vend për këtë lloj njohje që e shoqëron praktikën e pranisë. Pa të, njohja e gjërave për të cilat kemi folur në këtë libër do të jete e cekët dhe e kufizuar. Me të, ju i afroheni njohjes së niveleve më të thella të transformimit për të cilin kemi diskutuar në këto dy libra të trilogjisë dhe që do të jetë pjesë kryesore e librit të tretë *Dëshirimi i vullnetit të Perëndisë (Desiring God's will)*, ku do të shqyrtojmë transformimin e vullnetit dhe dëshirës.
6. Më e rëndësishmja, mos i mendoni këto gjëra që po ju nxis t'i bëni si mënyra për të ardhur tek njohja e Perëndisë dhe vetes. Ky do të ishte rikthim tek përmirësimi i vetvetes. Ajo që bëni duke i ndjekur këto sugjerime është se e fton hirin e njohjes. Kjo është dhuratë e Perëndisë. Mirëpo duhet të ngrihesh dhe ta hapësh këtë dhuratë. Andaj, sugjerimet e mia janë thjesht mënyra për t'u ngritur dhe të jesh i hapur ndaj Hirit. Janë mënyra që i ofroni vetëdijes suaj për pranimin e Hirit që po kërkon. Janë gjëra që të krishterët i kanë bërë përgjatë historisë së traditës sonë teksa janë munduar të hapin veten ndaj Perëndisë që të njihnin veten dhe Perëndinë. Andaj, janë praktika shpirtërore të cilave mund t'i besohet.

Për reflektim dhe diskutim



Askush nuk ecën mjaftueshëm përpara në shtegun e rrugëtimit të krishterë pa dy gjëra: hapësirë për reflektim meditues dhe bashkëpunimi me të tjerët që e ndajnë të njëjtën rrugë. Unë tashmë kam prezantuar pjesë nga këto duke ofruar sugjerime për reflektim në fund të secilit kapitull. Kjo ka qenë mënyrë për t'ju inkurajuar që të merrni kohën e nevojshme të mendoni për atë që po lexoni.

Tani që e keni përfunduar librin, më lejoni që t'ju ftoj edhe një herë që të reflektoni mbi atë që keni lexuar teksa ju ofroj edhe pyetje dhe sugjerime që i përshtaten edhe individëve edhe grupeve. I kam organizuar për dy lloje të grupeve. Lloji i parë është për grupet që takohen për gjashtë sesione nga dyzet e pesë minuta, ku në secilin sesion diskutohet një apo më shumë kapituj. Kjo pasohet nga një formë e sugjeruar për grupet që takohen vetëm një herë për shtatëdhjetë e pesë deri në nëntëdhjetë minuta për të diskutuar për librin në tërësi. Nëse e përdor Shtojcën për reflektim dhe nuk parasheh të jesh pjesë e ndonjërit nga grupet e diskutimit, mund të zgjedhësh pyetje nga cilido lloj.

Udhëzues diskutimi për gjashtë sesione mbi *Dhuntinë e të qenit vetvetja*

≈ Sesiioni një ≈

PARATHËNIE: IDENTITETI DHE AUTENTICITETI DHE KAPITULLI I:

NJOHJA TRANSFORMUESE E VETVETES DHE PERËNDISË

1. Si përgatitje për sesionin e parë , më lejoni t'ju sugjeroj që të ktheheni tek parathënia dhe kapitulli i parë dhe të mbani shënim pjesët tuaja të preferuara. Ndoshta tashmë e keni bërë duke e nënvizuar librin, por edhe nëse e keni bërë do t'ju inkurajoja të veçoni dy apo tre pjesë që ju kanë lënë përshtypje më së shumti. Teksa e prezantoni veten para të tjerëve në sesionin e parë, ndajeni një pjesë që ju ka lënë përshtypje dhe tregoni grupit si i jeni përgjigjur asaj pjese.
2. Më lejoni t'ju rikthej tek hyrja e këtij libri. Aty është një thënie nga Thomas Merton: *“Ka vetëm një problem nga i cili varet e gjithë ekzistenca, paqja dhe lumturia ime: të zbuloj veten derisa zbuloj Perëndinë. Nëse e gjej Atë do ta gjej edhe veten dhe nëse e gjej veten do ta gjej Atë”*. Në cilën gjë do të thoshit se varet ekzistenca, paqja dhe lumturia juaj? Çka e bën të vështirë të besosh në atë që Mertoni thotë? Çfarë ndryshimi do të kishte në jetën tuaj nëse ato që thotë ai janë të vërteta?
3. Kapitulli një thotë: “Trupi dhe shpirti përmbajnë mijëra mundësi nga të cilat mund të ndërtosh shumë identitete. Mirëpo vetëm në njërën nga këto mund të gjesh veten

tënde të vërtetë, që është e fshehur në Krishtin në gjithë përjetësinë. Vetëm në njërën do të mund të zbulosh thirrjen unike dhe përmbushjen më të madhe.” A pajtoheni se keni një identitet të fshehur që nuk të takon ty ta ndërtosh por ta zbulosh dhe që ky identitet është vetja jote në Krishtin? Cilat janë identitetet tjera në të cilat ke investuar më së shumti? Dag Hammarskjöld thotë se nuk do ta glesh kurrë këtë “përderisa të mos përjashtosh të gjitha mundësitë sipërfaqësore dhe të shkurtra me të cilat luan nga kurioziteti, habia apo lakmia dhe të cilat ju pengojnë të hidhni spirancën në përjetimin e misterit të jetës”. Si ju flet kjo teksa kërkonti të vërtetën e qenies suaj?

4. A pajtoheni se kërkimi i unikes sonë është një kërkim i shenjtë që ka një rol të rëndësishëm në jetën e krishterë? Pse ky nocion është kërcënim për disa që duket se mendojnë që sa më shumë t’i ngjasojmë Krishtit aq më shumë bëhemi si njëri tjetri? Si po përpiqeni t’i balanconi këto dy pozicione?
5. Në kapitullin një unë them se transformimi i vetes mund të ndodh kur Perëndia dhe vetja njihen thellësisht. Bëni një argument të kundërt bazuar në transformimin e vetes e që vjen nga njohja e thellë e Perëndisë. Pastaj identifikoni pasojat e largimit të vetvetes nga ana shpirtërore e krishterë. Cilat rrezeqe i shihni kur përqendroheni në Perëndinë ndërsa dështoni të njihni veten?
6. Sa nga njohja e Perëndisë është “dije (informacion) për Perëndinë” (objektive dhe jo-personale) dhe sa është “njohje me Perëndinë” (subjektive, personale, lidhje)? Si do ta përshkruanit dallimin në mes të këtyre të dyjave? Cilat janë të mirat e “dijes (informacionit) për Perëndinë dhe cilat janë kufizimet? Cilat janë të mirat e “njohjes me Perëndinë” që zhvillohen nga marrëdhënia me personin që njohim dhe cilat janë (nëse ka) kufizimet që mund të lidhen me të?

7. Në kapitullin 1, rilexoni diskutimin që gjendet tek pjesa “Njohuria transformuese e Pjetrit” për rrugëtimin shpirtëror të Pjetrit dhe procesin e ngadaltë transformues që ndodhi, dhe reflektoni nëse përputhet me rrugëtimin tuaj shpirtëror apo jo. Çka mësoni nga ky rrugëtim i Pjetrit? Çka ju sugjeron për gërshtimin e njohjes së vetes dhe Perëndisë?
8. Çka mund të emëroni si përjetim personal dhe direkt me Perëndinë? Si ka ndodhur tek ju dhe çka ka përfshirë? Çka keni mësuar për veten si rezultat i ballafaqimit me Perëndinë? Dhe çka dini për Perëndinë si rezultat i ballafaqimit të vërtetë me veten?

≈ *Sesioni dy* ≈

KAPITULLI 2: NJOHJA E PERËNDISË

1. Si përgatitje për këtë sesion, më lejoni sërish t’ju sugjeroj të ktheheni tek kapitulli 2 dhe të identifikoni pjesët e preferuara. Për të filluar me këtë kapitull ndani me të tjerët mësimet më të dobishme nga kapitulli 1 dhe pjesën që ju ka lënë më shumë përshtypje nga kapitulli 2 dhe si i jeni përgjigjur kësaj pjese.
2. Rilexoni përvojën e Vicki-t dhe dëshirat e saj që janë përshkruar në fillim të këtij kapitulli. Çka dini për dëshirat e saj? Çka dini për zhgënjimin që kishte për shkak të mos përmbushjes së këtyre dëshirave? Çka do t’i thoshit asaj nëse do të ishte shoqja juaj apo nëse do të merrte pjesë në grupet e diskutimit të librit?
3. Në këtë kapitull unë them: “Perëndia nuk ka reshtur së zbuluari ashtu siç nuk ka reshtur asnjëherë së qeni Dashuri.” A pajtoheni se Perëndia vazhdon të zbulojë

veten? Mendo se çka do të thotë kjo për njerëzimin sot. Cila është marrëdhënia mes asaj që Perëndia ka zbuluar në të kaluarën me atë që ne mund të dimë direkt dhe personalisht nga Perëndia tani? Si mund ta njohim Perëndinë dhe jo vetëm të kemi informacione për të? Sillni mendimet dhe pyetjet për këtë çështje në grupin e diskutimit teksa përgatiteni të diskutoni mbi implikimet e ndjekjes së këtij Perëndie që zbulon veten.

4. Si dallon njohja e Perëndisë nga njohja e njerëzve? Në cilat pika është e ngjashme? Çka i kërkohet njerëzve për ta njohur Perëndinë?
5. Ata që dinë më shumë për njohjen personale dhe direkte të Perëndisë (mistikët) na thonë se për shkak se Perëndia është dashuri, atëherë Perëndia mund të njihet vetëm në dhe përmes dashurisë. Çka do të thotë të njohësh Perëndinë përmes zemrës (përmes dashurisë), e jo përmes mendjes (përmes mendimeve dhe bindjeve)? Cila e përshkruan më së miri njohjen tënde? Çka dini për kufizimet e njohjes objektive të Perëndisë? Si mund ta mbështesë njohja objektive e Perëndisë njohjen personale?
6. Rikujtoni thënien e Thomas Mertonit që e kam thënë në këtë kapitull: “duhet ta njohim të vërtetën, duhet ta duam të vërtetën që njohim dhe duhet të veprojmë sipas masës së dashurisë sonë. E vërteta është vet Perëndia i cili nuk mund të njihet veçmas dashurisë dhe nuk mund të njihet pa iu dorëzuar vullnetit të Tij.” A pajtoheni? Nëse jo, përse? Cili është roli i dorëzimit dhe dashurisë në njohjen e Perëndisë?
7. Cili ka qenë përjetimi juaj gjatë meditimit të Ungjillit që e kam sugjeruar te Marku 10:17-22? Nëse nuk e keni bërë ende, rilexoni pasazhin dhe përfshihuni në të si një meditim. Çfarë vlere mund të ketë një lloj i tillë meditimi si një mënyrë e takimit me Jezusin dhe përmes Tij të njihni

Perëndinë? Çka është e parehatshme, nëse ka diçka, në shfrytëzimin e ndjenjave dhe imagjinatës për të pasur një meditim të tillë në lutje rreth historisë së ungjillit?

8. Pse është e vështirë të ndjeni praninë e Perëndisë në ngjarjet e zakonshme të ditës suaj? Cilat gjëra ju ndihmojnë të ndiheni ashtu? Çka keni zbuluar për praninë e Perëndisë edhe në kohë dhimbje, tragjike apo jo të këndshme?

≈ *Sesioni tre* ≈

KAPITULLI 3: HAPAT E PARË DREJT NJOHJES SË VETVETES

1. Si përgatitje për këtë sesion më lejoni që sërish t'ju sugjeroj të ktheheni tek kapitulli tre dhe të identifikoni pjesët e preferuara. Për të filluar këtë sesion të tretë, ndani me të tjerët mësimet më të dobishme të kapitullit 2 dhe pjesën që ju ka lënë më shumë përshtypje nga kapitulli 3 dhe si i jeni përgjigjur kësaj pjese.
2. Cila është vetja juaj që njihet nga Perëndia? A pajtoheni se kjo është vetja që duhet të aktualizohet teksa përpiqemi të njohim të vërtetën tonë? Si mund ta njihni veten jo si teologji abstrakte që duhet të besohet por si e vërteta e vetvetes që duhet të kuptohet?
3. A besoni se Perëndia ju do dhe ju njeh me një thellësi të paimagjinueshme, me këmbëngulje dhe intensitet në individualitetin tuaj? Nëse po, kur e shikoni Perëndinë në sy atëherë duhet të shihni reflektimin e vetes, ashtu sikurse fëmija shikon kah fytyra e dashur e prindërve. Çka e bën të vështirë shikimin në sytë e Perëndisë dhe ta shihni veten duke u reflektuar aty? Çka ju ndihmon ta bëni këtë të mundur?

4. Në këtë kapitull unë them se identiteti i rrënjosur në Perëndinë do të thotë që kur ne mendojmë se kush jemi, gjëja e parë që do të vijë në mendje është statusi si dikush që është thellësisht i dashur nga Perëndia. Sa e vërtetë është kjo për ju? Kur e vini re atë që ju vjen në mendje sapo mendoni për veten, çka mësoni për identitetin tuaj? Çka ju pengon të njihni veten brenda Perëndisë?
5. Rilexoni pjesën “Njohja e vetes si shumë të dashur” ku unë flas për identitetin e Jezusit. Çka mësoni për rrënjosjen e vetes në Perëndinë duke reflektuar mbi mënyrën si e bëri Jezusi?
6. Si do të ndihmonte takimi me Perëndinë në cënueshmërinë e realitetit të tanishëm që të njohësh më mirë veten që Perëndia e sheh kur Ai të shikon ty? Çka do të të ndihmonte të vije para Perëndisë me më shumë cënueshmëri dhe sinqeritet, duke guxuar të besosh se Perëndia është me ty në mesin e këtyre rrethanave të tanishme që ndoshta po përpiqesh t’i shmangësh apo t’i zvogëlosh?
7. Sa jeni pjekur në pranimin dhe përqafimin e hijes dhe të gjitha pjesëve të vetes që vazhdimisht jeni përpjekur t’i injoroni? Çka ju ka ndihmuar t’i mirëprisni pjesët e humbura të vetes në familjen e pjesëve të vetes që pranohen lehtë?
8. A pajtoheni se nuk mund ta njihni veten në të vërtetë pa i pranuar fillimisht ato gjëra rreth vetes që do të donit të mos ishin të vërteta? Cilat dimensione apo pjesë të vetes e keni më vështirë t’i njihni, emëroni apo t’i pranoni? Mbani mend se kur guxoni t’i emërtoni para vetes dhe të tjerëve, ky është hapi i parë drejt pranimin të tyre, kështu që guxoni ta ndërmerrni këtë hap. Çka do të mund të bënte më shumë kisha (apo forma të tjera të komunitetit shpirtëror) që të na ndihmojë t’i pranojmë pjesët që duken vështirë të pranueshme brenda vetes?

≈ *Sesioni katër* ≈

KAPITULLI 4: TA NJOHËSH VETEN ASHTU SIÇ JE

1. Si përgatitje për këtë sesion më lejoni që sërish t'ju sugjeroj të ktheheni tek kapitulli katër dhe të identifikoni pjesët e preferuara. Për të filluar këtë sesion të katërt, ndani me të tjerët mësimet më të dobishme të kapitullit 3 dhe pjesën që ju ka lënë më shumë përshtypje nga kapitulli 4 dhe si i jeni përgjigjur kësaj pjese.
2. Reflektoni mbi thënien e Thomas Merton në vazhdim: “Nuk ka shkatërrim më të madh në jetën shpirtërore sesa të zhytesh në irealitet, sepse jeta mbahet dhe lulëzon në ne nga marrëdhënia jonë e gjallë me realitetin.” Si do e cilësonit pranimin e realitetit nga ana juaj? Çka ju pengon t'i përkushtoheni dhe ta pranoni të gjithë realitetin e jetës suaj të tanishme? Cilat gjëra ju ndihmojnë që t'i emërtoni dhe t'i largoni iluzionet që komprometojnë përkushtimin tuaj të plotë ndaj realitetit?
3. Në kundërshtim me sugjerimin tim kur them se identiteti ynë duhet të bazohet në dashurinë e plotë të Perëndisë, disa të krishterë thonë se identiteti ynë si të krishterë duhet të rrënjohet në faktin se jemi mëkatarë. Cila nga të dyja anët e medaljes përputhet më shumë me bindjet tuaja? Merrni pak kohë diskutimi rreth identitetit me grupin dhe reflektoni nëse teologjia juaj reflekton dhe mbështet si duhet anën tuaj shpirtërore.
4. Në këtë kapitull unë them se mëkati është më shumë çështje e ontologjisë (qenies) sesa e moralit (sjelljes). Te jesh njeri do të thotë se je mëkatar. Kjo nënkupton se jemi të thyer dhe të prishur që mbartim në vete një të metë thelbësore dhe fatale që maskon krijesën e mirë. A pajtoheni? Nëse jo, pse? Si do ta përkufizonit mëkatin?

5. Rilexoni diskutimin për rastin e Stuart-it që u prezantua te sesioni “Zhvendosja nga Mëkatet tek Zemra e Mëkatit”. Si i kuptoni ju problemet kryesore? Si përshtatet kjo histori me mënyrën si e përkufizoni ju mëkatin? Si përshtatet më mënyrën si i qaseni rrugëtimit tuaj shpirtëror?
6. Ku e shihni veten në llojet e Eneagramit bazuar në leximin e atyre që them tek sesioni “Ndhima antike për njohjen e mëkatit tonë” apo nga njohuritë personale për të? Çfarë ndihme, nëse ka, ju jep për të kuptuar dhe njohur anët e fshehta të vetes që duhet të njihen para se të integrohen dhe pastaj të transformohen? Me cilat mjete dhe procese tjera keni punuar dhe që ju kanë ndihmuar të njihni veten më mirë?
7. E përfundova këtë kapitull duke thënë se njohja e vërtetë e vetes i ofrohet atyre që 1. e duan me të vërtetë këtë gjë, 2. që janë të gatshëm të reflektojnë në lutje për përjetimet e tyre dhe 3. që kanë guximin të ballafaqohen me veten dhe Perëndinë në fshehtësi. Merrni këto tri kritere si një matës me 10 nota dhe vini vetes nota për secilën nga këto kritere. A të ndihmon që ta shohësh veten se ku je tani në rrugëtimin e transformimit?
8. Cili është hapi i radhës që ndjen ta bësh në rrugëtimin tënd? Si ndihesh ndaj ftesës për të ndërmarrë këtë hap?

≈ Sesioni pesë ≈

KAPITULLI 5: DEMASKIMI I VETVETES SË RREME

1. Si përgatitje për këtë sesion më lejoni që sërish t’ju sugjeroj të ktheheni tek kapitulli pesë dhe të identifikoni pjesët e preferuara. Për të filluar këtë sesion të katërt, ndani me të tjerët mësimet më të dobishme të kapitullit 4 dhe pjesën që ju ka lënë më shumë përshtypje nga kapitulli 5 dhe si i jeni përgjigjur kësaj pjese.

2. A pajtoheni se çdo gjë e rreme në ne vjen nga bindja se lumturia jonë e vërtetë rrjedh nga të jetuarit në mënyrën tonë, e jo në mënyrën e Perëndisë? Nëse jo, atëherë çfarë burime tjera të falsitetit mund të identifikoni? Pse dyshoni se Perëndia është në gjendje të na ofrojë lumturi? Sipas mendimit tuaj, si ndikon ky dyshim në rritjen dhe fuqizimin e vetes së rreme?
3. Si doni që të tjerët të ju shohin? Çka ju thotë kjo për supozimet rreth atyre gjërave që mendoni se do t'ju bëjnë të lumtur dhe të përmbushur? Si është shndërruar ky imazh në gënjeshtër që e keni jetuar deri tani? Sa jeni të gatshëm të zvogëloni lidhjen tuaj me këtë gënjeshtër?
4. Basil Pennington thotë se thelbi i vetes së rreme është bindja se vlera ime varet nga ajo që kam dhe ajo që mund të bëj. Çfarë anë tjera të falsitetit mund të identifikoni pas reflektimit në lutje rreth gjërave që i shtoni asaj që keni dhe asaj që mund të bëni? Si do të liroheshit nga gjërat që i shtoni? Çka ju tremb më së shumti?
5. Çdo gjë pas së cilës kapemi përveç tek Perëndia mund të paraqesë një shtesë të panevojshme. Si i vlerësoni shtesat tuaja më të forta? Cilat prej tyre paraqesin një shtesë të panevojshme? Çka ju mban të lidhur për to? Si ballafaqoheni me ndjenjën e cenueshmërisë, turpfit dhe pamjaftueshmërisë që gjenden në thelbin e vetes së rreme?
6. Vini re cenimin e sedrës suaj dhe reagimin e tepërt. Çfarë ndihme i ofroni vetes për të kuptuar mënyrat e rreme të qenies? Bëni të njëjtën gjë me varësitë dhe zellin për të bërë diçka, brenda jush. Mos u ngutni që të konstatoni se nuk keni varësi. Mbani mend, dinamikat që krijojnë varësi na karakterizojnë dhe gjenden nën zellin tonë për të bërë diçka.

7. Rilexoni historinë e tundimit të Jezusit në shkretëtirë (Mateu 4:1-11) dhe diskutimin në lidhje me të tek sesiioni “Beteja hyjnore me veten e rreme.” Çka ju ofron meditim në lutje mbi mënyrën se si Jezusi u ballafaqua me tundimin e falsitetit të Tij, teksa mundoheni të ballafaqoheni më mënyrën më të mirë me falsitetin tuaj?
8. Çfarë thirrje po përjetoni nga Fryma që të mos i ikni fshehjes nga Perëndia, ta pranoni veten dhe Perëndinë me standardin e Perëndisë për dashuri pa kushte? Çka jeni të gatshëm të ofroni si përgjigje ndaj kësaj thirrjeje?

≈ Sesioni gjashtë ≈

KAPITULLI 6: SHNDËRRIMI NË VETEN E VËRTETË DHE EPILOGU

IDENTITETI DHE RRUGËTIMI SHPIRTËROR

1. Si përgatitje për këtë sesion më lejoni që sërish t’ju sugjeroj të ktheheni tek kapitulli gjashtë dhe tek epilogu që të identifikoni pjesët e preferuara. Për të filluar këtë sesion final, ndani me të tjerët mësimet më të dobishme të kapitullit 5 dhe pjesën që ju ka lënë më shumë përshtypje nga kapitulli 6 dhe epilogu, dhe si i jeni përgjigjur kësaj pjese.
2. Në kapitullin 6 thuhet se ne nuk e gjejmë të vërtetën për veten tonë duke e analizuar apo shqyrtuar mirëpo duke e humbur veten në Perëndinë. Kjo na sjellë sërish tek pyetja se çka na pengon që të dorëzohemi tek Perëndia. Teksa e keni lexuar librin deri këtu, çka do të identifikoni si pengesën më të rëndësishme drejt hedhjes së hapit për t’u dorëzuar? Emërtimi i tyre është njëra nga mënyrat si e përqaftoni realitetin tuaj të tanishëm dhe kjo në vetvete është një lutje.

3. Në kapitullin 6, rilexoni sesionin “Identiteti i rrënjës në Perëndinë” dhe reflektoni se çka mund të mësoni për mënyrën se si Jezusi e bazoi identitetin e Tij tek marrëdhënia me Perëndinë. Mos u ngutni që ta përjashtoni Jezusin si model për ne në këtë aspekt. Sepse si shembull i të qenit plotësisht njeri, ai është i përkryer. Çka mësoni nga reflektimi rreth mënyrës së zhvillimit dhe pastaj ruajtjes së identitetit të tij të rrënjës në Perëndinë?
4. Si e kuptoni thirrjen tuaj? Si është e lidhur kjo me të qenit vetja e vërtetë? Si mundet që thirrja juaj të jetë e lidhur plotësisht me qenien tuaj dhe të jetuarit e kësaj të vërtetë?
5. Në kapitullin 6, rilexoni sesionin “Thirrja e rrënjës në identitet” dhe reflektoni se si Jezusi e lidhi thirrjen e tij me identitetin dhe mendoni se si kjo mënyrë e të jetuarit të vërtetës unike të Tij mund të jetë edhe mënyra juaj.
6. Si mundet që edhe e vërteta e identitetit tuaj edhe thirrja të jenë të rrënjësura në dhuntitë unike, temperament, pasione, interesa, kuriozitete dhe dëshira? Kur reflektoni mbi këtë ju e dalloni mënyrën në të cilën thirrja e Perëndisë dhe vullneti i tij për ju gjendet në anën unike të vetes suaj të vërtetë.
7. Reflektoni mbi dhuntitë dhe ftesat që ndjeni se kanë ardhur nga Fryma e Perëndisë tek ju përmes studimit dhe diskutimeve në këtë libër. Si do t’i përgjigjeni atyre? Cili do të jetë hapi juaj i ardhshëm drejt përgjigjes me plotë zemër me “Po” ndaj dhuntisë së të qenit vetja?

Udhëzues diskutimi për një sesion mbi *Dhuntinë e të qenit vetvetja*

1. Si përgatitje për sesionin e parë, më lejoni t'ju sugjeroj që të ktheheni tek parathënia dhe kapitulli i parë dhe të mbani shënim pjesët tuaja të preferuara. Ndoshta tashmë e keni bërë duke e nënvizuar librin, por edhe nëse e keni bërë do t'ju inkurajoja të veçoni dy apo tre pjesë që ju kanë lënë përshtypje më së shumti. Teksa e prezantoni veten para të tjerëve në sesionin e parë, ndajeni një pjesë që ju ka lënë përshtypje dhe tregoni grupit si i jeni përgjigjur asaj pjese.
2. Epigrafi në fillim të librit na paraqet një thënie nga Thomas Merton: *“Ka vetëm një problem nga i cili varet e gjithë ekzistenca, paqja dhe lumturia ime: të zbuloj veten derisa zbuloj Perëndinë. Nëse e gjej Atë do ta gjej edhe veten dhe nëse e gjej veten do ta gjej Atë”*. Në cilën gjë do të thoshit se varet ekzistenca, paqja dhe lumturia juaj? Çka e bën të vështirë të besosh në atë që Merton-i thotë? Çfarë ndryshimi do të kishte në jetën tuaj nëse ato që thotë ai janë të vërteta?
3. A pajtoheni se kërkimi i anës sonë unike është një kërkim i shenjtë që ka një rol të rëndësishëm në jetën e krishterë? Pse ky nocion është kërcënim për disa që duket se mendojnë që sa më shumë t'i ngjasojmë Krishtit aq më shumë bëhemi si njëri tjetri? Si po përpiqeni t'i balanconi këto dy pozicione?

4. Sa nga njohja jote mbi Perëndinë është “dije (informacion) për Perëndinë” (objektive dhe jo-personale) dhe sa është “njohje me Perëndinë” (subjektive, personale, lidhje)? Si do ta përshkruanit dallimin në mes të këtyre të dyjave? Cilat janë të mirat “dijes (informacionit) për Perëndinë dhe cilat janë kufizimet? Cilat janë të mirat e “njohjes me Perëndinë” që zhvillohen nga marrëdhënia me personin që njohim dhe cilat janë (nëse ka) kufizimet që mund të lidhen me të?
5. Si dallon njohja e Perëndisë nga njohja e njerëzve? Në cilat pika është e ngjashme? Çka i kërkohet njerëzve për ta njohur Perëndinë?
6. Ata që dinë më shumë për njohjen personale dhe direkte të Perëndisë (mistikët) na thonë se për shkak se Perëndia është dashuri, atëherë Perëndia mund të njihet vetëm në dhe përmes dashurisë. Çka do të thotë të njohësh Perëndinë përmes zemrës (përmes dashurisë), e jo përmes mendjes (përmes mendimeve dhe bindjeve)? Cila e përshkruan më së miri njohjen tënde? Çka dini për kufizimet e njohjes objektive të Perëndisë? Si mund ta mbështesë njohja objektive e Perëndisë njohjen personale?
7. Cili ka qenë përjetimi juaj gjatë meditimit të Ungjillit që kam sugjeruar te Marku 10:17-22? Nëse nuk e keni bërë ende, rilexoni pasazhin dhe përfshihuni në të si një meditim. Çfarë vlere mund të ketë një lloj i tillë meditimi si një mënyrë e takimit me Jezusin dhe përmes Tij të njihni Perëndinë? Çka është e parehatshme, nëse ka diçka, në shfrytëzimin e ndjenjave dhe imagjinatës për të pasur një meditim të tillë në lutje rreth historisë së ungjillit?
8. Në kapitullin tre unë them se identiteti i rrënjësuar në Perëndinë do të thotë që kur ne mendojmë se kush jemi, gjëja e parë që do të vijë në mendje është statusi si dikush që është plotësisht i dashur nga Perëndia. Sa e vërtetë është kjo për ju? Kur e vini re atë që ju vjen në mendje

sapo mendoni për veten, çka mësoni për identitetin tuaj?
Çka ju pengon të njihni veten brenda Perëndisë?

9. Sa jeni pjekur në pranimin dhe përqafimin e hijes dhe të gjitha pjesëve të vetes që vazhdimisht jeni përpjekur t'i injoroni? Çka ju ka ndihmuar t'i mirëprisni pjesët e humbura të vetes në familjen e pjesëve të vetes që pranohen lehtë?
10. Reflektoni mbi thënien e Thomas Merton në vazhdim:
“Nuk ka shkatërrim më të madh në jetën shpirtërore sesa të zhytesh në irealitet, sepse jeta mbahet dhe lulëzon në ne nga marrëdhënia jonë e gjallë me realitetin.” Si do e cilësonit pranimin e realitetit nga ana juaj? Çka ju pengon t'i përkushtoheni dhe ta pranoni të gjithë realitetin e jetës suaj të tanishme? Cilat gjëra ju ndihmojnë që t'i emërtoni dhe t'i largoni iluzionet që komprometojnë përkushtimin tuaj të plotë ndaj realitetit?
11. Në kundërshtim me sugjerimin tim kur them se identiteti ynë duhet të bazohet në dashurinë e plotë të Perëndisë, disa të krishterë thonë se identiteti ynë si të krishterë duhet të rrënjohet në faktin se jemi mëkatarë. Cila nga të dyja anët e medaljes përputhet më shumë me bindjet tuaja? Merrni pak kohë diskutimi rreth identitetit me grupin dhe reflektoni nëse teologjia juaj reflekton dhe mbështet si duhet anën tuaj shpirtërore.
12. Në kapitullin 4 unë them se mëkati është më shumë çështje e ontologjisë (qenies) sesa e moralit (sjelljes). Te jesh njeri do të thotë se je mëkatar. Kjo nënkupton se jemi të thyer dhe të prishur që mbartim në vete një të metë thelbësore dhe fatale që maskon krijesën e mirë. A pajtoheni? Nëse jo, pse? Si do ta përkufizonit mëkatin?
13. Ku e shihni veten në llojet e Eneagramit bazuar në leximin e atyre që them tek sesi “Ndihma antike për njohjen e

mëkatit tonë” apo nga njohuritë personale për të? Çfarë ndihme, nëse ka, ju jep për të kuptuar dhe njohur anët e fshehta të vetes që duhet të njihen para se të integrohen dhe pastaj të transformohen? Me cilat mjete dhe procese tjera keni punuar dhe që ju kanë ndihmuar të njihni veten më mirë?

14. Kapitulli katër përfundon me thënien time se njohja e vërtetë e vetes i ofrohet atyre që 1. e duan me të vërtetë këtë gjë, 2. që janë të gatshëm të reflektojnë në lutje për përjetimet e tyre dhe 3. që kanë guximin të ballafaqohen me veten dhe Perëndinë në fshehtësi. Merrni këto tri kriterë si një matës me 10 nota dhe vini vetes nota për secilën nga këto kriterë. A të ndihmon që ta shohësh veten se ku je tani në rrugëtimin e transformimit?
15. A pajtoheni se çdo gjë e rreme në ne vjen nga bindja se lumturia jonë e vërtetë rrjedh nga të jetuarit në mënyrën tonë, e jo në mënyrën e Perëndisë? Nëse jo, atëherë çfarë burime tjera të falsitetit mund të identifikoni? Pse dyshoni se Perëndia është në gjendje të na ofrojë lumturi? Sipas mendimit tuaj, si ndikon ky dyshim në rritjen dhe fuqizimin e vetes së rreme?
16. Si doni që të tjerët të ju shohin? Çka ju thotë kjo për supozimet rreth atyre gjërave që mendoni se do t’ju bëjnë të lumtur dhe të përmbushur? Si është shndërruar ky imazh në gënjeshtëri që e keni jetuar deri tani? Sa jeni të gatshëm të zvogëloni lidhjen tuaj me këtë gënjeshtëri?
17. Basil Penington thotë se thelbi i vetes së rreme është bindja se vlera ime varet nga ajo që kam dhe ajo që mund të bëj. Çfarë anë tjera të falsitetit mund të identifikoni pas reflektimit në lutje rreth gjërave që i shtoni asaj që keni dhe asaj që mund të bëni? Si do të liroheshit nga gjërat që i shtoni? Çka ju tremb më së shumti?

18. Vini re cenimin e sedrës suaj dhe reagimin e tepërt. Çfarë ndihme i ofroni vetes për të kuptuar mënyrat e rreme të qenies? Bëni të njëjtën gjë me varësitë dhe zellin për të bërë diçka, brenda jush. Mos u ngutni që të konstatoni se nuk keni varësi. Mbani mend, dinamikat që krijojnë varësi na karakterizojnë dhe gjenden nën zellin tonë për të bërë diçka.
19. Si e kuptoni thirrjen tuaj? Si është e lidhur kjo me të qenit vetja e vërtetë? Si mundet që thirrja juaj të jetë e lidhur plotësisht me qenien tuaj dhe të jetuarit e kësaj të vërtete?
20. Si mundet që edhe e vërteta e identitetit tuaj edhe thirrja të jenë të rrënjosura në dhuntitë unike, temperament, pasione, interesa, kuriozitete dhe dëshira? Kur reflektoni mbi këtë ju e dalloni mënyrën në të cilën thirrja e Perëndisë dhe vullneti i tij për ju gjendet në anën unike të vetes suaj të vërtetë.
21. Reflektoni mbi dhuntitë dhe ftesat që ndjeni se kanë ardhur nga Fryma e Perëndisë tek ju përmes studimit dhe diskutimeve në këtë libër. Si do t'i përgjigjeni atyre? Cili do të jetë hapi juaj i ardhshëm drejt përgjigjes me plotë zemër me "Po" ndaj dhuntisë së të qenit vetvetja?

Shënime

PARATHËNIE: IDENTITETI DHE AUTENTICITETI

¹ Dag Hammarskjöld, *Markings* (New York: Alfred A. Knopf, 1969).

² Thomas Merton, *New Seeds of Contemplation* (New York: New Directions, 1961).

KAPITULLI 1: NJOHJA TRANSFORMUESE E VETVETES DHE PERËNDISË

¹ Thomas à Kempis, *Imitation of Christ*, trans. Clare L. Fitzpatrick (New York: Catholic Book Publishing, 1993)

² St. Augustine is quoted in Pierre Pourrat, *Cristian Spirituality in the Middle Ages* (London: Burns & Oates, 1924)

³ John Calvin, *Institutes of the Christian Religion*, 1536 ed., trans. Ford Lewis Battles (Grand Rapids: Eerdmans, 1995)

KAPITULLI 2: NJOHJA E PERËNDISË

¹ J.I. Packer, *Knowing God*, 20th anniv. ed. (Downers Grove, IL: InterVarsity Press, 1993)

² Louis Evelyn, *That Man Is That Man Is You* (New York: Paulist, 1964)

³ Packer, *Knowing God*,

⁴ Thomas Merton, *The Ascent to Truth* (New York: Harcourt Brace, 1981)

⁵ Falënderoj Kenon Grei që më sugjeroi këtë interpretim në predikimin e tij në Kishën St. Patrick Episcopal në Atlanta më 30 Mars 2003.

⁶ Carolyn Gratton, *The Art of Spiritual Guidance* (New York: Crossroad, 2000)

⁷ R. Paul Stevens, *Down-to-Earth Spirituality: Encountering God in the Ordinary, Boring Stuff of Life* (Downers Grove, IL: InterVarsity Press, 2003)

- ⁸ Ben Johnson e përshkruan këtë si pjesë shumë të rëndësishme të rolit që ka drejtuesi shpirtëror, pasi shpesh ne kemi nevojë për ndihmën e të tjerëve për të arritur demaskimin e pranisë së anës Hyjnore. E kam marrë këtë nga kapitulli i tij “Spiritual Direction in the Reformed Tradition” në librin “*Spiritual Direction and the Care of Souls*” ed. Gary Moon dhe David G. Benner (Downers Grove, IL: InterVarsity Press, 2004)
- ⁹ Richard Rohr, *Everything Belongs: The Gift of Contemplative Prayer* (New York: Crossroad, 1999)
- ¹⁰ David G. Benner, *Sacred Companions: The Gift of Spiritual Friendship and Direction* (Downers Grove, IL: InterVarsity Press, 2002)

KAPITULLI 3: HAPAT E PARË DREJT NJOHJES SË VETVETES

- ¹ Thomas Merton, *New Seeds of Contemplation* (New York: New Directions, 1961)
- ² J. I. Parker, *Knowing God*, 20th anniv. ed. (Downers Grove, IL: InterVarsity Press, 1993)
- ³ Hannah Hurnard, *Kingdom of Love*, (Carol Stream, IL: Tyndale House, 1981)
- ⁴ Kjo temë trajtohet më gjerësisht në librin tim *Surrender to Love* (Downers Grove, IL: InterVarsity Press, 2015),
- ⁵ Shihni librin e David G. Benner, *Sacred Companions: The gift of Spiritual Friendship and Direction* (Downers Grove, IL: InterVarsity Press, 2002), për të diskutuar më shumë rreth rëndësisë së shoqërimin shpirtëror dhe si e mundëson që kjo të ndodh.
- ⁶ Thomas Merton, *Thoughts in Solitude* (Boston: Shambhala, 1993)
- ⁷ I jam mirënjohës Robert V. Thomson për sugjerimin për ta bërë lidhjen në mes të kësaj historie dhe lutjes në predikimin e tij “Liria nga Vetja e Rreme”, i predikuar tek Lake Street Church në Evanston, IL, 3 Shkurt 2002. Edhe pse një numër shumë i vogël i tregimeve popullore të Nasradinit janë përkthyer dhe shkruar në anglisht, një hyrje e jashtëzakonshme në këto tregime mund të gjendet në librin e Idries Shah, *The Pleasantries of the Incredible Mulla Nasrudin* (London: Octagon, 1983).

KAPITULLI 4: TA NJOHËSH VETVETEN ASHTU SIÇ JE

¹ Thomas Merton, *Thoughts in Solitude* (Boston: Shambhala, 1993),

² James Finley, *Merton's Palace of Nowhere: A search for God Through Awareness of the True Self* (Notre Dame, IN: Ave Maria, 1978),

³ Dallas Willard, *The Divine Conspiracy: Rediscovering Our Hidden Life in God* (San Francisco: Harper San Francisco, 1998),

⁴ Për një hyrje të mirë në këtë qasje të kuptimi të personalitetit, lexoni librin e Don Richard Riso dhe Russ Hudson, *The Wisdom of the Enneagram: The Complete Guide to Psychological and Spiritual Growth for the Nine Personality Types* (New York: Bantam Doubleday Dell, 1999). Për një qasje plotësisht të krishterë mbi Eneagramin, veçanërisht i përqendruar në kuptimin e mëkatit, shihni librin e Richard Rohr, *Enneagram: A Christian Perspective* (New York: Crossroad, 2001, apo dëgjoni diskutimet e tij *Enneagram: Naming our Illusions*, një seri me gjashtë audio incizime prodhuar nga Credence Cassettes (Kansas City, MO, 1988).

⁵ Nuk jam ithtar i sistemeve të klasifikimit të personalitetit. Shpesh pjesët tona që përshtaten brenda kutisë janë më pak sesa ato që nuk përshtaten. Dhe tundimi për t'u krahasuar me të tjerët si "lloj" personaliteti është pothuajse i pa rezistueshëm për disa njerëz. Por, unë jam ithtar i Eneagramit, jo si tipologji por si mjet për të ndihmuar njohjen e mëkatit thelbësor. Edhe në jetën tim sikurse në punën me të tjerët Eneagrami ka qenë shumë i dobishëm.

⁶ Edhe pse kjo përmbledhje bashkon mendimet e një numri të caktuar njerëzish, ajo reflekton një borxh të madh ndaj punës së madhe të Richard Rohr, i cituar në shënimin 4.

⁷ Edhe pse janë hartuar pyetësorë që ndihmojnë në identifikimin e llojeve (shih Don Richard Riso dhe Russ Hudson, *The Riso-Hudson Enneagram Type Indicator* [Stone Ridge, NY: Enneagram Institute, 2000] ose www.enneagraminstitute.com/home.asp), mënyra më e mirë për të gjetur veten brenda Eneagramit është përmes reflektimit në lutje. Pasi që Eneagrami identifikon iluzionet tona të thella, tundimi që të zbukurojmë veten duke e identifikuar me deklaratat që përshtaten me mënyrën si duam ta shohim veten kufizon dobinë e pyetësorëve. Absorbimi i këtij rrjeti mbrojtës të iluzioneve është vepër shpirtërore që kërkon kohë, sinqeritet të

pashoq dhe mprehtësi që vjen vetëm nga hapja ndaj Frymës së Perëndisë.

KAPITULLI 5: DEMASKIMI I VETEVETES SË RREME

¹ Thomas Keating, *Invitation to Love: The Way of Christian Contemplation* (New York: Continuum, 1998)

² Richard Rohr, *Enneagram: Naming Our Illusions*, audiotapes (Kansas City, MO: Credence Cassettes, 1988) tape 1.

³ James Finley, *Merton's Palace of November: A Search for God Through Awareness of the True Self* (Notre Dame, IN: Ave Maria, 1978).

⁴ M. Basil Pennington, *True Self/False Self* (New York: Crossroad, 2000).

⁵ Thomas Merton, *New Seeds of Contemplation* (New York: New Directions, 1961)

⁶ Pennington, *True Self/False Self*

⁷ Ibid

KAPITULLI 6: SHNDËRRIMI NË VETEN E VËRTETË

¹ Ekman Tam, "Message to the Wounded World: Unmask the True Self – Zen and Merton", *Religious Studies and Theology* 17 (1998)

² Luka 2:40,52 pohon aspektin e zhvillimit të jetës së Jezusit që në fakt na siguron se ai ishte njeri.

³ Thomas Merton, *New Seeds of Contemplation* (New York: New Directions, 1961)

⁴ Jean Vanier, *Becomign Human* (Toronto: Anansi, 1998)

⁵ Gordon Smith, *Courage and Calling: Embracing Your God-Given Potential* (Downers Grove, IL: InterVarsity Press, 1999).

⁶ Alistair Campbell, *Paid to Care* (London: SPCK, 1985)

⁷ Frederick Buechner, *Listening to Your Life* (San Francisco: HarperSanFrancisco, 1992)

⁸ Juliet Benner, komunikim personal.

EPILOGU: IDENTITETI DHE RRUGËTIMI SHPIRTËROR

- ¹ Shihni librin e David G. Benner, *Spirituality and the Awakening Self* (Grand Rapids: Brazos Press, 2012), për më shumë diskutim mbi transformimin e identitetit.
- ² St. Augustine, cituar tek libri i Pierre Pourrat, *Christian Spirituality in the Middle Ages* (London: Burns & Oates, 1924)
- ³ Shihni librin e David G. Benner, *Presence and Encounter* (Grand Rapids: Brazos Press, 2014), për më shumë informacion mbi naturën e pranisë dhe udhëzime praktike për kultivimin e saj.

Për autorin

Dr. David G. Benner është psikolog dhe mentor i transformimit, i njohur ndërkombëtarisht, jeta e të cilit është udhëhequr nga dëshira për të ndihmuar njerëzit që të ecin nëpër rrugëtimin njerëzor në mënyrë shpirtërore dhe rrugëtimin shpirtëror në mënyrë njerëzore. Pasioni dhe thirrja e tij ka qenë kuptimi dhe zbulimi i transformimit, jo vetëm shërimi apo rritja por edhe shpalosja e vetes së bashku me rrugëtimin e rizgjimit.



Davidi ka mbajtur ligjërata në Univeristetin York, Universitetin e Torontos, Universitetin McMaster, Kolegjin Universitar Redeemer, Kolegjin Wheaton, Institutin e Studimeve Psikologjike në Universitetin e Richmond, Qendrën për Studime të Religjionit dhe Shoqërisë në Universitetin Victoria si dhe në Living School for Action and Contemplation. Ai, gjithashtu, ka qenë ligjërues mysafir në tridhjetë vende të botës dhe është autor ose editor i më shumë se njëzet e pesë librave që janë përkthyer në nëntëmbëdhjetë gjuhë të huaja.

Përveç psikologjisë dhe anës shpirtërore Davidi shfaq interes të veçantë për lundrim, çiklizëm, ngjitje në male, muzikë xhaz, ushqim të mirë dhe biseda të ngrohta. Ai është i martuar me Xhuliet Bener, autore e librit *Contemplative Vision: A guide to Christian Art and Prayer* (InterVarsity Press). Ata jetojnë në mes të Torontos, Kanada dhe Lima, Peru.

Davidi mund të gjendet në internet përmes:

- www.drdauidbenner.ca
- www.facebook.com/drdauidbenner
- Twitter: @drdauidbenner

Libra nga David G. Benner

Presence and Encounter: The Sacramental Possibilities of Everyday Life (Brazos Press, 2014)

Spirituality and the Awakening Self: The Sacred Journey of Transformation (Brezos Press, 2012)

Soulful Spirituality: Becoming Fully Alive and Deeply Human (Brazos Press, 2011)

Opening to God: Lectio Divina and the Life as Prayer (InterVarsity Press, 2010)

Desiring God's Will: Aligning Our Hearts with the Heart of God (InterVarsity Press, 2005)

The Gift of Being Yourself: The Sacred call to Self-Discovery (InterVarsity Press, 2004)

Spiritual Direction and the Care of Souls: Aguide to Christian Approaches and Practices, ed. with Gary Moon (InterVarsity Press, 2004)

Surrender to Love: Discovering the Heart of Christian Spirituality (InterVarsity Press, 2003)

Strategic Pastoral Counseling: A Short-Term Structured Model, 2nd ed. (Baker, 2003)

Sacred Companions: The Gift of Spiritual Friendship and Direction (InterVarsity Press, 2002)

Free at Last: Breaking the Bondage of Guilt and Emotional Wounds (Essence, 1999)

Care of Souls: Reuniting the Psychological and Spiritual for Christian Nurture and Counsel (Baker, 1998)

Money Madness and Financial Freedom: The Psychology of Money Meanings and Management (Detselig, 1996)

Choosing the Gift of Forgiveness, with Robert Harvey (Baker, 1996)

Understanding and Facilitating Forgiveness, with Robert Harvey (Baker, 1996)

Libra nga David G. Benner

Christian Prospective on Human Development, ed. with Leroy Aden and J. Harold Ellens (Baker, 1992)

Healing Emotional Wounds, (Baker, 1990)

Counseling and the Human Predicament, ed. with Leroy Aden (Baker, 1989)

Psychology and Religion, ed. (Baker 1988)

Psychotherapy and the Spiritual Quest (Baker, 1988)

Psychotherapy in the Christian Perspective, ed. (Baker, 1987)

Christian Counseling and Psychotherapy, ed. (Baker, 1987)

Baker Encyclopedia of Psychology, ed. (Baker, 1985)

Cip